

1 E mërkurë, 12 janar 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [Të dyshuarit hynë në sallë]

4 --- Fillon në orën 9.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zonja

6 Sekretare mund të paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është çështja

8 gjyqësore KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër

9 Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes

11 të gjithëve.

12 Paraqitjet e palëve. Ka ndonjë ndryshim.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk ka asnjë ndryshim.

14 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nuk ka asnjë ndryshim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman?

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Ne kemi edhe zotin Berisha sot në

17 mëngjes edhe ai arriti të vijë këtu dhe të jetë me ne sot në

18 mëngjes.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po kështu Gjykatësi

20 Mettraux është me videolidhje dhe zoti Rees.

21 Mirëmëngjes zoti Rees.

22 Pikësëpari, në lidhje me diskutimin që u bë dje në lidhje

23 me Panelin për të lëshuar një urdhër me gojë mbi kërkesën e

24 Mbrojtjes së Haradinajt për videolidhje me dëshmitarin e parë

25 ekspert, numër 1252.

1 Me 23 dhjetor 2021, Mbrojtja e Haradinajt bëri një
2 kërkesë që dëshmitari ekspert 1252 të bëhej me anë të
3 videolidhjes.

4 Prokuroria u përgjigj në lidhje me këtë, me dy kushte: e
5 para, që të bëhen organizimet logjistike të cilat të mos
6 shkaktjnë asnjë vonës dhe e dyta që teknologjia të lejojë
7 minimalisht që palët t'i tregojnë dokumente dëshmitarit. Dhe
8 që t'i bëhen pyetje dëshmitarit në seancë private ashtu sipas
9 nevojës.

10 Me 10 janar 2022, Zyra Administrative dorëzoi vlerësimin
11 e saj të seancës me videolidhje. Zyra Administrative theksoi
12 se duhet të dërgohen dy punonjës të Zyrës Administrative në
13 Mbretërinë e Bashkuar dhe duhet të vendosen materialet dhe
14 pajisjet e nevojshme përpara se sa të vendoset videolidhja.
15 Zyra Administrative gjithashtu tha se i duhej pesë ditë pune
16 për të organizuar këtë punë.

17 Kjo nevojë duhet për të organizuar udhëtimin, izolimin e
18 mundshëm dhe testimin e anëtarëve të personelit dhe vendosjen
19 e pajisjeve teknike.

20 Autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar kanë informuar Zyrën
21 Administrative se më e hershmja që mund ta organizojnë këtë,
22 që mund të japin përgjigje është 12 janari.

23 Trupi Gjykses vë në dukje se kërkesa për videolidhje
24 bazohet në situatën personale të dëshmitares dhe detyrimet e
25 saj profesionale. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se

1 dëshmitarja ka thënë se ajo mund të vihet në dispozicion të
2 Gjykatës për të ardhur këtu.

3 Trupi Gjykues në bazë të rregullës 144(1) vendos që të
4 lejohet videolidhja në bazë të diskrecionit të Panelit, në
5 qoftë se vendi i zgjedhur dhe teknologjia janë të
6 përshtatshme.

7 Trupi Gjykues ka parasysh se teknologjia dhe përparimet
8 teknologjike të bëra në kohët e fundit bëjnë që videolidhja dhe
9 dëshmia përmes videolidhjes të mos konsiderohet vetëm në raste
10 të jashtëzakonshme. Por kjo nuk do të bëhet rutinë. Në bazë të
11 kësaj kur të vendoset nëse duhet të bëhet dëshmi me
12 videolidhje, Trupi Gjykues mund të marri parasysh faktorë të
13 shumtë, si vendndodhja, situata personale dhe shëndetësore,
14 disponueshmëria, siguria e dëshmitarit si dhe kompleksiteti
15 dhe kohëzgjatja e dëshmisë dhe faktorët logjistikë.

16 Trupi Gjykues ka marrë parasysh nga njëra anë situatën
17 personale të dëshmitarit dhe gatishmërinë e saj për të
18 udhëtuar në Hagë, po kështu nga ana tjetër edhe organizimet
19 komplekse që duhet të bëhen. Trupi Gjykues ka marrë parasysh
20 edhe vonesat që mund të shkaktojnë dhënia e dëshmisë me
21 videolidhje.

22 Dhe mbi bazën e të gjitha këtyre konsideratave, Trupi
23 Gjykues mendon që mënyra më e arsyeshme për të dhënë dëshmi
24 është që dëshmitari të japë dëshmi në person.

25 Paneli e udhëzon Mbrojtjen e Haradinajt dhe Zyrën

1 Administrative që të sigurojnë që dëshmitari të jetë i
2 disponueshëm me 21 dhe 24 janar 2022. Këtu mbyllet urdhri me
3 gojë.

4 Z. Cadman, për sa i përket, a keni ndonjë përditësim në
5 lidhje me zotin Reid për të ardhur këtu për të dhënë dëshmi
6 këtu në Hagë?

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Rreth kësaj kohe kemi kontakt me të
8 dhe të shikojmë se çfarë do të thotë se çfarë do të thotë kur
9 të marrim përgjigje prej tij.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ai është
11 ideale që të vijë me datë 24 janar.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë në
14 rregull, do të japim një urdhër më vonë sot në lidhje me këtë.

15 Zoti Cadman, po kështu ju keni vënë edhe listën e emrave
16 pa shënimet tuaja. Keni ndonjë kundërshtim ju nga ZPS-ja në
17 lidhje me këtë listë? A dëshironi që t'i fusni si prova
18 materiale këto?

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo i nderuar Gjykatës përveç
20 DNH0870 që është pa shënime. Ne nuk po kërkojmë që të futen
21 këto si prova materiale me shënimet tona mbi bazën se këto
22 shënime konsiderohen se janë përmendur në dokumentet që janë
23 publike. Ne po kërkojmë që të futen si prova materiale vetëm
24 dokumentet që janë pa shënimet tona.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman (Vazhdim)

Faqe 5

1 marrim këtë parasysh dhe ju lutem Sekretare, jepini një numër
2 prove materiale.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të ketë numrin
4 DNH0870 dhe si numër prove materiale do të ketë 2D2.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, 2D2.

6 Zoti Cadman mund të vazhdoni me pyetjet kryesore për
7 dëshmitaren.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm një çështje desha të ngre që
9 ne e kemi lënë atë emrin e përsëritur në listë, se po ta heqim
10 atë ndikohen në referencat që bëhen në transkript.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

12 Zoti Haradinaj. Zoti Haradinaj më dëgjoni?

13 I AKUZUARI HARADINAJ: Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni ende nën
15 betimin, nën deklaratën që keni bërë dje. E kuptoni?

16 Deklaratën që do të thoni të vërtetën. Ju duhet të vazhdoni që
17 t'i përmbaheni asaj deklaratë. E kuptoni.

18 I AKUZUARI HARADINAJ: Kur bëhet një betim ai vlen, kështu
19 që unë jam i vetëdijshëm.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
21 Vazhdoni zoti Cadman.

22 DËSHMITARI: NASIM HARADINAJ [Vijon]

23 Pyetje nga z. Cadman: [Vazhdim]

24 Py. Mirëmëngjes zoti Haradinaj. Dje e ndërpreme ku sapo ishit
25 larguar nga zyrat e OVL-së dhe desha t'i kthehem kësaj edhe

1 një herë. Mbas kërkesës së policisë së Kosovës ju e shpërndatë
2 turmën. A mund t'i thoni Gjykatësve ku keni shkuar menjëherë
3 pas kësaj?

4 Pë. Unë e zhvendosa turmën prej rrugës që e kishte zënë
5 rrugën, kështu që turma nuk u shpërnda, kaloi në anën tjetër
6 të trotuarit. Kështu që u realizua ajo kërkesa e policisë që e
7 kërkoi dhe menjëherë sapo kam dhënë një intervistë shumë
8 shkurt aty, meqë ishin mbledhë shumë gazetarë, duke ju kërkuar
9 falje atyre se e kam një intervistë të caktume më përpara dhe
10 duhet me qenë në orën 5 aty, unë kam marrë një taksì që ka
11 qenë aty sepse aty përpara janë të stacionuar taksistat, para
12 ndërtese kam shku direkt për te TV7.

13 Py. Përpara sesa të largoheshit nga ai vend edhe na the që
14 kishte -- bisedove me policinë e Kosovës, a bisedove me ndonjë
15 prej Zyrës së Prokurorisë së Specializuar, aty në atë vend
16 para zyrave të OVL-së?

17 Pë. Unë kam pa vetë ata dy policët me uniforma ushtarake. M'u
18 s'mu ka afër dikush, as kam vërejt që ka qenë dikush aty

19 Py. Dhe është e vërtetë që në bisedën me policinë e Kosovës
20 askush nuk të tha që ti nuk duhet të largohesh prej aty, prej
21 zonës aty përpara të OVL-së?

22 Pë. Jo, jo, as policia e Kosovës as kurrkush.

23 Py. Pra, na the që ti u përpoqe të marrësh një taksì, a mund
24 të na e thuash edhe një herë ku po shkoje me atë taksì, ku
25 doje të shkoje me atë taksì?

1 Pë. Unë në fakt as e kam marrë taksin vetë, vetëm u kam thënë
2 "shko e thirrma aty një taksi" dhe s'di kush ka shku e ka
3 thirr një taksi, bile mbrapa meje ka ardhur ai djalë që e ka
4 porosit taksin. Ulun në taksi, unë e ju thashë që jam ka shkoj
5 në T7 me dhënë intervistë. Se ai ishte -- që po u desht me ju
6 kërkuj falje gazetarëve se ata donin ta vazhdonin intervistën
7 me mua aty përpara, gjithashtu dhe veteranët që ishin ulur
8 aty. Bile ne kemi bërë një takim të shkurtër me veteranët duke
9 thënë "të mbahet qetësia, të mos krijojë kush këtu precedent
10 për ndonjë problem a diçka, po vetëm qetë, sa më qetë".

11 Py. Pra, atëherë ke shkuar te stacioni televiziv T7, kë do të
12 takoje aty tek T7.

13 Pë. Unë kisha lënë takim me moderatorin e emisionit, Arsim
14 Lanin, në T7, që e ka programin e rregullt në ora 17.00. Është
15 ky një program që është i rregullt, me orar të caktuar, të
16 fiksuar

17 Py. A e kishe organizuar këtë intervistë edhe më herët gjatë
18 asaj dite apo jo?

19 Pë. Këtë intervistë ja kam pranë atij rrugës kah jam ardh
20 prej Deçanit në Prishtinë, që u nisa me ardh kur më thirri
21 Hysniu.

22 Py. Afërsisht sa kohë merr për me shku me taksi nga OVL-ja
23 tek T7?

24 Pë. Nuk kemi ba 10 minuta, si kemi ba 10 minuta.

25 Py. Kur ishte në taksi dhe po shkoje në studion e T7, a vure

1 re diçka gjatë kohës që ishe duke shkuar atje?

2 Pë. Unë jam ulur përpara në krah të vozitësit, në krah të
3 shoferit, në sediljen afër shoferit dhe të pasagjerit, nja 50
4 ma poshtë ka dalë nga krahu i djathtë i joni, një Jeep i madh
5 i EULEX-it. Ka dalë me rrëmbim prej krahut të djathtë, kishte
6 qenë i parkuar brenda, fshehtas jo kështu, është dalë prej një
7 rrugice edhe na ka ardhur mbrapa. Më bëri përshtypje dalja e
8 tij e shpejtë edhe normal që ishin edhe shenjat e tyre, por
9 nuk qe diçka që unë aty për aty mendova për diçka. Më vonë kur
10 pashë që nuk po len, sepse hyri një herë një kerr, na
11 parakaloi, na hyri në mes, kur kam pa që atij i ka dhënë atij
12 prapë ky, për me na parakalu për me na hy fill mas kerrit,
13 atëherë e dita që jam në përcjellje, mendova që jam vetëm në
14 përcjellje. Asgjë tjetër. Ma vonë kur kam shiku në rrugë për
15 me u siguru që është në përcjelljen tonë, i thashë vozitësit
16 "jep sinjal për me u kthy në krahun e majtë, por mos u kthe -
17 i thashë - se kemi me shku te T7". Më tha "pse" i thashë "jep
18 vetëm sinjal". Kur ka dhënë ai sinjal, menjëherë ka dhënë
19 sinjal edhe Jeep-i që ishte mbrapa. Prandaj aty e dita që aty
20 janë duke janë duke na përcjellë. I thashë "vazhdo, këta janë
21 jam mbas neve". Asgjë tjetër. Kam marrë telefonin, e kam thirr
22 moderatonin që e kisha të caktuar, sepse atje me hy në
23 televizion poshtë është një derë me kod, që ose duhet e dit
24 kodin ose duhet me i thirr me ta çelë ata prej së larti. Se
25 nuk kanë zile që është direkt tek ta. Do të thotë, zilja --

1 nëse i mëshon ziles në derë nuk shkon zilja ku i kanë ata
2 studiot. Shkon nëpër zyra të tjera, por jo aty. Kështu që nuk
3 kanë adresë të veçantë ku t'i mëshosh zilesh që është për tek
4 ta. Prandaj duhet ose një kod ose me zbrit ata vetë, e çojnë
5 një punëtor, përpara kur e kam pas intervistën që e kanë çel
6 derën. Unë e thirra Astritin i thashë "Astrit, mas meje është
7 një kerr i EULEX-it duke më përcjellë. Zbrit poshtë, - çelma
8 kodin se nuk e dija -, por si duket janë mas meje". Tha "në
9 rregull, po zbres poshtë vetë edhe e çeli derën". Kaq. Kur
10 kemi shkuar te dera afër, sepse hyrja është në një rrugicë, do
11 të thotë fill mbas Gjykatës Kushtetuese, në krahun e djathtë,
12 është rruga në krahun a majtë, rrugë e ngushtë, rrugicë, që
13 duhet në këmbë me hy, se s'ka tjetër, s'punon, s'mund të hysh
14 andej. Aty kam zbritur, kam dalë nga krahu i djathtë për me u
15 kthy në krah të majtë, fill mbas kerrit, kur kam dalë në anën
16 e majtë që e kam kalu tamam kerrin në anën e majtë, taksinë që
17 ishte, më kanë dalë ata që i kam pa dhe më kanë thënë "ndalu,
18 ndalu, policia, policia". Jam ndalur edhe njëri më ka dalë
19 para dhe më ka thënë "je i arrestuar", anglisht, tjetri... I
20 kam thënë "pse", në atë gjuhën tim angleze, sa disha unë.
21 Tjetri mbrapa më ka bërtit në gjuhën suedeze, më ka thënë "mos
22 luaj", "rër inte, rër inte" [fonetiksiht], që i binte, e di
23 saktë që më ka thënë në një suedishte të pastër. E kam parë
24 atë që është përpara që është Moberg dhe aty pastaj kam
25 filluar me e pyt "për ç'ka?". Ai u mundu me e nxjerrë një këtu

1 përpara që ka një varëse dhe aty kishte pasur një letër për
2 fundi a mundu me e nxjerrë me e lexu kështu. I thashë unë du
3 me qenë policia e Kosovës nëse jam i arrestuar. Aty e tutje
4 kemi filluar bisedën në gjuhën suedeze me të.
5 Py. Ti i the atij oficerit suedez, zotit Moberg, ke fol me të
6 në suedisht, i the që ai, i ke thënë atij që të priste derisa
7 të vinte policia e Kosovës. Si u përgjigj ai?
8 Pë. I kam thënë "thirre policinë e Kosovës", sepse ai ende
9 s'e kishte thirrur. I thashë "thirre policinë e Kosovës se du
10 me më arrestu me policinë e Kosovës së bashkë". Ka thirr dikën
11 në telefon nuk e di a ka thirr policinë a kënd e ka thirr dhe
12 më ka thënë "në rregull, por mos luaj deri [sa] të vijnë ata".
13 Aty kam ndejt, jam mbështetur për -- ka qenë një gard i
14 hekurit te dera, aty kemi ndej, kemi bisedu tema, kurrgjë
15 tjetër, deri kur kanë ardhur ata. Ndërkohë, njerëzit ju ka
16 interesu shumë - se u afruan gazetarët -, u ka interesuar
17 shumë ç'ka po foli me ta. Ka pasur që më kanë pyetur "në çfarë
18 gjuhe po flet me të zoti Haradinaj, ç'ka po të thonj?". Kam
19 thonë "kam urdhërarresti, jam ka fol suedisht, derisa të vijnë
20 policia e Kosovës me më marrë. Edhe pata me shku...". Edhe më
21 kanë thonë "ku je ka shkon?", e di që më kanë pyetur
22 gazetarët. Edhe ju thashë kesh ka shkoj në intervistë te T7 me
23 Arsim Lanin. Atëherë mu ka lajmëru prej së larti, Arsim Lani
24 edhe më tha "unë këtu jam Nasim" edhe e kam pa që ka qenë tuj
25 e incizu, ka pas media, është incizu edhe unë kjo pjesë krejt

1 komplet, që a dhanë në media.

2 Py. Sa kohë mbas kësaj bisede që bëre në fillim, sa kohë u
3 desh mbasi që erdhi e policia e Kosovës?

4 Pë. 10-15 minuta.

5 Py. Dhe mbasi erdhi policia e Kosovës, a mund të na e
6 shpjegosh se çfarë ndodhi atëherë?

7 Pë. Policia e Kosovës se ishte blloku rruga aty, se ajo rrugë
8 është ku u ndal taksia dhe u ndal në mes të rruge, në mes të
9 rruge, nuk është ndalë anash, por në mes të rrugës është
10 ndalur Fuori Stada, Jeep-i i EULEX-it, policët që më ndalën,
11 oficerët e këtyre i kanë pas disa probleme me qytetarët sepse
12 kërkonin me ja lëshu rrugën, janë kanë me fëmijë dhe ishin tuj
13 hequr fëmijët prej çerdheje, nuk mujshin me i marrë fëmijët
14 prej çerdheje, por këta nuk i kanë, nuk i kanë jep shumë
15 llogari. Dhe e di që ka qenë një debat mes këtyre oficerëve
16 dhe njerëzve, qytetarëve që lyshin me i marrë fëmijët e vet.
17 Kanë ardhur polica e Kosovës edhe ata janë ndalur nja 40 metra
18 ma poshtë. Edhe si janë ndalë ata unë e kam çu dorën me ju
19 tregu që jam këtu. Kanë ardhur, "përshëndetje Nasim",
20 "përshëndetje". Jemi përshëndet me dorë, normal edhe kanë
21 ardhur aty. I thashë këtij i thashë "jemi në rregull, kur të
22 duash mundemi me dhe zbatu atë". A mu ka afriu me hy në Jeep-
23 in, në kerrin e EULEX-it. Ju kam thënë "jo". Unë du me më
24 arrestu policia ime. Nuk jam ka e kontestoj arrestimin, du me
25 më arrestu policia ime. Du me hyp në kerrin. Tha "në rregull,

1 por hin këtu". Atëherë njëri polic u mundua me ba një si
2 kompromis, "po qe pra po hynë ne këtu". Thashë "jo - thashë -
3 a keni ju kerr të policisë, hyni ju në kerr të policisë",
4 thanë "po". "Në kerr tuajin". Është hamendësu ai oficeri pak,
5 nuk jam i sigurt a ka folur me dikën a s'ka fol, po janë ra
6 dakord që me hy në kerr të policisë, por tha "na duhet edhe
7 ne, oficerët e prokurorisë, me kanë me ty në krah". Thashë
8 "s'ka problem". Kemi hy në kerrin e policës së Kosovës, ka hy
9 edhe një oficer i tyre me mu, Moberg, saktë e di kush ka hy
10 edhe një policë në sediljen mbrapa, një polic i Kosovës,
11 Mober, unë në mes, Moberg, dhe dy policë para të Kosovës në
12 sediljet e para dhe kemi shkue deri në qendrën ku e kanë këta
13 te Fushë Kosova. Kemi hy brenda, e kemi kaluar atë traun, që
14 është trau i parë për me hy, kemi hy janë çelur dyert, kemi hy
15 në dyer, kur janë dalë aty, ka hy edhe ky kerri i policës, kur
16 jam dal aty prej kerrit, atëherë aty më ka thanë "tash je këtu
17 tek na". Kam thënë "në rregull", "tash duhet me t'i vu
18 prangat". Unë s'kam pasur pranga, deri në oborr, do të thotë
19 40 m në oborr të tyne, mi kanë vu prangat deri jam hi brenda
20 në objekt. Po i kam thënë, s'ka problem. Policia jonë janë
21 përshëndet edhe krejt në rregull. Sjelljet janë kanë të mira.
22 Fletëarrestit në fakt, q'atë që ka dasht me e lexu, kurrë s'ma
23 ka lexu edhe unë kurrë se kam parë deri sa më ka ardhur si
24 dokument këtu në burg kur jam ardh ma vonë masi jam dalë në
25 gjyq, për herë të parë.

1 Py. Mbas arrestimit dhe mbas kësaj që përshkrove që hyre tek
2 objekti i ZPS, sa kohë mbas kësaj je transportuar për në Hagë?
3 Pë. Unë menjëherë sapo jam futur aty brenda ka qenë një zyrë
4 e tyre, ka thënë ai që "Tash po përgatitemi. Këtu s'do të
5 qëndrosh kohë të gjatë". Më kanë lut "a don me pi ujë a
6 diçka". Më kanë pyet "a ke nevojë për ndonjë bar apo diçka". I
7 kam thënë që kam nevojë për syzet të leximit. Se më thanë që
8 shkon në Hagë menjëherë dhe çka janë të nevojshme. I kam thënë
9 "më duhen kokrrat e tensionit, të gjakut dhe syzet dhe një
10 palë çorape që unë i përdor për këmbën". Janë dalë, mi kanë
11 pru ato komplet edhe pritëm për me udhëtu me aeroplan siç [e
12 padëgjueshme]. Por ma vonë diku mas orës 6-7 të mbrëmjes. Se
13 një herë një kohë më kanë lënë vetëm në zyrë, nuk më kanë çuar
14 në qeli. Tu mendu që po shkojmë në aeroplan. Pastaj më tha "si
15 po të duket" thashë "sonte po mujt me ndej, do ta bëjsh natën
16 këtu, do të bujsh këtu dhe nesër në mëngjes po shkon në Hagë".
17 Në rregull, më ka çu në qeli dhe kurrgjë.

18 Py. Dhe në fakt ditën e nesërme të kanë transportuar për në
19 Hagë, apo jo?

20 Pë. Po, ditën e nesërme diku ka ora 9.30-10.00 jemi nis për
21 aty, më duket 11, nuk e di saktë. 11.30-12.00 më kanë çu te
22 një pjesë tjetër e aeroportit të Prishtinës, më kanë çuar e
23 një... ishte si një kontejner aty ma kanë bë një kontroll
24 mjekësor dhe aty më kanë thënë se "tash je në duart e
25 punëtorëve të kësaj Gjykate dhe përdorin të tjera pranga".

1 Sepse unë kam pas vetëm pranga në duar, ndërsa aty mi kanë heq
2 ato pranga dhe ma kanë [e padëgjueshme] rripin me gjithë
3 pranga tjetër lloj. Ma ka bërë kontrollin mjeku dhe jemi nis.
4 Më kanë thonë që nuk kemi përkthyes por për çdo gjë do të të
5 shoqëron njëri prej këtyre oficerëve që e dishin suedishten
6 dhe më ka shoqëru oficeri që din suedishten i dyti, jo
7 Mobergu, ky i dyti që më tha atje në suedisht "mos luaj". Janë
8 sjellë mirë. Aty e di që jam kenë nën vëzhgim të kamerave
9 komplet. Na u ka shërby vetëm pije të ftohte më ka thënë --
10 kam kërkuar çaj, më kanë thënë se nuk është e lejueshme. Nisem
11 veç ma në rregull. Sjellja po në nivel, kam qenë i vetëm në
12 aeroplan.

13 Py. Zoti Haradinaj, kam disa pyetje të fundit që dua t'i bëj
14 dhe ju lutem përgjigjuni sa më shkurt. Tani Prokuroria
15 pretendon se ju keni vepruar në mënyrë të paligjshme me 7 dhe
16 me 22 shtator.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj i nderuar Gjykatës, po
18 i kërkon të akuzuarit nëse beson që ka kryer krime dhe kjo i
19 takon që ta bëjë Paneli.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E hedh poshtë
21 këtë kundërshtim, vazhdoni, përgjigjuni.

22 I AKUZUARI HARADINAJ: Zoti avokat, unë po mendoj që ma
23 mirë po mendon Prokurori për mu, ky e din që s'kam bërë gjë
24 hiç. Kështu që unë se di veten as atëherë as tash. Sepse unë
25 edhe e thashë dhe po e them, kam pas vetëm një qëllim,

1 transparencën dhe interesin publik.

2 Kam dhënë vërejtjet e mia që unë besoj që çdo qytetar i
3 lirë i një shteti demokratik. Janë bazë, janë parim, që për
4 këto sende me fol haptazi. Unë për këto jam burgosur, se i kam
5 ato vite që përmenda në shtetin komunist që shteti janë -- dhe
6 njerëzit për me e pasë këtë liri kam sakrifiku veten. Kështu
7 që do të ishte absurde nëse unë tash dal kundër transparencës
8 dhe interesit të përgjithshëm. Kështu që nuk e ni vetëm që kam
9 ba. Kjo është ajo që më ka shty me i ba.

10 Py. Gjatë të njëjtës periudhë, a ke kërcënuar apo je munduar
11 të frikësosh ndonjë dëshmitar?

12 Pë. S'kam pas arsye, as kam pas arsye, as nuk jam i tillë, as
13 nuk kam pas në jetën time dikënd kërcënim unë, qoftë edhe
14 privat me dikën. Edhe kur e kam ndjerë veten të kërcënuar unë
15 s'i jam kërcënuar kurrkujt.

16 Py. Gjatë të njëjtës periudhës a ke marrë hak ndaj ndokujt që
17 ka dashtë të japë dëshmi?

18 Pë. Nuk më ka bërë kurrkush kurrgjë që unë me pas të drejtë as
19 me i lyp llogari as hak. Po s'kam pas të drejtë me i lyp
20 kurrkujt as llogari.

21 Py. Me përjashtim të zyrtarëve serbë që i përmende, që janë
22 në listë dhe dy personat e tjerë që i përmende që i kanë emrat
23 në publik, që njihen publikisht a ke nxjerrë identitetin e
24 ndonjë dëshmitari tjetër? APë. [e padëgjueshme] as të një emër
25 asnjë dëshmitar as e kam përmend as e kam përmend as që e kam

1 nxjerrë. As e kam proklamuar apo shpërndarë.

2 Py. Prokuroria pretendon se ju keni përdorur fjalët "spiun,
3 tradhta" dhe kur i ke përmendur këto fjalë, e ke pasur fjalën
4 për dëshmitarët. Për kë e ke pas fjalën ti kur ke përmendur
5 këto fjalë "spiun dhe tradhtar".

6 Pë. Të jem i sigurtë, këtu po shihet haptaz dhe Prokuroria
7 shpesh fjalët po i spekulon. Ose duhet me pranuar që nuk dinë.
8 Dhe po i referohet kësaj "spiunët" e dinë krejt bota se kush
9 janë. Spiunët janë bashkëpunëtorët e regjimit komunist në atë
10 kohë, që më kanë përcjellë dhe që vazhdojnë fatkeqësisht
11 vazhdojnë të jenë në krye të qeverisë treme. S'ka të bëjë me
12 spiunë të këtyre. Dhe bashkëpunëtorët janë ata që janë të
13 cilët që edhe gjatë kohës së luftës, fatkeqësisht shqiptarë,
14 që unë po lypja edhe ata kjo Prokurori t'i hetojë, kanë kryer
15 krime së bashku me forcat serbe. Përpos nacionalitetit tjetër,
16 përpos nacionalitetit serb që i janë bashkuar asaj ushtrie, ka
17 edhe shqiptarë që i janë bashkuar siç qe rasti i [REDAKTUAR] [e
18 padëgjueshme] e shumë të tjerëve që i dinë këta saktë po i
19 kanë si dëshmitarë këtu. Të sigurimit jugosllav, nuk ka tash
20 spiunë, s'mundet me pas spiunë tash.

21 Py. A keni publikuar ju vetë ndonjë material që ndodhej në
22 ato dokumente?

23 Pë. Unë jo vetëm që s'kam publikuar, unë as kam fotografuar ato
24 dokumente kurrë vetë. Unë ka ndodh që i kam "pëlqy" kur mediat
25 i kanë qit ose i kam shpërndarë në Facebookun-n tim. Nuk ka foto

1 e shpërndarë, qoftë në media, qoftë në Facebook, që është
2 marrë drejt e drejt prej meje. Unë i kam këqyr, i kam pëlqy,
3 ka ndodh që edhe e kam pëlqy, normal që i kam pëlqy dhe ka
4 ndodh që i kam shpërnda fotot që i ka qit media. Asnjëherë
5 edhe unë s'besoj që e ka bo askush, por për vete jam shumë i
6 sigurt që nuk kam fotografu, qoftë edhe një dokument që edhe e
7 kam mundësi me e bë. Se s'ishte ai qëllimi jonë. S'e kemi
8 marrë përsipër ne si organizatë atë si detyrë. Se me e pas
9 marrë përsipër atë detyrë, ne nuk ja kishim dhënë mediave. Dhe
10 qëllimi ka qenë që vetëm të mos gabojmë. Për atë jua kemi
11 dorëzu mediave që janë më profesionalistë se ne, më të [e
12 pakuptueshme] se ne. Kaq, kurrë, asnjëherë. As kam qit në
13 foto, as kam kërcënu kënd, as kam thirr kënd me i thënë vetëm
14 "pse", asnjëherë.

15 Py. I jeni përgjigjur pyetjes përpara pjesërisht, por do jua
16 bëj prapë. A keni kopjuar apo keni mbajtur kopje të
17 materialit?

18 Pë. As kemi kopjuar sepse s'kemi dasht me kopju as kemi
19 mbajtur kopje. Kopjet që i kanë lënë gazetarët, kanë qëndru
20 aty dhe s'është marrë kurrkush me to deri sa janë ardh dhe i
21 ka marrë përfaqësuesi i këtyre, dëshmitari 1.

22 Py. A keni ushtruar presion mbi ndonjë prej gazetarëve për ta
23 nxjerrë apo publikuar materialin?

24 Pë. Shiko, unë nuk kam ushtruar presion, kam replikuar me
25 njerëz kur kanë tentuar me më shti mu personalisht ose

1 organizatën që ne me i publiku, duke na thënë "pse po tuteni,
2 pse s'po guxoni, pse s'po i qitni vetë, pse po na thirrni ne".
3 Këtu kam replikuar me ta dhe ju kam thënë "Ju jeni ata
4 profesionalistat, ju jeni ata që e dini çka bëni, ne kemi
5 detyrë me tregu vetëm çka na ka ardh, është çështje e juaj çka
6 bëni, por jo me mësu mu çka me ba". Se unë me pa dasht, biles
7 është e incizuar kjo, me pa dashtë, unë i kisha qit vetë. S'ka
8 pas presion.

9 Py. A mendonit apo mendoni tani, pra, aso kohe a mendonit se
10 përmes zhvillimit të konferencave për shtyp, pra këto
11 konferenca për shtyp mund të kishin ndikim negativ te
12 dëshmitarët?

13 Pë. E vetmja gjë që kam menduar, që ka ndikim pozitiv ka qenë
14 arsyeja transparencës dhe e interesit publik. Asnjë gjë
15 negative s'kisha mendu se unë nuk jam i prirur me ba gjëra
16 negative. Ba me mendu për gjëra negative unë s'e kisha bërë,
17 kështu që ka qenë në dorën e tjetërkujt. E jona ka qenë vetëm
18 me tregu çka na ka ardhur.

19 Py. A keni penguar, kërcënuar apo kërkuar të dëmtoni ndonjë
20 prej anëtarëve të ZPS-së?

21 Pë. Askush ma mirë se këta nuk e dinë, vetëm nëse dojnë hala
22 me vazhdu me shpifje me gënjeshtër, askush ma mirë se oficerët
23 e tyre nuk e dinë. E para, unë s'kam njoft kurrkënd prej
24 këtyre. Në jetën time skam pas fare kontakt me këta deri në
25 atë datë që kam takuar dëshmitarin 1. Në jetën time s'jam

1 marrë vesh me fol me ata, a me bo diçka a të kem telefon të
2 tyre. E dyta, edhe me pas dasht me i kontaktu, ne s'kemi pas
3 asnjë lidhje me ta për me i thirr, asnjë numër asnjë send. Ma
4 ka lënë një farë kartëvizit, kur kanë qenë, neve na e ka lanë
5 q'aty. Por as e kam përdor, as kam pas nevojë me thirr. Dhe me
6 i pa nëse kisha kërcënu kisha mujt me i kërcënu vetëm këta,
7 vetëm dëshmitarin 1 e ata le ta pyesin, a e kam thirrur a kam
8 folur me të. Kurrë, kurrë, kurrë.

9 Py. Gjatë të gjithë dëshmisë tuaj keni thënë që dëshironi që
10 të gjithë ata autorët, kriminelë që kanë kryer lufte dhe krime
11 kundër njerëzimit gjatë çlirimit, duhet të japin llogari
12 përpara kësaj Gjykate. Përse është e rëndësishme kjo për ju?

13 Pë. Për mua, vetëm një i çmendur, i sëmurë psiqik, thotë që
14 duhet me qenë të mbrojtur kriminelët. Ose vetë një kriminel që
15 është. Unë po ta them këtë fjalë, unë atëherë duhet me pranë
16 që jam kriminel. Kështu që më së pari nuk e bëj këtë gabim
17 ndaj vetvetes si person. Është e nevojshme sepse njerëzit të
18 cilët janë të dëmtuar [e padëgjueshme], duhet ta dijnë se kush
19 i ka dëmtuar. Por edhe njerëzit të cilët kanë dëmtuar, është
20 shumë mirë me e marrë dënimin e merituar. Por kjo formë që
21 është kështu, po ju garantoj, po them edhe këtu, këtë drejtim
22 me kriminelët tuj i marrë si dëshmitarë në kuptimin po flas
23 për këtë listën këtu, ky drejtim ka me i çu aty ku kurrë
24 s'kanë me u zbulu ose është qëllimisht që të dëmtohet Kosova
25 jo individë.

1 Py. Prokuroria pretendon se synimi juaj është që ta mbyllnit
2 këtë institucion. Si do t'i përgjigjeshit kësaj?

3 Pë. Prokuroria, ndoshta i konvenon me thonë ashtu, por -- dhe
4 le të pretendojë. Po unë shyqyr që është drejtësia dhe tash po
5 ballafaqohem me të. E vërteta është këtu, ne kemi lyp që kjo
6 Prokurori - edhe po e them edhe sot edhe jam ka e kërkoj edhe
7 këtu para Gjykatës -, të ndërrojë këtë orientim. Sepse ma së
8 pari nderohet vetë, ma së pari del e fitime vet. Se unë mendoj
9 është nder për një Prokurori ta zbulojë një krim dhe ata ta
10 dëshmojnë. Në këtë formë a ka mundohet me e zëvendësu krimin
11 me dikënd tjetër dhe unë e kam kërkuar dhe ne si organizatë
12 kemi kërkuar që të amandamentohet -- të futet vetëm fjala "të
13 gjitha krimet, pa marrë parasysh kush i ka kry në Kosovë dhe
14 nga të gjitha grupet etnike". Nëse kjo nuk bëhet dhe me
15 precedentët që i ka krijuar vazhdimisht kjo Prokurori, që na
16 ka provokuar me reagu dhe në një farë mënyre na ka thirr dhe
17 do të ishim shumë injorant të ishim tregu po të mos kishim
18 reagu, ne kemi thënë "nëse këta nuk ndryshojnë" kur afati të
19 cilin këta vetë e kanë caktu në gusht 2020, që ju skadon afati
20 5 vjeçar, unë kam kërku të mos i vazhdohet afati, nëse veç nuk
21 i ndjek të gjitha krimet. Nëse këta e quajnë këtë bllokadë,
22 atëherë kështu kam menduar. Jo bllokadë por kam menduar që të
23 mos vazhdohet afati, se në fund të fundit, afatin as e kam
24 vendosur unë, po e kanë vendos këta vetë. Kështu që kam thënë
25 të mos vazhdohet ma [e padëgjueshme]. Edhe prapë kërkoj këtu

1 nga kjo Prokurori, të mos vazhdojë me ndjek këtë rrugë që ka
2 vazhdu. Mos të vazhdojë me rahabilitu kriminelët sepse të
3 marrësh një dëshmi nga kriminelët e sidomos serbë, nuk po i
4 quaj kriminelë pse janë serbë, po pse janë të dëshmuar se kanë
5 kryer vetë ekzekutime dhe kanë dhënë urdhër gjatë ekzekutimit,
6 këta normal që për këta, patologjikisht janë të edukuar që
7 shqiptarët janë fajtorë. Unë s'dua ta përjetoj në shtetin tonë
8 të pavarur, prapë një sistem ose një gjykatë të Kosovës që
9 është edhe ma e rreptë se gjykatat serbe në 1981, në raport --
10 më fal e thashë Gjykatë, e kam fjalën gjithmonë te Prokuroria,
11 në raport me kohën që jetojmë sot, 40 vite më vonë. Kjo është
12 ajo. Dhe nëse është e tillë, prapë po them, jam kundër dhe në
13 këtë formë që po shkon kjo Prokuroria, veç me rastin tim që po
14 e shoh, unë jam kundër, e kundërshtoj 100%.

15 Py. A mund të konfirmoni se që prej momentit që keni shprehur
16 shqetësimet tuaja publikisht, asnjëherë ZPS-ja nuk provoi që
17 t'i ngrinte edhe t'i diskutonte këto shqetësime me ju?

18 Pë. Përkundrazi më duk keq i ka shpjegu krejt rastet që kanë
19 ndodhur. Le që s'ka dëshirë me fol, nuk ka afër, po na kanë
20 neglizhu, na kanë injorë dhe tash po e di qëllimin. Tash po e
21 di qëllimin, të gjitha këto provokime i ka bërë për me na heq
22 ne, për me na pru këtu. Por besoj që në fund do të
23 ballafaqohemi me drejtësinë edhe e shohim. Nëse është urdhri i
24 koordinatorit të tyre dhe fjala koordinatorit të tyre, që këta
25 e kanë, do të thonë emri është 2-shi, nëse ai vendos dhe sipas

1 atij, unë veç jam dënuar në janar 2021 unë e kam marrë dënimin
2 e tij publik në televizion. Kështu që nëse ai është, unë -
3 mirëpo kjo nuk më ofendon, aspak.

4 Py. Në bazë të kësaj, pas kësaj, pasi i bëtë publike
5 shqetësimet tuaja, pasi i ngritët përpara qeverisë kosovare
6 dhe organizatave ndërkombëtare dhe nëpërmjet diskutimeve
7 publike që përmendët dëshminë tuaj, si mendonit ju atëherë, a
8 kishit alternativë tjetër?

9 Pë. Kam pas veç një alternativë. Me u detyru me e lëshu
10 Kosovën sikur jam detyru me e lëshu në kokën e Titos, -- të
11 Millosheviçit. Veç këtë alternativë e kam pasur. Atë s'kam
12 dashtë me e përsëritë më edhe s'kam dashtë me e kthy atë kohë
13 në vendin tim. Vetëm kjo ka qenë alternativa me e lëshu
14 Kosovën.

15 Py. Dhe së fundi, zoti Haradinaj, a besoni se veprimet tuaja
16 i justifikonte interesi publik?

17 Pë. Patjetër, patjetër pastaj edhe për këtë interes, ata
18 kërkonin. Por du me e potencu edhe një herë, asnjëherë nuk
19 kemi inicizu edhe intervistat që kemi dhënë ne, nuk janë
20 intervistat që i kemi iniciunë në televizion. Ne jemi thirrur
21 si një anëtar i një paneli të cilën e ka themelu televizioni,
22 meqenëse ishte interes publik. Edhe ka qenë në interes publik
23 edhe është edhe sot me interes publik dhe duhet ta dini se në
24 qendër të Kosovës në interesin ma të madh sot për sot është
25 puna e kësaj Prokurorie por edhe e Gjykatës.

1 Py. Faleminderit zoti Haradinaj, nuk kam më pyetje të tjera
2 he për he. Prokuroria do t'ju bëjë pyetje edhe Mbrojtësi i
3 zotit Gucati mund të ketë pyetje. Unë ju kërkoj që të mos
4 harroni urdhrat që kanë dhënë të nderuarit Gjykatës në
5 përgjigjet tuaja për të siguruar përkthimin.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Bowden
7 keni pyetje?

8 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling,
10 fjala është për ju.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

12 Pyetje të palës tjetër nga z. Halling:

13 Py. Mirëdita, zoti Haradinaj. Mua më quajnë Matt Halling.
14 Përfaqësoj Prokurorinë sot dhe do t'ju bëj pyetje.

15 Dëshiroj ta filloj duke ju treguar një video.

16 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares të nxjerrë
17 videon P1 me vulën kohore 07:05-08:08, kjo pjesë e videos
18 është publike për ata që duan ta ndjekin në anglisht, është
19 transkripti në faqen 3 të P1-ETRED.

20 Py. Zoti Haradinaj do ta ndjekim këtë video të shkurtër dhe
21 do t'ju bëj disa pyetje.

22 I AKUZUARI HARADINAJ: Në rregull.

23 [Luhet videoincizimi]

24 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë e kuptova
25 nga më përpara që përkthyesit duhet ta përkthenin në anglisht

1 këtë. Unë nuk dëgjova përkthim por me lejen tuaj mund ta lexoj
2 këtë pasazh për regjistrimin.

3 Py. Zoti Haradinaj, ju e dëgjuat se çfarë u tha në video apo
4 jo?

5 Pë. [E padëgjueshme]. Unë e dëgjova fort mirë se në çfarë
6 konteskti ti po don me qit këto, luan pak rol. Unë po t'i
7 përsëris edhe një herë, unë pajtohem plotësisht me çfarë kam
8 thënë.

9 Z. HALLING: [Përkthim]

10 Py. Zoti Haradinaj, ju këtu jeni i vetmi nga ne që jemi këtu
11 -- ose më saktë dua ta them këtu, dua ta lexoj pasazhin që ju
12 thatë në anglisht. Një moment ju lutem sa ta lexoj në
13 anglisht. Kjo u tha këtu që:

14 "Shpresoj që ju media por edhe media që janë marrë kaq
15 shumë me këto analizat do të kenë me çka do të merren. Mendoj
16 se kjo Gjykatë do të paguajë çmimin e vet. Të thuash që këto
17 janë konfidenciale, top sekret, për dokumente që kanë dalë,
18 janë rrjedhur, është skandaloze është e turpshme edhe t'ia
19 përmendësh emrin, nuk ekziston më. Ajo që është më keq i ka
20 keqorientuar dëshmitarët duke u thënë që do të mbrohen këta
21 emra, këta mbiemra, këto shënime. Tani duhet ta dinë që këto
22 janë emra të ditur dhe askush nuk është që nuk dihet më sepse
23 vendi i saktë, fletëthirrja e saktë, deklarata e saktë, të
24 gjitha këto deklarata, deklarata tjetër janë këtu të
25 përfshira."

1 Zoti Haradinaj, u thatë dëshmitarëve që emrat tani dihen,
2 pra, siç është në këtë. Pra janë emrat dëshmitarët që më
3 përpara nuk diheshin, kështu?
4 Pë. [E padëgjueshme]. Dëgjo zoti Prokuror, më vjen keq që
5 bisedën e parë po e fillojmë kështu dhe po më detyron me të
6 thënë "mos spekuloni". Ti mos spekuloni me më kallxu kujt i thashë
7 unë. Unë nuk u thashë dëshmitarëve, unë t'u kam drejtuar ty, ty
8 si Prokurori ose ju si Prokurori për skandalin që e keni bërë.
9 Prandaj mos spekuloni ti, me mendimin tënd, se kujt i kam thënë
10 unë. Dëgjo mirë, përkthe mirë dhe e sheh. Juve ju jam
11 drejtuar, në skandalin e juaj. Ju, ju e keni shkatërruar, ju
12 kam thënë edhe këtu, ju e keni shkatërruar vetveten. Dhe
13 dëmet, nëse mendon që janë krijuar deri tash, zoti Prokuror i
14 keni krijuar ju, me fajin e juaj ose me qëllimin e juaj se
15 s'dua të besoj që në këtë Prokuroria ka aq analfabetë sa lejon
16 me i ndodhë kjo çka i ka ndodhë. Plotësisht, por jo
17 dëshmitarëve, nuk jua jam drejtuar dëshmitarëve, por ju si
18 Prokurori. Çmimin normal ai që e bën, duhet me i pagu. Prandaj
19 ju jeni ata që duhet me i pagu këtë çmim. Daljen jeni ju që
20 duhet me dhënë përgjegjësi për këtë dalje dhe mbrojtjen jeni
21 ju ata që e keni premtuar dhe keni lyp një krijim të kësaj. Dhe
22 Parlamenti ynë jua ka aprovuar dhe prapë nuk e keni bërë. Është
23 përgjegjësi e juaja edhe po ju them, ju jeni fajtor. Ju ose
24 dikush nga ju është dasht me kanë i ulur këtu. E keni këtë
25 mundësi financiare, politike, edhe prapë po të them, politike

1 dhe më keni sjellë këtu. Kaq.

2 Py. Kërkoj ndjesë. Zoti Haradinaj, ju lutem përgjigjuni
3 pyetjes që ju bëra. Pyetja ishte kjo: dëshmitarët emrat e të
4 cilët ju i patë, a ishin emra të cilët më përpara nuk
5 diheshin? Ju lutem përgjigjuni kësaj pyetjeje.

6 Pë. Ti më pyet mua çka kam pa apo çka kam thënë? Të lutem
7 sqaroje pyetjen se për mua është me dy qëllime kjo pyetje. Çka
8 kam pa apo çka kam deklaruar unë.

9 Py. Zoti Haradinaj, kur po përmendnit dëshmitarët, emrat në
10 këtë pjesë, për këta dëshmitarë e kam fjalën. Ata emrat për të
11 cilën ju e kishit fjalën, a ishin emrat që më përpara
12 diheshin?

13 Pë. Zoti Prokuror fjala "dëshmitar", është vetëm "dëshmitar".
14 Emrin ngjitja ti. Ti jua ke ngjit emrin, unë s'kam përmend
15 emrin. Nëse fjala dëshmitar është e dënueshme këtu, atëherë
16 këtë vepër penale jemi ka bëjmë që prej që kemi filluar këtë
17 gjyq sepse po i përmendim dëshmitarët. Fjala dëshmitar është
18 term i përgjithshëm që e din ti shumë mirë. Unë vetë mundem me
19 thënë që ka dëshmitarë të manipuluar edhe ka edhe dëshmitarë,
20 po ta plotësoj këtë. Për ndryshe nuk kanë emërtim këta
21 dëshmitar. Ata emrat që kanë qenë aty, unë nuk kam përmend
22 asnjë që s'ka qenë minimum pesë vite përpara i ditur dhe
23 publik.

24 Py. Emrat e dëshmitarëve për të cilët e kishim fjalën në këtë
25 ekstrakt, më përpara nuk ishin emrat të ditur, kështu?

1 Pë. E para, unë nuk e di në këtë ekstrakt, veç këqyre, e para
2 në këtë ekstrakt edhe sa janë kanë dhe kush janë kanë. Kam
3 mujt me e lexu ndonjë përciptazi por edhe ata që kam lexuar
4 unë kam përmend vetëm emrat, që minimum thashë edhe një herë,
5 prej që jeni kriju, hala edhe pa u kriju ju si Gjykatë, në
6 proceset e Salustros, këta emrat kanë qenë publik. Dhe të kam
7 mbetur borxh në përgjigjen më parë, që nuk dihet kam thënë,
8 nuk dihet - është nuk dihet sepse e thashë edhe dje këtu, nuk
9 dihet, sesa kujt ma i keni dërgu këtë dërgesë që na keni dërgu
10 ne, këtë material. Prandaj kam thënë këtë fjalë "nuk e dihet".
11 Edhe sot po them, nuk dihet. Sepse ju që na keni pru ne ato,
12 ose kushdo që na i ka pru, e ka pas mundësinë me ja çu kujtdo.

13 Py. Zoti Haradinaj, për çfarë e kishit fjalën kur thatë që
14 "ta dinë tani se janë emrat të ditur dhe se askush nuk është
15 më që nuk dihet".

16 Pë. Veç pra, veç po duhet me të përkthi ose ke problem ose
17 vetë po bën se s'po e kupton, prandaj "ta dinë tani Prokuroria
18 Speciale se çka i kanë ba vetes dhe sa e kanë dëmtu veten".

19 Kaq.

20 Py. Zoti Haradinaj a donit ju që dëshmitarët në materialet
21 për të cilat e kishim fjalën në datën 7 shtator, a donit që
22 këta dëshmitarë ta dinin se -- ta dinin që kush ishin dhe
23 çfarë thanë ata, tani dihej?

24 Pë. Zoti Prokuror edhe një herë po ta sqaroj, ti po ke qejf
25 me gjuajt peshk në ujë të turbullt. E para edhe sot ti vete

1 nuk e ke konfirmu që këtu që materiali është i juaj, hala deri
2 sot. E dyta - përpos asaj pjesës që po doni me na dënu. E
3 dyta, ne s'kemi nevojë me e ditë, a s'keni nevojë ta dini, ju
4 pyeteni veten që a keni dashtë që tjerët ta dinë ose të paktën
5 ne Organizata që na keni sjellë apo jo. S'ka qenë kjo dëshirë
6 kjo e jona, e s'është varur as prej dëshirës tonë, as
7 mundësisë tonë.

8 Py. Zoti Haradinaj, nuk iu përgjigjët pyetjes time. Edhe një
9 herë, nëse kam bërë apo jo pyetje të mira apo nëse po peshkoj,
10 nuk ju takon juve ta thoni si dëshmitar. Mund të ndërhyjë
11 avokati juaj apo Trupi Gjykses nëse bëj një pyetje të
12 papërshtatshme. Po e bëj edhe një herë pyetjen. Dëshmitarët
13 për të cilët ju e kishit fjalën në këtë ekstrakt, a donit ju
14 që këta dëshmitarë ta dinin se tashmë dihej se kush ishin ata
15 se çfarë kishin thënë ata?

16 Pë. Po i drejtohem Panelit Gjykses, zoti Gjykatës ose
17 përkthyesit, këta nuk është tuj e përkthyer mirë çka e thashë
18 unë ose prapë Prokurori po spekulon. Asnjëherë, për asnjë
19 moment deri tash unë këtij nuk i thashë si e ka bën pyetje të
20 mirë. Kështu që mos spekulon se nuk të thashë ose po jua tërheq
21 vërejtjen përkthyesve atje se këtë fjalë që "nuk po bën pyetje
22 të mirë", unë nuk e thashë këtu. Të lutem kthejeni edhe një
23 herë në gjuhën shqipe e përkthejeni. Asnjëherë nuk e thashë.
24 Thashë për gjuan në ujë të turbullt. Nuk thashë "a po bën
25 pyetje të mirë a të keqe". Për mua asnjë pyetje, janë të tuat,

1 çfarë t'i bësh, ashtu t'i pranoj. Edhe është e vërtetë që unë
2 s'i vlerësoj pyetjet a janë të mira a janë të këqija. Ti i bën
3 në favorin tënd të mira dhe unë i jap përgjigjet në favorin
4 tim të mira dhe të drejtës dhe të transparencës. Se ty nuk të
5 konvenon, unë zoti Prokuror, të kuptoj se drejtësia është
6 mbret dhe është e ashpër.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
8 Haradinaj, është e nevojshme që t'u përgjigjeni pyetjeve që
9 jua bën Prokurori në kundrapyetjet që ai bën. Në fakt, ju po
10 komentoni për cilësinë e pyetjes dhe nuk ju takon ta bëni
11 këtë. Pyetja kërkonte "po ose jo" si përgjigje. Kështu që e
12 keni për detyrë të jepni "po ose jo" si përgjigje. Tani po jua
13 them pasi zoti Halling t'ua bëjë edhe një herë pyetjen.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

15 I AKUZUARI HARADINAJ: A thashë a nuk thashë [e
16 padëgjueshme].

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
18 Haradinaj --

19 I AKUZUARI HARADINAJ: Du me fol --

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jua fika unë
21 mikrofonin sepse nuk po përgjigjeshit. Është e rëndësishme t'a
22 dëgjoni Prokurorin dhe t'i përgjigjeni pyetjes pa mbajtur një
23 fjalim se çfarë mendoni ju për cilësinë e pyetjeve të tij.
24 Pra, nuk ka nevojë të përgjigjeni tani. Ju kërkohet tani që të
25 dëgjoni pyetjet e zotit Halling.

1 I AKUZUARI HARADINAJ: Në rregull.

2 Z. HALLING: [Përkthim]

3 Py. Zoti Haradinaj përgjigjuni me "po" ose "jo", dëshmitarët
4 për të cilët ju e kishit fjalët në këtë ekstrakt, a donit ju
5 që këta dëshmitarë tani ta dinin se dihej tashmë se kush ishin
6 dhe çfarë kishin thënë?

7 Pë. Jo.

8 Py. Pse the publikisht se askush nuk është i paditur dhe që
9 deklaratat janë dhënë dhe të gjitha materiale dhe janë të
10 gjitha në materiale?

11 Pë. Kam komentu punën e juaj.

12 Py. Dhe ju komentuat për atë punë në formë publike, a është
13 kështu?

14 Pë. Nuk është hera e parë që ju kam komentuar ju. Veprimi
15 juaj ishte publik, interesi i transparencës dhe interesi
16 publik ishin publik, prandaj dhe në mënyrë publike.

17 Py. Zoti Haradinaj, në deklaratën tuaj që është futur si
18 provë materiale në paragrafin 101, ju thoni që ZPS-ja nuk ka
19 mbrojtur as dëshmitarët e vet që i ka premtuar atyre mbrojtje.
20 Ju e kishit fjalën që shpërndarja e dokumenteve konfidenciale
21 të ZPS-ë i ka shkaktuar dëm dëshmitarëve, a është kështu?

22 Pë. E para, ne nuk e kemi ditur a janë konfidenciale a
23 s'janë. E dyta, s'kemi ditur as a janë autentike a s'janë. E
24 treta, na kemi prapë dyshimet tona që është material vetëm
25 ndoshta me manipulu dikush. Ne nuk kemi pasur atë siguri me

1 deklaru këto ç'ka t'i po deklaron.

2 Py. Zoti Haradinaj, kur të erdhën dokumentet e ZPS aty, kur
3 erdhën tek ju, a i shkaktuan këto dëm dëshmitarëve?

4 Pë. Asnjëherë s'na u ka thënë ne decidivisht që materiali i
5 ZPS -- na u ka thënë vetëm që dojn me i marrë. Dhe u ka
6 shkaktu dëm a s'u ka shkaktu dëm, nuk është vlerësimi jem. E
7 dini ju.

8 Py. Kur thatë në deklaratën tuaj që ZPS-ja nuk mbrojti as
9 dëshmitarët të cilëve ju kishte premtuar t'i mbronte, a është
10 ky vlerësimi juaj, që këta dëshmitarë nuk po mbroheshin më?

11 Pë. Unë nuk e di sepse unë s'punoj tek ju dhe s'e di a i
12 mbroni a s'i mbroni. Dhe e dyta, unë e thashë edhe një herë,
13 ju duhet ta vlerësoni vetë, nëse ai material më së pari është
14 autentik dhe pastaj a po krijon dëm apo s'krijon dëm. Nëse
15 është i juaji e keni qit ju me qëllim unë mendoj se s'ban dëm
16 se ju e keni qit ose me bë dëm ose mos me bë dëm. E keni
17 përcaktuar ju. Unë jap vlerësimin që mendoj që -- dhe
18 gjithmonë këtu ju referohem vetëm juve, asnjëherë dëshmitarëve
19 ku ju po pretendonit.

20 Py. Zoti Haradinaj, ju e dinit që në qoftë se do të
21 nxirreshin emrat e dëshmitarëve ata do të frikësoheshin për
22 vdekje. A nuk është kështu?

23 Z. BUCKLEY: [Përkthim] Ne e kundërshtojmë, sepse
24 Prokurori përdor një gjuhë shumë emotive, "frikësoj për
25 vdekje" - a është gjuhë kjo e përshtatshme që të përdoret në

1 Gjykatë?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
3 riformulojeni, është pak e tepruar.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Do ta riformuloj. Ndoshta mund të
5 jetë më e lehtë që të lexoj një paragraf të deklaratës së
6 zotit Haradinaj. Këto janë paragrafët -- është dokumenti 104-
7 191 deri 104-400, paragrafi 19.

8 Py. Zoti Haradinaj, do t'ju lexoj një paragraf nga një
9 dokument paraparak që ka dorëzuar avokati juaj.

10 "Pavarësisht jo vetëm unë isha i shqetësuar dhe e kisha
11 parasysh këtë çështje, por kishte edhe një çështje më të madhe
12 që vihej në pyetje, kjo ishte rrjedhja e dokument të ZPS-
13 është, që kishte treguar që ka mungesë sigurie të theksuar. Ky
14 është një shqetësim i madh që këto dosje të nxjerra përmbanin
15 emrat e dëshmitarëve. Ky është një shqetësim i madh se ky
16 informacion në qoftë se do të nxirrej, mund të shkaktonte
17 vdekjen e tyre ose mund t'i frikësonte për vdekje. Këta
18 dëshmitarë, pra nxjerrja e emrave të këtyre dëshmitarëve dhe e
19 këtij informacioni ndërkohë që ata mendonin se këto emrat emra
20 nuk do të nxirreshin asnjëherë."

21 Zoti Haradinaj, a e keni thënë ju këtë?

22 Pë. Ka mundësi ta shoh në gjuhën shqipe, e kam vetëm në
23 anglisht. Nuk po di ku ka referohet edhe pse e dëgjova në
24 shqip por po du me e shoh.

25 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk ka

1 përkthim të këtij dokumenti në shqip. Ndoshta unë mund ta
2 lexoj edhe një herë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lexojeni
4 ngadalë dhe do të përkthehet ngadalë.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Zoti Haradinaj do ta përsëris
6 citimin.

7 "Megjithatë, jo vetëm që e kisha unë parasysh dhe isha i
8 shqetësuar për këto çështje, por kishte edhe një çështje më të
9 madhe në pyetje që ishte rrjedhja e dokumenteve të ZPS-është,
10 që kishe treguar se kishte mungesë të theksuar sigurie. Ky
11 ishte shqetësim i madh sepse ishin nxjerrë dokumente që kishin
12 emrat e dëshmitarëve. Ky është një shqetësim i madh sepse në
13 qoftë se nxirrej ky informacion mund të shkaktonte vdekjen e
14 tyre ose t'i frikësonte ata për vdekje, sepse ata po vepronin
15 mbi bazën se ata ishin dëshmitarë të mbrojtur. Këta
16 dëshmitarë, pra, po ndanin një informacion ndërkohë që
17 mendonin se emrat e tyre nuk do të nxirreshin asnjëherë.".

18 Zoti Haradinaj a e keni thënë ju këtë?

19 Pë. Jo, unë e kam thënë po ju kam referu të gjithë opinionit
20 publik që flitej në atë kohë në të gjitha mediat. Kjo flitej.
21 Se nëse është kështu, kjo flitej. Prandaj unë kam ofru të
22 gjitha thëniet të gjithë analistave dhe kjo ishte ajo që në
23 Kosovë flitej çdokund, në çdo media, në çdo vend. Unë i jam
24 referuar asaj ç'ka flitet që është shqetësim për krejt
25 popullin e Kosovës. Vetëm ju kam referuar ato dhe vetëm i kam

1 transmetuar këtë opinion që edhe të tjetër e kanë shfaqur, se
2 këtë opinion e ke pasur të shfaqur dy javë, tri javë, katër
3 javë. Nuk është opinioni im personal. E kështu.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
5 Haradinaj. Zoti Haradinaj kjo pyetje kërkonte përgjigje "po"
6 ose "jo" a e keni thënë këtë?

7 I AKUZUARI HARADINAJ: I jam referuar të tjerëve që i kanë
8 thënë këto.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem zoti
10 Haradinaj vetëm "po" ose "jo".

11 I AKUZUARI HARADINAJ: Jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë ngre kundërshtim në lidhje me
14 insistimin për të dhënë përgjigje "po" ose "jo" zoti
15 Haradinaj, sepse ai duhet të japë shpjegimet. Kjo ju lejua
16 dëshmitarëve të Prokurorisë, t'i lejohet edhe dëshmitarëve
17 tanë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ka një dallim
19 midis dhënies së shpjegimit dhe shmangies së pyetjes. Ka një
20 rregull i cili është rregull për të gjithë, që zbatohet për të
21 gjithë.

22 Z. HALLING: [Përkthim]
23 Py. Zoti Haradinaj nga përgjigja që keni dhënë, ju e keni
24 ditur që në qoftë se do të dilnin emrat e dëshmitarëve që
25 përmbaheshin në ato dosje, ata do të frikësoheshin për vdekje.

1 A është kështu?

2 Pë. Unë e mendoj që ata dëshmitarë që po e nijnë sot këtë
3 deklaratën tonë po e nijnë këtë deklaram, unë s'e kam ditur
4 këtë. Jo. S'është kështu.

5 Py. Ju thoni që është hera e parë që dëgjoni për këta
6 dëshmitarë sot? A nuk e dëgjuat, që e përmendët këtë edhe në
7 videon që tregova më herët?

8 Pë. Po tash nëse unë e shpjegoj këtë ju prapë bëni pyetje.
9 unë e sqarova një herë. Ju kam referue thënieve dhe mediave të
10 tjera që i thonin këto thënie. Nuk janë thënie të miat, as
11 shqetësimi s'ka qenë shqetësim vetëm i imi, shqetësim të cilin
12 e mbjellën tek të gjithë ne, mediat dhe opinionet.

13 Py. Dhe ky opinion publik që përmendët, nxjerrja e emrave të
14 dëshmitarëve të mbrojtur mund të shkaktonte vdekjen e tyre
15 sepse njerëz të tjerë mund t'i dëmtonin ata, t'i lëndonin ata,
16 kështu e kuptuat?

17 Pë. Jo as e kam kuptuar kështu, as nuk shoh arsye që
18 dëshmitarët të lëndohen -- ndonjë gjë në diçka apo mund [e
19 pakuptueshme]. Dëshmitarët, dëshmitarët krejt tjetër s'ka pas.
20 Unë s'kam menduar kështu dhe unë u përgjigja në këtë pyetje që
21 u bë. Sa të duash e vazhdojmë.

22 Py. Zoti Haradinaj, gjatë kësaj kohe në shtator 2020, ju keni
23 thënë vazhdimisht që OVL-ja nuk ka nxjerrë ndonjë emër të
24 dëshmitarëve, a është kështu?

25 Pë. Po, është kështu, qëndroj edhe sot që s'kemi nxjerrë

1 asnjë emër të dëshmitarëve, me përjashtim nëse janë dëshmitarë
2 që ju i keni qit këtu. Këta janë publikë, - thashë - pesë vjet
3 përpara. Nuk është që i kemi dëgjuar ose i kemi parë për të
4 parën herë në ato letra.

5 Py. Pse nuk i përmende emrat, nuk i keni përmend emrat e
6 dëshmitarëve?

7 Pë. Po as nuk i di, po as kam lexuar. Kam tregu, ne kemi
8 shfletuar, ne s'kemi lexuar. Unë s'i di as sot.

9 Py. Zoti Haradinaj, ju nuk i keni nxjerrë emrat e
10 dëshmitarëve sepse e dinit që ishte gabim -- do të ishte gabim
11 po ta bënit këtë?

12 Pë. Edhe këtë nuk ka qenë mendimi ynë i këtyre. Ka qenë
13 opinion që e kemi marrë gjatë paneleve që nuk duhet, --
14 përndryshe as që s'ka qenë një vendim i joni që e kemi pru na
15 vendim apo e dinim që është kështu apo nuk është kështu. E
16 para, edhe po të dinim edhe po mos të dinim, ne nuk i dimë
17 emrat që ka qenë. Nuk i dimë emrat kush kanë qenë. S'kemi
18 mbërritur me i lexu.

19 Py. Është gabim të nxirren emrat e dëshmitarëve se kjo mund
20 të shkaktojë lëndimin e tyre. A është kështu?

21 Pë. Kjo është referim i një thënieje që na u ka thënë prej
22 juristëve, panelistëve dhe shoqatat civile gjatë panelit që
23 janë kanë dhe e kam e ripërsërit të tyren.

24 Pë. Zoti Haradinaj, do ta bëj edhe një herë të njëjtën
25 pyetje: është gabim të nxirren, është e gabuar të nxirren

1 emrat e dëshmitarëve sepse kjo mund t'i dëmtojë ata. A është
2 kështu?

3 Pë. S'është mendim i imi personal, është mendim i një
4 opinionit të cilit flitej në televizion, të cilit unë i jam
5 referuar.

6 Py. Zoti Haradinaj, dua t'ju lexoj një pjesë të dëshmisë së
7 zotit Gucati në këtë çështje gjyqësore. Ju kujtohet që zoti
8 Gucati ka dhënë dëshmi muajin e kaluar apo jo? Zoti Haradinaj
9 ju kujtohet që zoti Gucati ka dhënë dëshmi muajin e kaluar? Ju
10 kujtohet dëshmia e tij?

11 Pë. Sa kam mujt me e mbajtur mend, por e di që ka dhënë dëshmi.

12 Py. Do t'ju lexoj një pjesë të tij, ky është nga transkripti,
13 faqja 2309 dhe pastaj do t'ju bëj disa pyetje.

14 "Pyetje: Pajtoheni që nxjerrja e emrave të dëshmitarëve
15 në publik do i rrezikojë dëshmitarët?

16 Përgjigja nga zoti Gucati:

17 "Po ju them edhe një herë që në qoftë se një emër nxirret
18 nga unë, nga kryesia e OVL-së, sigurisht ne mund t'i kishim
19 dëmtuar në një farë mënyre dëshmitarët, por ne nuk kemi
20 nxjerrë asgjë."

21 Zoti Haradinaj, a pajtoheni me zotin Gucati, me atë që ka
22 thënë në këtë pjesë që ju lexova?

23 Pë. E para, zotin Gucati e keni pasur këtu, e keni pyetur,
24 unë s'i komentoj dëshmitë e të tjerëve, as të zotit Gucati, as
25 të kurrkujt tjetër.

1 Py. Zoti Haradinaj, më vjen keq, por nuk mund të përgjigjeni
2 që "s'kam koment" në lidhje me këtë. A pajtoheni në lidhje me
3 atë që tha zoti Gucati në dëshmi, në atë pjesë të dëshmisë që
4 ju lexova?

5 Pë. Zoti Prokuror, mos luaj me fjalë. Nuk thashë "s'kam
6 koment". Thashë "nuk i komentoj njerëz të cilët i keni pasur
7 këtu kanë dhënë deklaratën dhe i keni marrë në pyetje".

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
9 Haradinaj, duhet t'i jepni përgjigje kësaj pyetjeje dhe
10 përgjigja duhet të jetë "po" ose "jo". Pastaj mund të
11 shpjegoni, por fillimisht duhet të jepni përgjigje.

12 Pë. S'po kuptoj ç'ka kam me thënë "po" ose "jo". Në qoftë se
13 doni veç me thanë fjalë "po" ose "jo", jua them "po", "jo". Po
14 unë po ju them "nuk e komentoj personin që ka dhënë
15 deklaratën". E kanë dhënë këtu, e kanë pas përpara. Pse me i
16 komentu unë të tjerët. Këtu e keni, ja ku e keni zotin Gucati
17 e thirrni prapë. Nuk është çështje e imja kjo. E ç'ka me thënë
18 zoti Gjykatës "po" ose "jo". Në cilën përgjigje, në cilën
19 pyetje. Ai e ka dhënë. S'mund të përgjigjem për të.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
21 Haradinaj, pyetja është "a pajtoheni me deklaratën që ka bërë
22 zoti Gucati, a pajtoheni "po" ose "jo"?".

23 Pë. Po dhe ky është një tjetër opinion që Gucati veç ju ka
24 referu, opinion i njëjtë si unë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përsëri nuk

1 është përgjigje zoti Haradinaj. A pajtoheni me këtë që ka
2 thënë zoti Gucati, siç e citoi zoti Halling, "po" ose "jo"?

3 I AKUZUARI HARADINAJ: Nëse s'më dhe fjalën dhe po
4 insiston që unë të përgjigjem me "po" ose "jo" dhe ma dhe
5 pastaj të drejtën me koment, po të them, "po, pajtohem",
6 duke mendu që m'u gjithmonë edhe ky e ka thënë siç e thashë
7 edhe unë me bindje jo të tij por të opinionit që e krijuan të
8 tjerët dhe e thanë. Kështu që vetëm ju ka referu atyre
9 thënieve që janë folur. Për kështu pajtohena sepse u pajtova
10 edhe për vedi. Por unë nuk besoj që ka qenë edhe mendim direkt
11 i tij sepse nuk e kemi pas ndonjë mendim. As kemi menduar
12 kësisoj.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
14 zoti Haradinaj.

15 Vazhdoni zoti Halling.

16 Z. HALLING: [Përkthim]

17 Py. Zoti Haradinaj, a është e vërtetë që në intervistat që ke
18 bërë në shtator 2020, të është bërë pyetja dhe të është thënë
19 që "nxjerrja e emrave të dëshmitarëve mund t'i frikësojë këta
20 dëshmitarë?".

21 Pë. Nuk m'u ka thënë mu. U ka thënë gjatë debateve, nuk m'u
22 ka drejtu mua ashtu direkt, u ka thënë gjatë debateve, që e
23 kanë si këshillë që është mirë mos me u bë kështu. Prandaj ne
24 e kemi marrë këtë opinion. Do të thotë është opinion i marrun
25 prej atyre që ne i kemi llogarit që janë profesionalistë,

1 sepse ka pas - thashë - edhe avokatë, njerëz të shoqërisë
2 civile, gjykatës. Dhe është një opinion që ne e kemi krijuar
3 në bazë të atyre që ata kanë thënë.

4 Py. Pra, me sa kuptoj unë, kjo u tha gjatë debatit, gjatë
5 debateve ku keni qenë ju personalisht i pranishëm, a është
6 kështu?

7 Pë. Po kjo është thanë duke iu referuar këtyre.

8 Py. Por ata jua drejtuan këtë vërejtje edhe ju, apo jo?

9 Pë. Na u drejtuan sepse edhe ata e kishin këtë opinion. Dhe
10 ja pranuan atë opinion të tyre.

11 Py. Zoti Haradinaj, unë do të shfaq një video përsëri. Kjo
12 është nga një intervistë tjetër që e keni dhënë më 22 shtator
13 2020. Është prova materiale P11. Është vula kohore 1:24:20-
14 1:25:01.

15 Ju lutem përkthyesit ta përkthejnë pjesën. Pasazhi në
16 anglisht është në P11-ET RED faqet 64-65.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kemi --
18 desha të di nëse mund të përkthehet, e kemi këtë informacion
19 zonja Sekretare?

20 Vazhdoni zoti Halling.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Pra, zoti Haradinaj, përsëri si
22 përpara do të luajmë këtë video dhe pastaj do t'ju bëj disa
23 pyetje.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. HALLING: [Përkthim]

1 Py. Zoti Haradinaj, në këtë shkëmbim, sa për t'u siguruar,

2 zoti Arjan Koci thotë:

3 "Kjo ka sjellë një ndjenjë frike te dëshmitarët".

4 Dhe pastaj thuhet:

5 "Sigurisht".

6 Dhe ju thoni:

7 "Jo nuk ka krijuar"

8 Dhe pastaj thoni që:

9 "Zoti Koci, unë nuk jam jurist por kjo ka krijuar një
10 ndjenjë shqetësimi dhe kuptimin se njerëzit i kanë mashtruar
11 dhe tani njerëzit janë vetëdijësuar".

12 Ku e kishit fjalën zoti Haradinaj kur thonit se "njerëzit
13 janë vetëdijësuar"?

14 Pë. Nëse e shihni në këtë foto mirë, zoti Gjykatës nëse më
15 lejohet me sqaru, se më duhet për arsye që të përgjigjem. Këtu
16 ke dy opinionistë, një gazetar dhe një avokat, më duket është
17 edhe i akredituar edhe te ju. Dhe them se "njerëzit janë
18 vetëdijësuar" është fjala, ju referohem njerëzve në Parlament,
19 që janë vetëdijësuar se pse duhet të hihet ato ç'ka na
20 kërkojshim. Pse duhej të ishte ligji për të gjitha. Dhe janë
21 vetëdijësuar për të gjitha ato që ata kanë menduar që do të
22 realizojë kjo Gjykatë. Fjala është që njerëzit janë
23 vetëdijësuar, unë e kam fjalën për njerëz që vendosin për
24 shtetin tonë, as dëshmitarë, as unë nuk kanë pozita që të
25 vendosin për shtetin tonë. Mua më intereson çështja e shtetit.

1 Se po të më kishte interesuar individi, do më kishte individi
2 -- ma së pari vetja e ime dhe nuk do t'i kisha hyrë kësaj
3 rruge që të sakrifikoja jetën time komplet. Prandaj, do të
4 vetëdijësohet.

5 I pari është që ky, Berat Buzhala, sepse ky është njeri
6 që ka votu vetë këtë Gjykatë. Prandaj e thashë, për këta vlen,
7 këtu është fjala edhe nuk thashë aty "nuk jam jurist", po "jam
8 jurist". Nuk jam jurist profesional, por jam jurist.

9 Py. Iu tha pra, juve aty që dëshmitarët ishin të frikësuar
10 dhe përgjigja juaj për njerëzit që ishin vetëdijësuar ishte në
11 lidhje me shtetin. Këtë po thoni?

12 Pë. Dëgjo edhe një herë ose shiko mirë përkthimin, këtë e
13 thanë të tjerët aty, prandaj fola pak më përpara për opinion
14 që ngriti. E tha Berat Buzhala këtë, e thanë këta të tjerët.
15 Dhe ky është ai opinion që e kemi marrë na prej këtyre sepse
16 për ne këta janë njerëzit më kompetentë, më profesionalë për
17 cilësinë e këtyre sendeve, prandaj kur thosha "ju kam referu",
18 besoj që tash po më kuptoni.

19 Py. Ju po përpiqeshit ta bënit të qartë se bashkëpunimi me
20 DHSK-në ishte gabim, apo jo?

21 Pë. Për kënd ta bëj të qartë se bashkëpunimi me DHSK-në ishte
22 gabim, për kënd, për kënd zoti Prokuror, të lutem thuama.

23 Py. Fjalët tuaja të sakta - fjalët e tua të sakta janë "ata
24 ishin mashtruar dhe tani ata njerëz janë të vetëdijësuar".

25 Pë. Pra unë njerëzit t'i shpjegova. 82 parlamentarë që kanë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 43

1 çuar gishtin pa ditë ç'ka ka bëjmë dhe të kanë lejuar ty sot,
2 zoti Prokuror me i uzurpu kompetencat edhe të Gjykatës
3 Kushtetuese edhe të Avokatit të Popullit edhe të drejtësisë.
4 Nuk pyetet më kush në Kosovë, hiç.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të vazhdojmë me pyetjet e mia
6 mbas pushimit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
8 pushim tani, do të vijmë përsëri në orën 11.30, se kjo seancë
9 mbyllet.

10 --- Pauza fillon në orën 11.01

11 --- Seanca rifillon në orën 11.30

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Dua që të them vetëm dy gjëra të
14 shkurtra.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një moment.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Së pari, a mund t'i jepni urdhër
17 Prokurorisë që kur t'i tregojë dokumentet z. Haradinaj, ai t'i
18 shikojë këto dokumente nëse përmenden transkriptet, ta shikojë
19 transkriptin.

20 E dyta, nëse mund t'ia shpjegoni i nderuar Gjykatës,
21 zotit Haradinaj që të mos ketë konfuzion që kur ai urdhërohet
22 të përgjigjet me "po" ose me "jo", kjo nuk do të thotë që ai
23 nuk mund ta shpjegojë përgjigjen.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po a ia keni
25 shpjeguar ju apo jo?

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam pasur mundësi që të flas me
2 të.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
4 Haradinaj, dua të jem shumë i qartë. Zoti Halling bëri shumë
5 pyetje të cilat kërkonin një përgjigje me "po" ose me "jo" dhe
6 ju e dini se, e kuptoni se kur një pyetje kërkon "po" ose me
7 "jo". Dhe mund të doni të shpjegoni por fillimisht thoni "po"
8 ose "jo" dhe mund të vazhdoni me shpjegimin, e kuptoni?

9 I AKUZUARI HARADINAJ: Zoti Gjykatës unë kur kuptoj edhe i
10 përgjigjena, po kur s'i kuptoj atëherë i përgjigjena në atë
11 mënyrën time. Kur e kuptoj normal që i përgjigjena me "po" ose
12 "jo" kur e kuptoj ashtu.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe nëse nuk
14 e kuptoni, mos jepni shpjegim, mjafton të thoni nuk e kuptova
15 pyetjen që t'ju bëhet pyetja nga e para ose ndryshe.

16 I AKUZUARI HARADINAJ: Në rregull.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni fjalën
18 z. Halling.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Sa i takon pikës
20 tjetër që ngriti Mbrojtja e zotit Haradinaj tani kur ka gjëra
21 të cilat unë kam ndërmend që t'i lexojë dëshmitari, do të
22 vendosë dhe versionin shqip kur ka, kur do të shfaqim video,
23 gjë që do bëj tani, ai mund të shikojë videon dhe unë do t'i
24 jap vetëm transkriptin e faqes në anglisht për të gjithë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë dua të them se kjo nuk mjafton.
2 Kur zoti Halling përmend një transkript, një dokument, ky
3 dokument duhet që t'i tregohet z. Haradinaj në mënyrë që t'i
4 bëhet pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk kishte mikrofon]

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, nuk tha që do ta bëjë ka. Ai
7 nuk tha që sa herë që do t'i referojë një dokument të
8 transkriptit do t'i tregohet z. Haradinaj. Unë këtë kërkoj i
9 nderuar Gjykatës.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Kur ka një video, të cilën kërkoj
11 që ta shikojë z. Haradinaj unë kam ndërmend që ai të shikojë
12 videon.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për video
14 mund të mos jetë transkript.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Mund të mos jetë, por kur përmendet
16 një transkript...

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po kur është
18 transkripti e keni transkriptin apo jo?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Po, po e kemi dhe mund të vëmë në
20 dispozicion.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, nëse
22 është transkripti mund të na tregohet dhe është në rregull.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. HALLING: Mirë.

25 Py. Zoti Haradinaj, siç sapo e përmenda kam një video tjetër

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 46

1 të cilën dua t'jua tregoj. Edhe kjo është nga materiali P11 me
2 vulë kohore 51:32 deri në 51:52. Në transkriptin në anglisht
3 është P11-ET-RED në faqen 38.

4 Të nderuar Gjykatës, ka një version në shqip të kësaj,
5 por do të zëvendësonte transkriptin në anglisht.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të na e
7 përkthejnë në anglisht, kështu që unë sugjeroj që kjo do ishte
8 mënyra më e mirë.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë është P11, versioni shqip
10 i këtij transkripti me të njëjtën vulë kohore në faqe.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
12 Haradinaj ka një pyetje më duket.

13 I AKUZUARI HARADINAJ: Ma qitni këtu në shqip se unë e kam
14 në anglisht. Unë në anglisht s'muj e kuptoj. Me ju ndigju, u
15 ndigjoj veç po du me e ditë a është qitë fjalë për fjalë çka
16 po folet. Versionin këtu ku asht në anglisht të më dalë
17 shkrimi shqip nëse ka mundësi, nëse ka mundësi. Anglisht nuk
18 ka nevojë me më dalë, se s'e kuptoj.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka mikrofon]

20 I AKUZUARI HARADINAJ: Faleminderit zoti Gjykatës.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Për Sekretaren, në shqip është
22 51:32 - 51:52. Është në faqen e mëparshme. Edhe një më shumë.
23 Faleminderit.

24 [Luhet videoincizimi]

25 "Për atë që thotë Tribunali se është intimidim pra në

1 procesin gjyqësor në ballin e drejtësisë, pra është...”

2 “S’është faji, s’ka faj pse e lëshon ai, ai duhet me e
3 dënu. Ai hajn që merr 200 milionë euro [e padëgjueshme]...”

4 “S’e dimë ne nëse i kanë nxjerrë ata apo...”

5 Z. HALLING: [Përkthim]

6 Zoti Haradinaj, në këtë pjesë prezantuesi thotë ky është
7 prospekti i intimidimit të procesit gjyqësor, kështu?

8 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
9 këshillohen]

10 I AKUZUARI HARADINAJ: Të nderuar Gjykatës, s’e di a jeni
11 tu pa pamjen që jam tu pa edhe unë që’tu. Jo, nëse jeni ka
12 shihni atëherë po e filloj përgjigjen. Këtë pamje që unë po e
13 shoh konkretisht këtu ku është stopu kjo fotografia e
14 televizionit. Vetëm po ceki. E cek personin kush ka thonë.
15 Janë ekspozuar dëshmitarët. Prokuroria të kërkojë falje. Ky
16 s’është mendimi imi. Ky mendim i personit këtu që e ka thonë.
17 E dyta, aty çka thashë, edhe sot kërkoj përgjegjësi ndaj atyne
18 që e kanë vu këtu. Dhe unë e kërkoj edhe sot me u ul të
19 vërtetët këtu ata që i kanë bo këto dokumentet.

20 Përderisa marrin rroga të mira, përderisa marrin të
21 gjitha dhe kanë përgjegjësi. Dhe sot kërkoj të njëjtët. Të
22 japin përgjegjësi ata që e nxorën këtë material dhe e prunë
23 këtë material te na. Ndërsa këto të tjerat janë opinionet e
24 këtyne që shpesh ne dhe ju kam referu për shembull. Se edhe
25 nëse ndonjëherë e kam thonë këtë fjalë e shihni që është

1 opiniononi i të tjerëve.

2 Z. HALLING: [Përkthim]

3 Py. Kur u shpreh ky opinion dhe ju u përgjigjët "është faji i
4 atyre që i kanë lënë dokumentet të dalin." Çfarë donit të
5 thoshit me këtë fjalë?

6 Pë. Ç'po them, është faji i juji, kam mendu për ju. Është
7 faji juji. Edhe tash po them është faji juji që keni leju me
8 ndodh kjo.

9 Py. Pra me fjalë të tjera, do të ishte e saktë nëse do të
10 thosha që në këtë pjesëz që pamë në video nuk ka rëndësi nëse
11 procesi intimidohet apo jo sepse është faji i Dhomave të
12 Specializuara të Kosovës që pse kanë dalë dokumentet?

13 Pë. Unë nuk e thashë kështu këtë në fjalët që ti the. Ky
14 është mendimi i yti. Është shumë keq, çfarëdo procesi që niset
15 për drejtësi të pengohet dhe çdo njeri normal - proceset për
16 të dalë një vepër që është e dënueshme dhe pengon me dënu ne
17 nuk jemi, ne nuk jem, ne jem për me u dënu i merituar. Por nuk
18 jam me u kriju fajtori, me e mbrojt fajtorin e vërtetë, rasti
19 siç jemi ne këtu.

20 Py. Përse po flisni për fajet e Dhomave të Specializuara të
21 Kosovës në përgjigje të një pyetjeje në lidhje me intimidimin
22 e procesit gjyqësor?

23 Pë. Po, se kam thonë unë këtë, bile unë aty i tregoj, i
24 kërkoj shpjegim ç'ka është fjala intimidim. Dëgjo mirë ç'ka
25 thotë. Dhe nëse ka faj sepse ju po më fajësoni mu tash dhe na

1 keni fajësu ne për diçka që koka e gabushme e në fakt ne s'e
2 kemi bo, e keni bo ju, nga ju ka rrjedh, nëse s'ka rrjedh
3 atëherë pse unë jam këtu?!

4 Py. Zoti Haradinaj, a nuk thatë ju që është faji i atyre që i
5 kanë lëshuar dokumentet dhe përgjigjja e prezantuesit është që
6 "Tribunali ka thënë se ky është intimidim i procesit
7 gjyqësor".

8 Pë. Po ta përsëris edhe njëherë ta thashë. Unë po ta përsëris
9 edhe këtu. Është faji i juji që keni leju këtë rrjedhje, jam
10 tu ta përsërit, ta kam përsërit dhe do ta përsëris, edhe asht
11 kështu. Mendoj që u përgjigja. Pastaj e keni thënë edhe ju
12 vetë që o gabim nëse është kështu.

13 Py. Pra e thatë këtë në përgjigje të pyetjes së prezantuesit?

14 Pë. E thashë këtë në opinionin e tij që e dha që nëse ka faj,
15 këtu kanë faj ata të cilët i kanë nxjerrë nëse i kanë nxjerrë,
16 ata të cilët i kanë maru nëse i kanë maru, ata të cilët na
17 kanë provoku me to. Po edhe nëse janë të vërteta këto që kanë
18 dalë, prapë faji i juj është zoti Prokuror, i zyrës juaj. Ne
19 s'kemi punuar te ju.

20 Py. Pra, po dëshmoni këtu se ngjarjet e shtatorit të vitit
21 2020 shkaktuan intimidim të procesit gjyqësor, por faji për
22 këtë ishte i Dhomave të Specializuara të Kosovës?

23 Pë. Në asnjë mënyrë s'po e dëshmoj këtë, përkundrazi, nëse
24 ka, unë s'besoj që ka, po nëse ka, unë nuk po e them këtë që
25 është shkaktu, se s'kanë pasë çka me shkaktu, kush u përmend?

1 Nëse fjala "dëshmitar" qënka dhënia e asaj që çka u dashë me u
2 mshef, unë thashë s'janë përmend asnji emën nëse ka pasë emna.
3 Asnji emër që se di deri sot, kështu që unë s'besoj që ka
4 intimidu deri tash, as tash, mbasi po thu unë s'besoj se as
5 deri tash. Nëse nuk janë çu tjetërkund ata dokumenta më, po
6 janë sjellë veç te na, që për atë punë e dini ju ma mirë se ku
7 i keni çu.

8 Py. Pra do të ishte e vërtetë që nëse emrat, po të
9 përmendeshin emrat atëherë do të ishte intimidim?

10 Pë. Për mue çështja kryesore ka qenë qeveritarët tanë a kanë
11 ditë ç'ka kanë bo dhe fuqinë që ia kanë dhënë dhe plus pjesën
12 tjetër që ia keni grabitë dhe ju a po i përmbaheni atyne që
13 keni thonë. Unë edhe një herë po them, në 2018-n unë kam
14 deklaratë, kam deklaratë që muj e gjoni nëpër dëshmi, me
15 siguri edhe i keni gjetë që s'i qitni, ku kam thonë që "duhet
16 kjo Gjykatë t'i dënojë të gjitha krimet" dhe po e them edhe
17 një herë. Përndryshe po të jetë kështu do ta kisha përçafu
18 këtë ide pse jo, pse jo? Kush është ai i çmendur që është
19 kundra zbulimit të një krimi?! S'më intereson hiç
20 nacionaliteti. Secili të përgjigjet për pjesët e veta. Por jam
21 kundra dhe po them edhe këtu, jam kundër atyre që duke e mshef
22 kriminelin e sajojnë një kriminel të ri...

23 Py. Zoti Haradinaj, nuk iu përgjigjët pyetjes sime. Do ta bëj
24 edhe njëherë pyetjen. Do të ishte e vërtetë që nëse do të
25 përmendeshin emrat atëherë do të ishte intimidim?

1 Pë. Ata po i referohen opinionit që ka marrë prej tjetër,
2 kështu e kanë thonë, me këtë jam pajtu dhe këtë e kemi thonë
3 edhe na, e kemi përsërit. Ka qenë një opinion që e kemi marrë
4 prej njerëzve që janë ma kompetentë se na dhe këtë e kemi
5 përsërit edhe na. Po s'ka qenë mendim i yni, saktë i yni. Nuk
6 ka buruar prej mendimit tonë, ka buruar prej ndikimit dhe
7 mendimeve të njerëzve që besojmë që i kanë ditë këto gjana ma
8 mirë se na.

9 Py. Pra në përmbledhjen paraprake kur flisnit për opinionin
10 publik të dëshmitarëve që ishin të frikësuar për vdekje, ky
11 ishte një opinion publik me të cilin ju pajtoheshit apo jo?

12 Pë. Po kush nuk pajtohet nëse është pengim, në të vërtetë
13 kush nuk pajtohet. Nëse është e vërtetë ashtu pse mos me u
14 pajtu, çka ka të keqe nëse pajtohem për dikënd që mundohet me
15 pengu një drejtësi. Unë jam për drejtësi zoti Prokuror.

16 Py. Dhe dëshmia e zotit Hysni Gucati, të cilën jua lexova në
17 sesionin e mëparshëm, ju thatë që ishte reflektimi i opinionit
18 publik, por ju pajtoheni edhe me atë deklaratë apo jo?

19 Pë. Unë u përgjigja sa i përket zotit Gucati. Unë nuk e
20 konstatova po unë mendova, e dhashë një mendim të temin që
21 ndoshta mundet me konë edhe te ai ky ndikim. Prandaj unë ta
22 dhashë këtë përgjigje për Hysni Gucatin ty. Edhe ta dhashë jo
23 si mendim timin, po konstatova që me siguri edhe ai, te ai ka
24 ndiku ky mendim prej opinionit që u ngrit atje. Unë nuk besoj
25 që ka qenë mendim personal i inicium nga truni i Hysni Gucatit

1 ky ose i imi. Këto janë mendime që ne ju kemi referu njerëzve,
2 duke llogarit, ndoshta edhe gabimisht, po duke llogarit si
3 janë ma profesionalisht, ma të zgjuar në këtë çështje dhe i
4 dinë ma mirë, derisa kanë punu për interesin publik. Kjo është
5 ajo që na ju kemi referu, kështu që na vetëm ju kemi referu
6 dhe i kemi ripërsërit në një farë mënyre, i kemi parafrazu
7 kurrgjë tjetër.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman,
9 po.

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk doja që të pengoja përgjigjen e
11 pyetjes nga z. Haradinaj po nëse zoti Halling do vazhdojë që
12 t'ia, të përmendë, t'i thotë zoti Haradinaj se çfarë ka thënë
13 zoti Gucati duhet që t'i tregojmë transkriptin se çfarë pyetje
14 është bërë, çfarë përgjigje ka dhënë në mënyrë që të ketë
15 mundësi të japë përgjigje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se ky
17 shkëmbim pyetje-përgjigje lidhur me zotin Gucati ishte shumë i
18 qartë. Dëshmitari nuk tha se ishte i paqartë. Argumenti i tij
19 ishte që ishte një opinion por --

20 Pra u kuptua dhe përgjigjja. Kundërshtimi juaj rrëzohet.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Sigurisht kundërshtimi është që kjo
22 pyetje është bërë njëherë dhe ka marrë përgjigje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me këtë
24 pajtohem.

25 Z. Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Dua të ngre dy
2 çështje shumë shkurt. E para ka të bëjë me transkriptin që u
3 citua nga zoti Gucati. Ishte një citim i pjesshëm, jo i plotë.
4 Nga ana jonë ne i bëjmë jehonë komentit të zotit Cadman ku i
5 kërkon zoti Hallin që nëse dëshiron të përmendë transkript të
6 dëshmisë për hir të Trupit Gjykues por edhe të dëshmitarit të
7 vendosë pjesët përkatëse të transkriptit në ekran në mënyrë që
8 që të gjitha palët të sigurohen për plotësinë dhe saktësinë e
9 citimit që i bëhet.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] E dyta...

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk mendoj se
13 kjo kishte ndonjë efekt tek pyetja që u bë dhe që u përgjigj.
14 Kjo pyetje, kjo çështje tani sigurisht është bërë, ka marrë
15 përgjigje. Kur të ketë mundësi do të përpiqemi që t'ia
16 vendosim dokumentin zotit Haradinaj që ta shikojë.

17 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

18 Së dyti, unë do t'ia lë çështjen e zotit Gucati në duart
19 e zotit Bowden. Ju jam mirënjohës për videolidhjen që është
20 organizuar për të marrë pjesë, po tani kërkoj leje të largohem
21 nga sesioni në këtë moment, me lejen tuaj.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

23 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Duhet të përmend që edhe z. Soliman
25 nuk është më me ne sepse siç e thashë ai do ishte vetëm në

1 sesionin e parë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa problem.

3 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 vazhdoni.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Dhe e vetmja gjë që
7 do përmendja për këtë shkëmbim që u bë tani është që këto janë
8 dokumente shumë të gjata dhe më duhet që të nxjerr ekstraktin.
9 Nuk është se nuk kam dashur që të jap kontekstin e duhur nëse
10 avokatët e Mbrojtjes duan që, kanë diçka për t'i shtuar
11 citimit, mund ta ngrenë si çështje. Përndryshe mund ta
12 përmendi në pyetjet plotësuese.

13 Z. HALLING: [Përkthim]

14 Py. Zoti Haradinaj, kam edhe një pyetje tjetër që dua të ma
15 sqaroni lidhur me një video tjetër. Për Sekretarinë është P7
16 15:33 vula kohore deri në 16:14.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
18 Haradinaj, e shihni përpara dokumentin në gjuhën shqipe, e
19 keni?

20 I AKUZUARI HARADINAJ: [Përkthim] Mu mbulu me videolinkun
21 është. Mu nuk ka nevojë t'më qitet në gjuhën angleze, mjafton,
22 sepse unë jo që e kuptoj komplet kështu që, për mu mundet me u
23 kursy mos me ma qit transkriptin në gjuhën angleze.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E shihni
25 tani?

1 I AKUZUARI HARADINAJ: [Përkthim] Tash e shoh,
2 faleminderit.

3 [Luhet videoincizimi]

4 Z. HALLING: [Përkthim] Në transkriptin në anglisht për
5 përkthyesit fillon me pjesën "Mr. Gashi" pastaj pjesa
6 përfundon me "Mr. Haradinaj, that's right" që kjo është për
7 transkriptin në anglisht.

8 Kështu që do të kërkoj që të luhet edhe njëherë video.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ju lutem.

10 [Luhet videoincizimi]

11 Z. HALLING: [Përkthim]

12 Py. Zoti Haradinaj, kush po flet në këtë diskutim këtu që
13 pamë?

14 Pë. Këtu zoti Prokuror ma shumë është një opinion i avokatit,
15 nuk e di këtu a ka qenë, po ka qenë atëherë në atë kohë avokat
16 i yni, avokati Tomë Gashi që është i akreditum, që ashtu një
17 opinion i tij ma shumë i juristit dhe i moderatores. Dhe kam
18 edhe unë disa fjali të cilat që don i përsëriti ça kam mendu
19 dhe ça kam thonë.

20 Py. Po, ju lutem mundet.

21 Pë. Këtu këta po diskutojnë për ligjet. Toma po ka jep
22 opinion të tij, po ka jep opinion të tij, ndërsa unë hyj këtu
23 duke thonë se, këta dëshmitarë nuk mund kurrkush t'i
24 shantazhojë dhe s'kanë pse me u shantazhu, kjo është. Ta
25 lexoj. Nuk mundet me konë prandaj i kemi qitë, ku është fjala

1 shantazhim, s'jam tu mujt me e gjetë tash ku po foli këtu, nuk
2 e shoh atë. Më para ke përkthimi, këtu tash s'po e shoh. Të
3 lutem ma qitni...
4 Py. Zoti Haradinaj, është në fund, nga fundi i kësaj videos
5 që pamë, kur ju thonë që ky keqpërdorim është vepër penale,
6 Pë. Thjesht unë e dëgjova çka tha. Do të thotë unë këtë e
7 them thjesht. Nuk mundesh kush me e shantazhu dhe s'ka pse me
8 i shantazhu. Thjesht, do të thotë unë jam këtu kundër. As ka
9 metoda as s'ka bazë me i shantazhu. Ata e japin opinion e tyre
10 se a muj me i keqpërdor kush as muj me i keqpërdor kush. Dhe
11 këtu bile Toma jep opinion edhe për të tjerët që është
12 opinion i tij dhe këto opinione, qoftë të Tomës, jo pse ka
13 qenë rast që është avokat i yni, aty i Mbrojtjes po edhe si
14 jurist që është i njoftun dhe i akreditum te ju që është edhe
15 profesionalizmit të tyre te na normal që këto opinionet e tyre
16 ne i kemi marrë të mirëqena, që kemi mendu janë më
17 profesionale. Prandaj edhe kemi vendosur, kemi vendosur mos me
18 u marrë na me këto letra çfarëdo qofshin, qofshin
19 fallcifikatë, qofshin të vërteta, mos me u marrë ne sepse kemi
20 mendu që ne nuk kemi mundësinë me e ditë saktë çka janë,
21 prandaj e kemi dorëzuar te mediat dhe ata e dijnë çka bojnë.
22 Edhe po shkrun, "nuk ka nevojë me u shantazhu prej këtyre
23 njerëzve", se s'kanë çfarë me i shantazhu. Nuk e di si është e
24 përkthyme në anglisht, këtu shumë qartë e thonë, nuk kanë
25 nevojë me u shantazhu njerëzit se s'kanë për çka çfarë. Do të

1 thotë s'kanë për çka me i shantazhu. Dëshmitari është
2 dëshmitar.

3 Nëse është shpifje ka mundësinë ai tjetri me e dëshmu të
4 kundërtën dhe çka, krejt normale, dëshmitari është dëshmitar,
5 çka ka me u shantazhu.

6 Py. Në fund të videos që pamë, aty ju thonë që:

7 "Keqpërdorimi përbën vepër penale, por edhe dëshmia e
8 rreme është vepër penale".

9 Thatë që:

10 "Po është e vërtetë".

11 A jeni dakord me atë fjali nga fundi i videos?

12 Pë. Kush e tha? Të lutem sqaroma kush e tha? I kujt është ai
13 citim? A është i imi?

14 Py. Do t'jua lexoj.

15 Prezantuesja thotë:

16 "Keqpërdorimi përbën vepër penale. Dëshmia e rreme,
17 fabrikimi po kështu është vepër penale".

18 Dhe ju kësaj i përgjigjeni:

19 "Po, po e drejtë".

20 Pyetja që kam është: A jeni dakord me atë çka tha
21 prezantuesja, pajtoheni me atë çka tha prezantuesja?

22 Pë. Decidivisht këto që ka thonë përfaqësuesja, unë edhe
23 gjatë përkthimeve të mia, përvojë që kam nëpër gjykata që kam
24 përkthi në Suedi po edhe në gjykata q'ashtu, pengimi normal,
25 edhe pengimi normal që është gabim, po edhe shpifja është e

1 dënueshme, normal edhe duhet me u konë ishalla. Se nëse
2 shpifjet nuk janë të dënueshme ka me mbaru ky popull, normal
3 që janë. Çka ka kjo, unë veç u pajtova me mendim edhe jam. Unë
4 vetëm u pajtova me mendimin e moderatores edhe pajtohem edhe
5 sot.

6 Py. Pra ju e dinit që dokumentet me emrat e dëshmitarëve mund
7 të keqpërdoreshin, a është kështu?

8 Pë. E lypni që çka kam mendu unë këtë fjalë, ça kam thonë
9 sepse unë i keni nxjerrë këto si në kontekst dhe po u kapni
10 për dy fjali. Unë e spjegoj këto që doni.

11 Py. Do ta bëj dhe njëherë pyetjen. Kjo ka të bëjë me dijeninë
12 tuaj. Pra, ju e dinit që dokumentet me emrat e dëshmitarëve
13 mund të keqpërdoreshin, a është kështu?

14 Pë. Po mund të keqpërdoreshin po t'i kishim citu na, po t'i
15 kishim qitë na ose po t'i kishim publiku, ndoshta edhe mund të
16 keqpërdoreshin, ndoshta. Pajtohem me këtë. Prandaj ne nuk i
17 kemi thonë, as nuk i kemi citu këta emna. Duke dëgjuar këtë
18 opinion sepse dhe ky opinion kështu i thonun është opinion që
19 kam dëgjuar prej paneleve. Dhe mos harro aty ka analistë që
20 ata që kemi na, prej tyre i kam marrë, kështu që unë pajtohem
21 plotësisht me atë mendim derisa kanë thonë njerëzit që janë
22 profesionalë të asaj lëmie. Pajtohem edhe sot, po që është
23 ashtu.

24 Py. Në fakt keqpërdorimi i dokumenteve me emrat e
25 dëshmitarëve në to përbën shkelje penale apo jo?

1 Pë. Cilat dokumente se fjala dokument ti e din, dokument
2 është edhe ky kështu...

3 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kundërshtoj.
4 Prokuroria i kërkon zotit Haradinaj që të marrë një vendim apo
5 të përcaktojë që ka të bëjë me ligjin penal, me të drejtën
6 penale. Zoti Halling n.q.s. ka pyetje mund t'i marrë
7 referencat nga transkripti dhe nuk mund të kërkojë nga zoti
8 Haradinaj që të japë mendimin e tij juridik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në lidhje me
10 faktin që ju po kërkon mendimin juridik të zotit Haradinaj
11 unë e pranoj kundërshtimin e Mbrojtësit.

12 Z. HALLING: [Përkthim]
13 Py. Zoti Haradinaj, kur zoti Gashi të tha se kjo mund të
14 frikësojë dikënd, ai e kishte fjalën për dokumentet që kishin
15 ardhur tek zyrat e OVL-së apo jo?

16 Pë. Zoti Prokuror....

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Një sekondë zoti Haradinaj.

19 Përsëri kur bëhet fjalë për frikësim, ai, Prokurori pra
20 duhet t'i tregojë zotit Haradinaj pikërisht aty ku thuhet kjo
21 në transkript, po kështu është edhe një çështje tjetër që ka
22 të bëjë me saktësinë e përkthimit të transkriptit sepse janë
23 përdorur fraza të ndryshme, janë përdorur "shantazhim" dhe
24 "frikësim" aty.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] N.q.s. ka

1 ndonjë rresht në transkript apo në përkthim d.m.th. të zotit
2 Gashi ju lutem jepini dëshmitarit ku është kjo në transkript.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po, mund t'ju ndihmoj me këtë.

4 Sekretarja mund ta gjejë këtë në faqen 8 ose 9 të versionit në
5 anglisht. Dhe aty thuhet nga zoti Gashi:

6 "Ne e dimë që kjo mund të frikësojë, intimidojë dikë".

7 Është në vulën kohore 15:50 në fund të faqes dhe në
8 versionin shqip mund të shkosh një faqe më mbrapa për ta
9 gjetur citimin.

10 Py. Do ta bëj përsëri pyetjen. Kur zoti Gashi ju tha që:

11 "Kjo mund të frikësojë dikë..."

12 Ai e kishte fjalën për, pra kjo mund të intimidojë dikë -
13 ai e kishte fjalën për dokumentet që kishin ardhur në OVL?

14 I AKUZUARI HARADINAJ:

15 Pë. Zoti Prokuror më fal që po ndërhyj. Këtu s'e kuptova unë,
16 në gjuhën shqipe me u përkthi tash, me u përkthi fjala "zoti
17 Gashi ju tha" - ti e ke fjalën që më ka thonë mu? Këtë je ka
18 bën tash me qëllim apo me të vërtetë s'je ka kupton. Ky nuk mu
19 ka drejtu mu, ky i drejtohet opinionit këtu. Unë nuk jam tek
20 ky në këshilla, as ka më këshillon mund, ky ka i drejtohet
21 opinionit edhe ka flet për opinionin dhe asht mendim i tij për
22 opinionin. Nuk është tu ma tërhjek as mund vërejtjen as
23 kurrkujt. Dhe as më drejtohet mu hiç. Kështu që nuk më ka
24 thënë kurrgjë. Nëse kësaj i referohesh unë s'di si me mu
25 përkthi mu dhe s'di si po të përkthehet ty, këtu që po e shoh

1 ky është tu i referu opinionit, e ka japë një mendim të vetin
2 për opinionin në TV.

3 Py. Zoti Haradinaj, pyetja ime është për të cilat dokumente e
4 ka fjalën ai kur i thotë këto fjalë? A e kupton këtë kur të
5 tha zoti Gashi ty se këto dokumente mund të shantazhojnë dikë,
6 mund të frikësojnë dikë e kishte fjalën për dokumentet që
7 kishin arritur në OVL?

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Kundërshtim. Ai nuk mund të thotë
9 se për çfarë e kishte fjalën zoti Gashi. N.q.s. zoti Gashi e
10 shpjegon përgjigjen më tej në transkript, atëherë zoti Halling
11 mund të na e thotë se ku është ajo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë e hedh
13 poshtë kundërshtimin. Pres nga ai që të japë shpjegim për këtë
14 pyetje, t'i përgjigjet.

15 Z. HALLING: [Përkthim]

16 Py. Ju lutem përgjigjuni.

17 I AKUZUARI HARADINAJ:

18 Pë. Nuk mund të shpjegoj dhe të spekuloj këtu se çka mendu
19 këtu Zoti Gashi. Nuk muj të komentoj idenë e z. Gashi, të
20 tjetrit. Unë s'muj, jo vetëm të Gashit po të askujt tjetër.
21 Nuk muj të komentoj, s'kam as atë kompetencë, as atë aftësi.
22 Këto janë mendimet e tij. Zoti Gashi besoj që do të vijë si
23 dëshmitar, pyeteni kur të vjen.

24 Py. Zoti Haradinaj, në përgjigjen tuaj ndaj kësaj pyetjeje.

25 Ta shohim në faqen anglisht dhe në shqip, thoni që:

1 "Dëshmitarët nuk kanë nevojë se ata e dinë veten a janë.
2 Nuk kanë nevojë me u shantazhu".

3 Ju e kishit fjalën për dokumentet që kishin arritur në
4 zyrat e OVL-së apo jo?

5 Pë. Unë e kam fjalën për çdo dëshmitar. Edhe sot mendoj,
6 asnjë dëshmitar nuk ka nevojë me u shantazhu përderisa është
7 dëshmitar dhe thotë një diçka, një dëshmi të vet. Ndërsa ai
8 shantazhohet, ai shantazhohet nga vetvetja nëse ka bërë
9 shpifje që pastaj gjyqi e vërteton dhe duhet me e dënu, kështu
10 që s'ka nevojë - unë s'e kuptoj si do shantazhohet dëshmitari
11 kur s'ka nevojë. Është tu tregu të vërtetën gjithmonë - unë
12 dëshmitar e kuptoj njeriun i cili tregon diçka që ai din. Po
13 pse duhet me u shantazhu ai, pse duhet me u pengu ai?!

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Po ju kërkoj ndjesë që po ndërpres
16 edhe njëherë dhe kemi kontrolluar dhe ka një mospërputhje
17 midis asaj që thuhet në shqip që përdoret fjala "shantazhojmë"
18 ndërsa në anglisht është përkthyer me fjalën "frikësim".
19 Kështu që duhet të jemi shumë të kujdesshëm se çfarë shprehje
20 përdorin, çfarë fjale përdorin.

21 Ka dallim midis këtyre koncepteve dhe ky duhet pasur
22 parasysh.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling
24 po përdor informacionin që ka para vetes dhe atë mund ta -
25 këtë çështje mund ta ngrini me Njësinë e Përkthimit.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Zoti Halling po i bën pyetjet mbi
2 bazën e një përkthimi të pasaktë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Pyetja që po bëj unë nuk ka lidhje
5 me këtë çështje dhe pyetjes ende nuk i është dhënë përgjigje.

6 I AKUZUARI HARADINAJ:

7 Py. Zoti Haradinaj, kur e kishit fjalën për dëshmitarët, e
8 kishit fjalën për dëshmitarët që ishin, emrat e të cilëve
9 ishin në dokumentet që erdhën në zyrat e OVL-së. A mund t'i
10 përgjigjeni kësaj ju lutem me "po" ose "jo"?

11 Pë. Kisha dëshmitarë në përgjithësi sepse dëshmitarët të
12 cilët ishin aty nuk e di, as kush janë konë se s'i kam lexu.
13 Edhe sot po të them, një dëshmitar as nuk ka arsye, për çka
14 duhet me u shantazhu?! Unë po ta kisha vendos me u konë
15 dëshmitar unë do të kisha thonë atë që di gjithmonë nën betim.

16 Py. Pra kur thatë që "ata e dinë veten a janë a s'janë", ju e
17 kishit fjalën për dëshmitarët në përgjithësi kështu po thoni?

18 Pë. Kjo është, kjo përgjigjja është dhënë në kontekstin se
19 ata insistojshtin me më pyt mu kush janë. Po unë e thashë unë
20 "nuk e di". Mund ta dinë vetëm ata që janë. Dhe e vërteta
21 është kështu, ne nuk e dimë kush janë. Në fakt e dini edhe
22 ata. Po edhe me e ditë nuk është ndonjë kiameti i madh,
23 dëshmitar është. E keqja do të ishte nëse është i përpunum nga
24 ju duke marrë parasysh kë kini koordinator.

25 Py. Në përgjigjen tuaj tani thatë që të njëjtët, "të vetmit

1 njerëz që e dinë këtë jeni ju", a kuptoj nga kjo që ju e keni
2 fjalën për ata d.m.th. dëshmitarët, kështu?

3 Pë. Jo, jo, jo. Ti personalisht me shokët e tu. Edhe me e
4 siguri e din që ishalla nuk flet pa ditë kurrëgjo.

5 Py. Pra dëshmitarët për të cilët po flasim tani janë
6 dëshmitarët e Dhomave të Specializuara, a është kështu?

7 Pë. Nuk ka konë e saktësime për kë dëshmitar. Ti tash
8 përcaktoji ku të dush ti për qejf tëndin. Ne kemi fol për
9 dëshmitarët. Dëshmitarët edhe në Kosovë vlejné edhe gjithkund
10 dëshmitarë. Pastaj emrin na s'e dimë as për çka askush, as s'e
11 di as s'e kam lexu. Bile dhe ata që kam pa ndoshta tërthorazi
12 sot se di, mi keni kujtu ju disa. Disa që i di që 6-7 vjet si
13 emra që janë deklaruar vetë se janë dëshmitarë. Kështu që nëse
14 është ashtu dhe është kjo e dënueshme atëherë u dashtë ata me
15 u ul para meje mbasi e kanë thy kodin e vet kundra vetes e
16 kundra jush.

17 Py. Zoti Haradinaj, në përpjekjet tuaja kundër Dhomave të
18 Specializuara përpara se të vinin paketat ishte qëllimi i OVL-
19 së që të amendohej ligji për Dhomat e Specializuara ose të
20 shfuqizohej ai, a është kështu?

21 Pë. E para, nuk kemi qenë na kundër mendimit, kundër Dhomave
22 të Specializuara, jemi qenë kundra formës dhe veprimeve që i
23 bëjshin haptazi dhe prandaj e lypshim me e amendamu ligjin
24 sepse logjikisht zoti Gjykatës po të ishim për shfuqizim pse
25 atëherë na me lyp amendamentim kur të shfuqizohet mbi të

1 gjitha ligjet pse me shtina një ligj që pastaj sipas teje që
2 po thu ku ta shkatërronim, sa vlerë ka këtu, sa logjikë ka?!

3 Ne ishim për mosvazhdimin sepse vetë i keni caktu një afat
4 kohor dhe në opinion ka qenë e ditun pse ju tash e uzurput të
5 drejtën e juve, ka qenë e ditun që do të hyn edhe ajo në
6 Parlament për me u votu kjo vazhdimi. Ju keni pasë një afat të
7 caktum kur përfundon afati. Dhe ne jemi qenë, nëse nuk mundet
8 me hy ky ligj - e cekim edhe njëherë për publikun, për ju dhe
9 për të gjithë ata që ndjekin - ligji që, këtu Dhomat e
10 Specializuara t'i ndjekin të gjitha krimet që janë kryer në
11 Kosovë pa marrë parasysh nga kush. Atëherë të paktën kur të
12 vjen vakti me ja vazhdu mos ja vazhdojnë më. Dhe për atë jam
13 në pajtim edhe sot nëse nuk bëhet kështu.

14 Py. Ju thatë "pushteti, fuqia që keni uzurpu ju tani". Çfarë
15 fuqie, çfarë pushteti ka uzurpu DSK-ja?

16 Pë. Po ta dokumentoj dhe ata e kanë vërtetë këtu edhe ma
17 fort. Vizita e Avokatit të Popullit tim, të shtetit tim që e
18 pata këtu, mu ka hjek koha si vizitë familjare. Kërkesa e
19 Ministrisë së Drejtësisë që u bë këtu dhe jam i pari që e kam
20 propozu dhe s'jam taku me ta, më ka ardhë si kërkesë
21 familjare. Ndërsa vizita e Avokatit të Popullit të juaj që ka
22 ardhë prej Italisë, ajo mu ka caktu zyrtare dhe kjo është një
23 prej barazive që ju e bëni. Derisa Avokati i Popullit tim,
24 Shtetit të Kosovës, e që ju po e thirrni në emër të Kosovës
25 dhe mua ma hjekni si familjar Avokatin e Popullit tim që vjen

1 me më pa mu në burg dhe më detyroni mos ta pranoj Ministrinë e
2 Drejtësisë të shtetit tim dhe i detyroni të kërkojnë vizitë
3 familjare, unë i kam injorë. Jo i kam injorë ata si të shtetit
4 tim, po i kam injorë me ju kallzu se nuk i pyet ma kush. Dhe
5 këtë segregacion jeni tu e bo edhe sot në vizitat tona. Spjego
6 ti dhe kupto çfarë force ke marrë sa avokatin tënd që e ki
7 këtu, ma ke prurë mu, ai më ka ardhur zyrtarisht. Avokati i
8 Popullit tim, unë u dashtë me e shkru aty si familjar dhe mu
9 ka hjek koha e vizitës për sa kohë ka ndejt Avokati i Popullit
10 të Kosovës. Nëse kjo s'të mjafton atëherë unë e paskena kuptu
11 keq. Kështu u kuptu, për këtë po e them.

12 Py. Zoti Haradinaj, në dëshmitë dhe deklaratat tuaja keni
13 thënë vetë që doni të amendoni ligjin e DSK-së dhe këto
14 përpjekje nuk patën sukses. Pra ju kishit interes në atë kohë
15 që ta shfuqizonit ligjin apo jo?

16 Pë. Zoti Prokuror, a po bëhesh sikur je shurdh a nuk po ndi?
17 Kam interes edhe sot me e shti në fuqi që të ndiqen të gjitha
18 krimet, jo të shkojnë në mënyrë selektive mono-etnike dhe jo
19 të punojë vetëm me ata të cilët dikur ishin ekzekutues dhe
20 urdhërdhënës e të mos përgjigjet - duke qenë Gjykata e Kosovës
21 të mos punosh me asnjë të Kosovës, me asnjë person të Kosovës.
22 Jo me punu me ne, po me punu me organet legjitime, me
23 drejtësinë e Kosovës. Çka ka të keqe? Kështu do të
24 mirëkuptoheshit gjithkund. Ju vetë i bëni procedanet, ju me
25 qëllim jeni tu i bo procedanet me tregu forcë e pushtet, se

1 unë s'e di që shkon edhe në dobi të juve kjo kështu. Kjo është
2 që po e them prapë edhe këtu për hir të transparencës dhe të
3 interesit publik. Dhe mos më pyt mu, se me mujt edhe sot - se
4 derisa nuk u bo ju s'e keni ndërru këtë qasje edhe po ju shoh
5 se as tash.

6 Prandaj edhe sot jam me e shti, që të ndiqen të gjitha
7 krimet pa marrë parasysh kush i ka ba. Ça ka të keqe këtu,
8 nëse ti je kundër kësaj, atëherë unë jam çdo herë kundra teje.
9 Nëse ti prononcohesh që je ti kundra kësaj çka thashë unë, unë
10 po ta prononcoj këtu që çdo herë sa ta kam jetën jam kundra
11 një drejtësie të tillë. Dhe s'është drejtësi, sepse nuk janë
12 me armë të barabarta. Ti e përdor forcën, fuqinë që e ke marrë
13 në Gjykatë Kushtetuese, vendos çka të dush, ja zgjat mandatin
14 tënd sa të dush.

15 Provoje zoti Gjykatës se me shtine fort. Që këtu Berat
16 Buzhalën e ke. Provoje qite në Parlament edhe njëherë në këtë
17 formë që jeni a do t'ju votojnë më. E ki Berat Buzhalën
18 deklarativisht dhe me qëllim nuk e qite këtu, ku tha: "Unë
19 kurrë s'do ta kisha votu në Gjykatë që është Koordinator
20 [REDAKTUAR]". Është një prej deputetëve që të ka votuar ty.
21 Py. Zoti Haradinaj, pyetja ime është tjetër, jo kjo që i
22 dhatë përgjigje ju.

23 Pë. Ma përsërit edhe njëherë se unë kështu e kuptova.

24 Py. Duke e kuptuar që përpjekjet e tua për amendim ishin të
25 pasukseshme atëherë ti u përpoqe gjithashtu që ta shfuqizoje

1 ligjin a nuk është kështu?

2 Pë. Po të ishin në dorën time mujt me e kisha shfuqizu
3 njëqind herë me këtë lloj drejtimi që ke ti. Dhe po të them
4 edhe sot. Prandaj mund dashtë mu me mbledh asi, me mbledh
5 deputetë, me mbledh nënshkrime. Po të ishe ti në mandatin tim
6 pikërisht për hir të drejtësisë të njëanshme që je ka bën, sot
7 të kisha shfuqizu në këtë formë. Por po të ishe qysh po them
8 unë për zbulimin e të gjitha krimeve dhe për me i sjellë
9 kriminalët këtu para Trupit Gjykes do të kishin përkrahë të
10 gjithë. Jemi për këtë. Organizata e Veteranëve është për këtë,
11 që kriminelët e mundshëm të bihen edhe të sillen para Trupit
12 Gjykes. Pse jo? Fiton shoqëria, fiton shteti, fiton
13 njerëzimi. Kush është ai i çmendur që don me e mbrojt një
14 kriminel?

15 Py. Zoti Haradinaj, të shohim tani paragrafin 17 të
16 deklaratës tuaj.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Prova materiale 2D1, paragrafi 17.

18 Py. Zoti Haradinaj, këtu thoni, në këtë paragraf të
19 deklaratës që është pranuar si provë materiale:

20 "Duhet ta qartësoj që ne nuk po kërkonim shfuqizimin apo
21 mbylljen e DHSK-së".

22 Këtë keni thënë apo jo, kjo është e vërtetë.

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 Pë. Ne po kërkonim futjen e një amendamenti që parashikonte
25 hetimet për të gjitha krimet e kryera, pavarësisht se kush i

1 ka kryer ato, këtë po them. Për të qenë të qartë se ne nuk po
2 kërkonim shfuqizimin apo mbylljen e DHS-së-së dhe është shumë
3 e vërtetë dhe ta thashë edhe këtu. Ju e keni qitë këtë. S'e
4 kemi lyp ne shfuqizimin. Ne kemi lyp një amendamentim me e
5 shti me u ndjek që kjo çka thashë ma lart, të gjitha krimet.

6 Nëse dhe kjo Prokurori e pranon që s'po don me ndjekë të
7 gjitha krimet unë po të them dhe njëherë, ne s'po mujt e
8 shfuqizojmë se ju, ju jeni shtet paralel. Kosova ngratë atje
9 veç rrinë i kallzojnë përralla shoqi-shoqit ata deputetët që
10 ka lëshu ky shtet. Se ju tash ia jepni fuqinë vetë, ju se
11 pytni hiç Kosovën. Po problemi është që po t'i vjen mandati në
12 duart e këtyre parlamentarëve, nëse nuk është bërë për
13 ndjekjen e të gjitha krimeve, unë jam - edhe njëherë po të
14 them - për mosvazhdim të mandatit. Të paktën këtë, por edhe
15 për shfuqizim pse jo. Nëse jeni ju të tillë dhe se ju e
16 pranoni që jeni të tillë. Unë ta them haptazi, jam për
17 shfuqizim.

18 Kështu që i qëndroj kësaj çka shkruan këtu. Tash ta
19 shpjegova dhe ma gjatë bile edhe ma qartë. Edhe nëse që tash
20 nuk e ke të qartë, edhe nëse ky panel s'e ka të qartë, unë nuk
21 di ma, veç harxhoj frymë badihava.

22 Py. Pra nga dëshmia juaj kuptoj që ju nuk kërkonit shfuqizimin
23 apo mbylljen e DHSK-së por do ta shfuqizonit sot atë, kështu?

24 Pë. Ti po kupton çka ku ke qejf ti me kuptu. Dhe me që ti
25 s'po kupton, po ta kallzoj edhe sot. Nëse ti e pranon që je

1 një etnik, kështu qysh po tregohesh dhe nuk don me i shti të
2 gjitha krimet, unë po të them "po", jam për shfuqizimin prej
3 këtij momenti dhe e ndali në këtë moment dëshminë, as nuk flas
4 me ty. Vetëm prano ti që s'po don dhe je i tillë.

5 Po don me më detyru ti me dalë kundra të drejtave të
6 popullit tim? Pranoje ti këtë që e ke kështu, që unë po ta
7 pranoj. S'jam me ty nëse ti je mono-etnik, nëse ti je
8 selektiv. Nëse ti nuk don me i qit kriminelët përpara këtu, po
9 don me saju të tjerë në bazë dhe të dëshmime të kriminelëve që
10 i ki koordinatorë, unë po të them jam kundra teje dhe këtu jam
11 kundra teje. Dhe nëse vazhdon dhe ma bind, ma krijon këtë
12 bindje, unë e ndërpres dëshminë qoftë edhe me dëmtimin tim
13 personal.

14 Jam kundra kësaj. Jam kundra atyre që dojnë me ma dëshmu
15 edhe përly luftën dhe shtetin tonë. Jam, kundra atyne jam
16 ardhë edhe kam luftu, sepse ata ishin regjimi i Millosheviçit
17 dhe i Titos. Qe u bindët ju, edhe na, edhe së bashku i kemi
18 hjekë prej aty. E çka po pret tash me mendu ndryshe?

19 Py. Ju dëshironi që DHSK-ja të rrëzohet apo jo?

20 Pë. Ju po doni, dëshironi që DHSK-ja të rrëzohet ose ta
21 paraqitni të tillë. Ne po dëshirojmë që DHSK-ja të
22 përmirësohet ku ka mundësi, t'i ndjekë të gjitha krimet, asgjë
23 tjetër. A po të pengon kjo ty? Nëse kjo të pengon, po të them
24 edhe njëherë, po, du me u rrëzu nëse të pengon kjo me i ndjekë
25 të gjitha krimet, du me u rrëzu, s'du me ju pa hiç. Edhe jo

1 unë, po e don gjithë populli liridashës i Kosovës, e don
2 demokracia e duhet me e dashtë edhe shteti yt. Me u turpënu
3 nëse ti ke qëllime mono-etnike e selektive, ça mendove?!

4 Py. N.q.s. rruga ligjore për mbylljen e DHSK-së nuk
5 funksionoi, atëherë këtë do ta bënit edhe duke shkelur ligjin
6 apo jo?

7 Pë. Kush e tha këtë?

8 Py. Askush ende, por po ju pyes unë, n.q.s. rruga ligjore për
9 mbylljen e DHSK-së nuk funksionoi...

10 Pë. Zoti Prokuror, unë çdo herë prej që kam ardhë këtu jam ka
11 u thirrë në ligj. Dhe ai që thirret në ligj, ai nuk rrëzon
12 ligje, prandaj kurrë ne nuk kemi sabotu kënd, kurrë s'kemi
13 shantazhu kënd, kurrë s'kemi kërcënu kënd, kurrë s'jemi marrë
14 nëpër gojë kënd, vetëm kemi lyp anën ligjore. Edhe nënshkrimet
15 zoti Prokuror janë ligjore, edhe kërkesa në parlament është
16 ligjore, e drejtë kushtetuese e çdo qytetari. Prandaj nëse ti
17 i këqyr veprimet tona, të gjitha janë veprime ligjore dhe
18 prapë po të them, çdo gjë që është ligjore është e drejtë.
19 Ndërsa ajo çka thu ti është e kundërta asaj çka po e them unë.
20 Nëse ka anë ligjore që përmirëson, pse jo. Çka ke ti këtu
21 kundra përmirësimit? Çka po të pengon ty zbulimi i të gjitha
22 krimeve, a po don me ju dalë në mbrojtje disave? Çka të pengon
23 ty me u zbulu krimet, të cilët janë të nacionaliteteve të
24 tjera, por që s'janë as ushtarë të UÇK-së. S'kanë mujt me bo
25 edhe shqiptarët që s'janë konë ushtarë, të veshur ushtarë. Pse

1 të pengon ty kjo? E ne është tu na pengu kjo. Pse këta të
2 gjithë nuk jemi të barabartë para kësaj Prokurorie? Pse po na
3 i servoni njerëz, po i viktimizoni njerëzit kund ju po doni,
4 pse? Bjerini atë që e meriton, me ty jemi. Ndiqi të gjithë
5 kriminelët, me ty jemi. Dhe jemi kundër çdo tjetër që ty të
6 kundërshton në këtë formë. Prandaj tash ti këqyre a unë e kam
7 anën ligjore apo ti. Unë jam për anë ligjore, çdo gjë që bëhet
8 në anën ligjore. Unë duke u llogarit në anën ligjore sot,
9 mundësohet deklarata jeme këtu, se ndoshta ti s'do të kishe
10 pasë qejf as me më qitë këtu në deklaratë, veç me ma dhanë
11 dënimin që atë ditë që më ke arrestu. Po ligji është çdo gjë
12 që garanton. Ligji e shfrytëzon edhe duhet ta shfrytëzojë
13 secilin njeri në një shtet demokratik pse jo?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, i lutem
15 Sekretares të Gjykatës të nxjerrë dokumentin me numër P24.
16 Është video tjetër me vulë kohore 14:14 deri në 14:38.
17 Transkripti në gjuhën angleze është P24-ET, në faqet 7 deri 8.
18 Fillon me një pjesë, ku thuhet "On this point, I am in
19 complete agreement", që do të thotë: "Në këtë pikë, pajtohem
20 plotësisht". Dhe përfundon tek "We have the confirmation".
21 "Kemi konfirmimin".
22 Py. Zoti Haradinaj, do të shfaqim një tjetër video, në bazë
23 të cilës do t'ju bëj një pyetje.
24 Py. Ma qitni shqip ju lutem transkriptin.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Po, patjetër. Tani është bërë

1 rutinë që do të dalë në ekran edhe transkripti në anglisht
2 edhe ai në shqip.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 [Luhet videoincizimi]

5 Z. HALLING: [Përkthim]

6 Py. Zoti Haradinaj nuk e keni të ndezur mikrofonin.

7 Pë. Po tu hjeket, videon më lufti kjo. Lëshone pak ma poshtë
8 nëse është... dhe nëse është shkelje të kësaj. Shtroje pyetjen
9 zoti Prokuror, s'ka problem. Unë e dëgjova.

10 Py. Pyetja ka të bëjë me pjesën ku thuhet:

11 "Shkelje... edhe nëse është shkelje, e kemi për detyrë që
12 të bëjmë çdo gjë që demanton korrektësinë e kësaj Gjykate
13 sepse është raciste".

14 Është një intervistë që keni dhënë më datën 9 shtator
15 2020. Çfarë keni dashur të thoni me këto fjalë?

16 Pë. Nëse pak përpara ndëgjut Milaim Zekën aty, ky e ka
17 ndryshu mendimin prej opinionit, se përpara ka qenë i bindun
18 edhe në një intervistë para kësaj - ka qenë i bindun që i kemi
19 mbaru na këto ose i kemi fotokopju, ose i kemi bo na. Na ka
20 akuzu për këto. Kështu është një prej atyre gazetarëve që të
21 bën nervozë edhe pse unë kështu e kam pasur shok. Po të bën
22 nervoz edhe don me nxjerrë diçka. Unë po them edhe njëherë,
23 çështja jonë u konë...

24 I AKUZUARI HARADINAJ: A prej fillimit e kam a po? Prej
25 fillimit. Shiqo.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, zoti
2 Haradinaj, zoti Haradinaj, më dëgjoni? Nuk po i përgjigjeni
3 pyetjes, as po i afroheni fare pyetjes. Dëgjojeni dhe njëherë
4 pyetjen dhe përgjigjuni pyetjes. Mos na tregoni për çështje të
5 tjera të cilat ju interesojnë juve.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës,
7 po e përsëris.

8 Py. Pyetja ka të bëjë me pjesën ku thuhet:

9 "Shkelje... edhe po të ketë shkelje, e kemi për detyrë që
10 të bëjmë gjithçka që të tregojmë që kjo Gjykatë nuk është
11 korrekte sepse është raciste, është selektive dhe ja ku e kemi
12 konfirmimin".

13 Zoti Haradinaj, çfarë keni dashur të thoni me këto fjalë,
14 kur keni thënë këto fjalë?

15 Pë. Kur them "shkelje" do të thotë po mendohet që s'ka
16 shkelje. Dhe e kam tu thonë që sido që të jetë ajo që unë do
17 të thotë këtu, nuk po mendoj që është shkelje. Në kontekstin
18 që e them unë fjalën, në gjuhën shqipe, nëse dikush e njeh
19 mirë gjuhën shqipe dhe e kupton se e kemi edhe si dialekt,
20 këtu ka kuptimin shkelje, tu thonë që nuk ka shkelje, nuk po e
21 kuptoj që këtë shkelje, por tu thonë se këtë e bëjmë për hir
22 të transparencës dhe që duhet me u ditë, sepse mendimi jonë
23 për këtë Gjykatë ka qenë i tillë gjithmonë tu u bazu në të
24 dhënat edhe pa ardhë këto dokumente, në të dhënat ku
25 koordinatori i juve, Dëshmitari 2 çdo herë ka dalë publikisht

1 në mediat serbe edhe ato serbe në Kosovë, edhe na ka denoncue,
2 na ka linçue dhe na ka dënu. Prandaj e kemi pasë këtë ide hala
3 pa ardhë këtu letra, të tillë. Kështu që kjo është. Kështu që
4 kjo është. Këtë ta thashë edhe tash, në këtë prizëm, në këtë
5 kuptim.

6 Py. Zoti Haradinaj, ju kuptoj kur thoni që nuk ka shkelje.
7 Por këtu a nuk jeni shprehur në mënyrë kushtore, "edhe po të
8 kishte shkelje", pra edhe nëse do ishte shkelje, pra nuk po
9 flisni këtu për një mundësi?

10 Pë. Po. Do të thotë edhe po të ishte shkelje, do të thotë,
11 është fjala nëse e kanë bo ata. S'ishte faji jonë për këtë
12 shkelje. Nuk i kishim siguruar ne këto letra në mënyrën tonë
13 ose nuk kishim punuar për sigurimin e këtyre letrave. Dhe edhe
14 sot po them, nuk kishte pse ne të merakoseshim për një diçka
15 që s'është e jona. E jona ka qenë vetëm me e tregu çka na ka
16 ardhur. Dhe mendoj që kemi kryer obligimin e transparencës së
17 interesit publik. Kjo ka qenë për ne interesante. Për mu nuk
18 është interesante se si ti i ruan dokumentat e tu. As nuk më
19 merakos a i ruan, as s'i ruan. Edhe ti e din se po të mos
20 ishte ashtu t'i s'i kishe ruajtur. Prandaj s'është problemi i
21 jemi ai, për në këtë kuptim e kam thonë. Të jenë ose të mos
22 jenë është problem ose është faji i dikujt tjetër, nuk është i
23 joni.

24 Detyrë e jona ka qenë për hir të transparencës çka na ka
25 ardhë me e qitë. Po të kishim dashtë - edhe njëherë po them -

1 e komunikim cek s'di sa herë - po të kishim dashtë, ne e
2 kishim fotografu, ne e kishim mbajjt ma gjatë, ne e kishim
3 publiku, edhe ishin të gjitha jashtë. Po t'i kishim dashtë me
4 i bo ato çka ti po ke qejf me më ngarku mu këtu. S'ke mujt me
5 më ndal.

6 Mos harro, unë jam edhe qytetar i Suedisë. Po të kisha
7 dashtë kisha thirrur gazetarë suedezë, po të kishim dashtë çka
8 po mendon ti me na ngarku, na e kishim bo këtë punë. S'kemi
9 dashtë. Kemi dashtë me u konë transparentë edhe ndaj popullit
10 tem, ndaj vendit tem, ndaj jush. Përkundrazi, kjo u dashtë me
11 u marrë si kompliment edhe si bashkëpunim me ju, qartas me ju
12 ndihmu ju, se nëse janë konë të juvet me e ditë çka ka ju
13 ndodhë. Për këtë e kemi bo. Edhe për ju e kemi bo edhe pse
14 s'jam pajtu me ju, sepse kjo dëmtonte popullin tonë.

15 Py. Pra kur thatë që DHSK-ja është raciste dhe selektive, ky
16 ishte një lloj komplimenti?

17 Pë. Ky është kompliment që ju ja jepni vetit, nuk jua kam
18 dhënë unë. Metoda e punës tënde, metoda e punës juaj,
19 seleksionimi i njerëzve, seleksionimi nën një nacionalitet,
20 sepse as shqiptarë të tjerë nuk...vetëm kush u konë, kush
21 është shqiptar dhe është UÇK. E ke nda saktë, e ke definu, e
22 ke selektu, e ke bo targetin dhe ti s'del prej atij targeti
23 dhe s'po pranon me dalë. Ky është definim që ja ke dhënë ti
24 dhe ja ke dhonë dhe populli kështu të thotë, nuk është definim
25 i jemi, po definimi i opinionit çfarë qëndron sot në Kosovë

1 prej ju, fatkeqësisht ky është.

2 Py. Zoti Haradinaj, në këtë diskutim për të cilin po flasim,
3 ju po thoni në 9 shtator 2020 se jeni të gatshëm të kryeni
4 edhe një vepër penale për të treguar, shkelje - pra më falni -
5 , për të treguar që kjo Gjykatë është e opinionuar, a nuk
6 është kështu?

7 Pë. Nuk po e kuptoj pyetjen në 9 shtator çka kam thonë, ku
8 asht?

9 Py. Në ekstraktin e videos për të cilën po flasim, kemi folur
10 tani.

11 Pë. Ma lëshoni edhe një herë videon ta dëgjoj.

12 Py. Mbase është më shpejt po të lexoj atë, fjalët përkatëse,
13 deklaratën përkatëse.

14 Pë. Lëshojeni këtu në shqip transkriptin.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, zoti
16 Cadman.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Mbase do ishte më e shpejtë, do
18 ishte dhe më e shpejtë dhe më mirë që të dëgjojë me veshët e
19 tij zoti Haradinaj se çfarë ka thënë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 shikojmë transkriptin. Nuk ka asnjë kundërshtim, argument për
22 transkriptin. Le të fillojmë këtu.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

24 Py. Do t'jua lexoj edhe njëherë fjalinë në anglisht dhe mund
25 të shikoni fjalinë përkatëse në transkriptin në shqip.

1 "Shkelje... edhe nëse është shkelje, ne e kemi për detyrë
2 që do të bëjmë çdo gjë që e demanton korrektësinë e kësaj
3 Gjykate sepse është raciste, është selektive dhe ja ku u
4 konfirmua".

5 Pyetja që kam unë është, në këtë deklaratë këtu ju po
6 thoni, po deklaroni se jeni të gatshëm të bëni një shkelje për
7 të treguar që kjo Gjykatë është e njëanshme apo jo?
8 Pë. Zoti Prokuror, po du me besu se nuk je ka e bon me qëllim
9 se me të vërtetë nuk je ka kupton çka kam thonë. Po du me besu
10 edhe pse prej teje hala që s'ndjeva qyshdo po i ndryshon
11 fjalët. Unë them edhe nëse është shkelje, i referohem, nëse
12 është shkelje e ka bo tjetër kush, s'jemi tu e bo tjetërkush,
13 s'jemi tu e bo ne atë shkelje, në këtë pikëpamje është. Jo do
14 ta shkel unë. Por nëse është shkelje, është shkelje e
15 tjetërkujt dhe këtu aludoj për ju, e keni bo këtë shkelje ju.
16 Kështu i referohena kësaj shkelje. Nuk them do ta shkeli, po
17 nëse është, fjala "nëse është", është me një pikëpyetje
18 shkruhet që këtu s'e ka. Edhe të shkruhet për me ta sqaru ty
19 se qysh është shqip. "Nëse është" do të thotë është fjalë
20 "nëse" nuk do me thonë - më duket anglisht është "maybe" - se
21 s'po du me hy në gjuhë atje ku s'jam... Prandaj unë them "edhe
22 nëse asht" nuk është shkelje e jona. Nuk ia kam atribu vetit
23 që do të shkeli e do të bëj çdo gjë unë. Ndërsa këto të tjerat
24 që jeni ksi, këtë opinion e keni krijuar ju me sjelljet e
25 juve. Ky nuk o opinion që jua kam ngjitur unë edhe jua kam

1 thonë unë për të parën herë. Jua kam thonë katër vjet më

2 përpara se me ardhë unë. Të lutem.

3 Py. Zoti Haradinaj, e kuptoj, por nuk është pyetja që po ju

4 bëj tani. Pyetja është, në këtë deklaratë, ju po thoni që jeni

5 të gatshëm të bëni një shkelje për të treguar që kjo Gjykatë

6 është e njëanshme, a nuk është kështu?

7 Pë. Nuk është e vërtetë kjo çka po thu dhe po më detyron me

8 thonë që s'është e vërtetë. Këtu po thojmë "ne kemi detyrë që

9 të bëjmë çdo gjë që është", këtë çka është, jo të bëjmë ne çdo

10 gjë. Jo të bëjmë ne çdo gjë për me ju demontu. Por ne duhet me

11 bo çdo gjë me tregu çka është kjo çka është. Se për me bo na

12 çdo gjë, është sikur ne të kishim ndërmarrë diçka kundër juve,

13 kur të kishim thonë diçka kundër juve - s'jua kishim pritë

14 oficerat hiç brenda, vetëm kur t'mi kishe vu prangat. Kështu

15 që veprimi jonë nuk ta tregu ty as me Dëshmitarin 1 as me sa

16 herë keni kërku.

17 Është faji i juve. Unë e di që do të thuash apat e

18 kuptova, s'e kuptova. Por po të them, ne do të bëjmë çdo gjë,

19 do të thotë që ne do bëjmë çdo gjë. Kur të thush çdo gjë, i

20 bie në anën ligjore, që - nga ana ligjore - që me i tregu këtu

21 ça na kanë ardhë vëlla, me u konë transparentë. Dhe prapë po

22 të them çdo gjë bëhej me u konë transparent. Kur shoh që diçka

23 po shkon në dëm të interesit të përgjithshëm.

24 Zoti Prokuror, mos harro, këtu s'kam asgjë personale,

25 hiç, asnji send hiç personale s'kam nëse e këqyr këtu. Vetëm e

1 shoh që mue po ma kthen kohën në një shtet të qujtun të
2 pavarur, të njoftun me çdo shtet, po ma kthen kohën e vjetër
3 që unë mos me guxu me fol. Prandaj them do të bëj çdo gjë. Dhe
4 po ta përsëris çdo gjë e bëj. Po çdo gjë nuk do të thotë që do
5 të bëj inkriminim. Çdo gjë nuk do të thotë do të vraji, do të
6 mys, do të kërcënoj. Do të bëj çdo gjë që është e lejueshme.
7 Gjersa e them haptazi është çdo gjë. Ai që don me bo kështu në
8 kuptimin e keq e negativ, ai nuk e thotë.

9 Py. Pra, po thoni që nuk do të kishit penguar punën e DHSK-së
10 edhe pse po ta bënit këtë gjë mund të çonte në abrogimin e
11 saj?

12 Pë. Po të rekomandoj vetëm një rast, qoftë një sekondë çka u
13 bo diçka kundra juve, përpos anës ligjore. Të kërkosh, të
14 shqyrtohet në Parlament dhe të amendamentohet një ligj ku
15 ndjek të gjitha krimat, po kjo jo vetëm që është mudi i mirë,
16 po duhet edhe me u mburr. Çka keni kundra këtu? Ku [e
17 padëgjueshme] po me të vërtetë po doni me na bo budallë? Çka
18 ke kundër z. Prokuror? Unë s'kam të drejtë me të shtru pyetje.

19 Po çka ka kush kundër zbulimit të gjitha krimeve. Kujt po
20 i pengon kjo? Dhe pse gjithë kjo rezistencë sa edhe me dënu
21 njerin që thotë kështu? Pastaj të kërkosh në mënyrë të
22 ligjshme në Parlament, të kërkosh në mënyrë të ligjshme përmes
23 deputetëve, ana ligjore që është - çka ka këtu inkriminuese,
24 çka ka këtu të keqe? Kjo s'do me thonë që je armik,
25 përkundrazi, jam mik, dashamir i drejtësisë, jo i juji, i

1 drejtësisë së mirëfilltë. Por jo i juji në këtë formë, në këtë
2 qasje që kini jo.

3 Py. Duke pasur parasysh qasjen e ndjekur, doni që ta pengoni
4 këtë qasje apo jo?

5 Pë. Duke pasur parasysh qasjen e ndjekur, dua të përmirësohet
6 kjo, për ma mirë kjo, për ndjekjen e të gjitha krimeve. Kaq e
7 thjeshtë është. Pse po e komplikoni? Dua që ta ndryshoni
8 qasjen dhe ta përmirësoni me i ndjekë të gjitha krimet e
9 kryera në Kosovë pikë. Dhe jemi në rregull. Jemi dhe
10 bashkëpunëtorë mes veti, jemi dhe mbështetës mes veti. Do t'i
11 mbështesim të gjithë. S'do t'i mbështesim vetëm kriminelët, ç
12 ka të keqe?

13 Py. Pra, a e kam kuptuar qartë që nuk doni të pengoni qasjen
14 e Gjykatës, thjesht doni ta ndryshoni?

15 Pë. Po.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Sekretarja e Gjykatës a mund të
17 nxjerrë materialin me numër P18?

18 I AKUZUARI HARADINAJ: Nuk pajtohem me qasjen që ka. Dojmë
19 ta ndryshojmë në këtë formë, për ndjekjen e të gjitha krimeve.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Për materialin P18, pjesa e
21 transkriptit është 29:19 deri në 29:38. Në transkriptin në
22 anglisht P18RED, faqet 5 dhe 6, pjesa fillon me fjalët në
23 anglisht "I care only for the veterans" "kujdesem vetëm për
24 veteranët" dhe pastaj mbaron me fjalët "picked up from
25 Milosevic", "marrë nga Millosheviçi".

1 Py. Zoti Haradinaj, siç e kuptuat, e kam dhe një tjetër video
2 të shkurtër por do të presim sa të nxjerrim dhe transkriptet e
3 videos në ekran.

4 Pë. Në rregull.

5 [Luhet videoincizimi]

6 Z. HALLING: Të sigurohem që rreshti i fundit, ishte:
7 "atë drejtësi që morëm prej aparatit të Millosheviçit, të
8 dhjefsha".

9 Py. Zoti Haradinaj, po flisni për Dhomat e Specializuara të
10 Kosovës në këtë dialog apo jo?

11 Pë. Po flas për njeriun e Millosheviçit që ju e keni
12 koordinator dhe saktë pajtohem plotësisht çka kam thonë. S'po
13 du me ta përsërit atë fjalën e dytë që e fola për Milloshin.
14 Por e le të kuptoj pikë për presje pajtohena me këtë... Dhe
15 çdo gjë po të them edhe njëherë këtu që vjen prej oficerëve
16 dhe njerëzve përfaqësues të Millosheviçit, unë jam kundërshtar
17 deri në vdekje me ta. Nëse ti e pranon që je, unë po të them
18 atëherë që njëmend më ke kundërshtar. Dhe duhet me u konë
19 çdokush kundra Millosheviçit. Vetë e keni shpallë kriminel, se
20 s'keni mujt me mbërrit deri në fund po kasap të Ballkanit,
21 pesë luftëra i ka bo. Dhe jam kundra çdo gjëje që vjen prej
22 Millosheviçit dhe do të jem çdo herë. Nëse kjo ju prish punë
23 atëherë vazhdoni denomëni lirisht se jam, kam me konë dhe do
24 të jem sa ta kem frymën gjallë, ndaj çdo ideje të
25 Millosheviçit dhe njerëzve të tij që t'i i ke për koordinator

1 këtua dhe bazohesh këtua dhe e falënderon.

2 Py. Dhe...

3 Pë. Kështu çka thashë.

4 Py. A mendoni se DHSK-ja e ka marrë drejtësinë e aparatit të
5 Millosheviçit?

6 Pë. Mohomani që nuk e ke [REDAKTUAR]koordinator, po e ndërroj
7 mendimin.

8 Py. Zoti Haradinaj, ju lutem ju thashë që të mos përmendni
9 asnjë emër përtej atyre që ju lejohet të diskutoni. Por
10 gjithsesi pyetjes sime nuk iu përgjigjët. Përgjigjuni me "po"
11 ose me "jo". A mendoni se DHSK-ja, drejtësinë e ka marrë prej
12 aparatit të Millosheviçit?

13 Pë. Me këtë koordinator mendoj se po dhe metodat që ajo nga
14 shkon mendoj se po. Prandaj në momentin që e shtini zbulimin e
15 të gjitha krimeve, ndryshoni qasje. Prandaj janë këto që
16 njerëzit nuk ju dun. Kështu po reflektoni. Ndoshta është e
17 gabueshme, kështu po reflektoni. Dhe është mirë dikush të
18 thotë sesi po reflekton. Është ndihmë, përkundrazi duhet me u
19 konë falënderues. Kështu po reflektoni me sjelljet e juve
20 kështu po reflektoni. Njeriu që ka dënu me vdekje gjinë,
21 Vuksheviçi nëse guxohet me fol, njeriu i parë i Millosheviçit.
22 Dyshi, njeriu i parë i Millosheviçit. Do t'i referoheni ktyne
23 çka mendon që ata mendojnë për shqiptarët. Patologjikisht ata
24 kanë kriju sindromën me i urrejt shqiptarët. S'mund të vijë
25 asgjë tjetër. Edhe nëse vjen i drejtë, besomani nuk do të jetë

1 e besueshme prej popullit tim, besomani këtë. Njëqind vjet na
2 kanë vra, pre, gri.

3 Py. Pra nga citimi, në bazë të citimit është që, a është e
4 vërtetë që do ta pengonit drejtësinë e DHSK-së gjatë gjithë
5 jetës?

6 Pë. O jo të DHSK-së, po edhe të Zotit që bazohet në të dhënat
7 e Millosheviçit unë jam kundërshtar, sa herë po don me ta
8 sqaru. Po vorri më qet prej dheut mos me e kundërshtu
9 Millosheviçin.

10 Py. Pra nga kjo përgjigje e kuptoj që "po". U përgjigjët me
11 "po" pyetjes time?

12 Pë. Çka kuptove, çka kuptove që jam kundra Millosheviçit? Po.

13 Py. A do ta pengonit drejtësinë e DHSK-së gjatë gjithë jetës
14 tuaj? A është "po" përgjigjja juaj për këtë pyetje?

15 Pë. Nëse ju punoni me direktivat e Millosheviçit, po. Po. Po.

16 Py. Dhe ky është dhe besimi juaj, kështu e besoni apo jo?

17 Pë. Kjo është ajo që ju po e reflektoni dhe ma keni kriju
18 bindjen, ju, sjelljet e juve. Dhe jo vetëm mund. Nuk po du me
19 zgjeru mendimin për me e zbutë, po qoftë edhe vetëm mu.

20 Py. Pra nuk ka të bëjë thjesht që të ndryshoni DHSK-në vetëm,
21 por jeni të gatshëm edhe ta pengoni DHSK-në apo jo?

22 Pë. Nëse është DHSK-ja që bazohet mbi të dhënat dhe idetë e
23 Millosheviçit edhe me e pengu. Po unë nuk besoj që një i tillë
24 je ti ai që po ja zgjat këtë epitete taban, dhe në një farë
25 mënyre po e pranon. Unë jam që DHSK-janë të ndryshojë një

1 qasje, t'i zbulojë të gjitha krimet. Dhe s'kam nevojë me u
2 konë kundër. Mos u mundo me më hidh anej ka unë nuk mendoj në
3 fakt. Nuk jam, edhe njëherë po ta përsëriti, nuk jam kundra
4 drejtësisë dhe nuk jam kundra pengimit të zbulimit të vrasësve
5 apo kriminelëve apo sido t'i quj unë.

6 Po nuk jam që të këqyrni vetëm në një vend. Sepse me këto
7 ju jeni ka boni, po doni duke u thirrë në koordinatorin e juj,
8 ju jeni dhe ka i rehabilitoni. Po i rehabilitoni kriminelët e
9 tjerë. Po i rehabilitoni njerëzit me folë shlirë. Prandaj
10 thjesht po them, unë jam kundra çdo gjykate që është
11 selektive, kudo qoftë edhe në një shtet tjetër po të ishte,
12 unë jam kundra, jo vetëm në vendin tim. Edhe besoj që duhet të
13 jeni edhe ju kundër, të paktën për kodin juridik që duhet me e
14 pasë një njeri. Prandaj po të them edhe njëherë, nuk ke nevojë
15 me më interpretu mu, unë jam ka thonë çka ka them. Jam kundra
16 çdo gjykate që punon mbi parimet e Millosheviçit. Jam kundër
17 dhe do të jem kundër krejt jetën time. Edhe brezi jem që vjen
18 do të jetë kundra ideve dhe parimeve të Millosheviçit. Dhe
19 mburrem me këtë.

20 Py. Zoti Haradinaj.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ardhur
22 momenti për pushimin e drekës.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta bëj edhe një pyetje të
24 fundit?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 Py. Me "po" ose me "jo" se ka ardhur dhe koha e pushimit.

3 Nëse DHSK-ja do të vazhdojë, do të vazhdonte të mbetej kështu
4 siç është, do ta kundërshtonit gjithë jetën?

5 Pë. Po tash unë s'po e kam të qartë se ti ma kundërshtove
6 idenë teme. Unë s'po e kam të qartë, është sesi jeni ju? Ma
7 sqaro si jeni dhe unë po jap një përgjigje.

8 Py. Me "po" ose me "jo". Nëse DHSK-ja do të vazhdojë të
9 mbetet siç është, pa i bërë ndryshime, do ta pengonit për
10 gjithë jetën apo jo? Me "po" ose me "jo".

11 Pë. Unë po të them nëse ti e tregon se je në ato parimet e
12 Milloshit, unë po të them jam kundra. Por nëse ti thu që
13 kështu që po vepron, unë do të përdori çdo rrugë ligjore qysh
14 kam përdor deri tash, thirret Parlamenti - do të bëj çdo rrugë
15 ligjore që me mujt me ndërhy sadopak në këtë qasje të juvet që
16 me e shti vetëm fjalën për të gjitha krimet e kryera pa marrë
17 parasysh nga kush që janë bo në Kosovë, kaq. Ose nëse këto
18 s'mundi, sepse ka krime që kanë kryer serbët e Serbisë. Për
19 qytetarët Kosovarë pra. Nga të gjithë qytetarët e Republikës
20 së Kosovës, mjafton dhe jemi në rregull, jemi shokë, jemi
21 dashamirë, jemi bashkëpunëtorë, jemi çka të dush. Edhe nëse ti
22 këtë nuk e bën, atëherë unë jam kundra në anën ligjore çdo
23 herë që ka mundësi do ta ngresh në Parlament. Ana ligjore dhe
24 te... është legjitime me e kundërshtu me anë ligjore. Por jo
25 të krijojë dhunë ose po mundohena me bo shantazhe a këto çka

1 po i quani ju. Jo, se s'kam nevojë, është ana ligjore.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
4 pushimin e drekës. Do të bëjmë ndërprerjen deri në orën 2.30.
5 Do të rishihemi atëherë.

6 --- Pushimi i drekës fillon në orën 13.02

7 --- Seanca rifillon në orën 14.30 pasdite

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kam
9 ndërmend t'ju bie shumë në qafë, por a keni ndonjë përgjigje
10 nga eksperti?

11 Z. CADMAN: [Përkthim] E prita pyetjen tuaj dhe i dërgova
12 një kujtesë zotit Reid, por nuk kemi marrë ende përgjigje. Po
13 pres që të na kthejë përgjigje. Do të vazhdojmë t'i kërkojmë
14 informacion gjatë ditës sot.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Nuk ka
16 mikrofon].

17 Mund t'i kujtoni që ai ka pranuar që të jetë dëshmitar
18 ekspert. Dhe duhet të jetë këtu për të dhënë dëshmi, sepse
19 vonesa në ardhjen e tij ose në dhënien e dëshmisë së tij vonon
20 çdo gjë tjetër.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, ia kemi bërë të qartë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
23 di që ia keni bërë të qartë.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] E vetmja vështirësi është që duhet
25 t'i japim mundësinë atij të flejë, sepse dallimi midis zonave

1 -- orari nga këtu atje është i madh. Po kështu në interes dhe
2 ndihmë për të ndihmuar Gjykatën dhe për ecjen, ecurinë e
3 këtyre procedurave, ne kemi përgatitur të gjitha transkriptet
4 që janë në listën e prezantimeve të Prokurorisë në gjuhën
5 shqipe për të ndihmuar zotin Haradinaj për t'i parë ato.

6 Ia kam treguar Prokurorisë. Ata nuk kanë kundërshtim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po do të
8 mundej ai t'i gjejë vetë faqet ku janë?

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Ato janë të shënuara sipas numrave
10 ERN, pra, numrit të provës dhe mund t'ia tregojmë atij.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po janë edhe
12 numrat që fillojnë me P. A po do të përdorni vetëm numrat ERN?

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm numrat ERN.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ne do të përpiqemi. Por
15 transkripti do jetë gjithmonë në ekran edhe në qoftë se e kemi
16 të vështirë të gjejmë dokumentet.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
18 Haradinaj, dua t'ju kujtoj edhe njëherë duhet, ju lutem, të
19 flisni më ngadalë sepse përkthyesit e kanë shumë të vështirë
20 t'ju përkthejnë dhe është shumë e rëndësishme që të përkthehen
21 siç duhet ato që thoni ju. E kuptoni?

22 I AKUZUARI HARADINAJ: Po. Do të mundohem.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
24 bëni ç'është e mundur që të ngadalësoni, merrni frymë herë pas
25 here dhe pastaj vazhdoni.

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 Py. Zoti Haradinaj, do të vazhdojmë përsëri me një video.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo ka numrin 08935504. Ky është
4 numri ERN. Prova materiale, numri i provës materiale është P8.
5 Është në vulën kohore 50:33 deri në 51:01. Në transkriptin
6 anglisht, kjo është në faqen 26. Pjesa fillon me atë ku thuhet
7 "paketa e parë ishte" dhe mbaron "që është dorëzuar apo është
8 dhënë nga armiku". Të presim pak derisa të dali në ekran.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 Py. Zoti Haradinaj, për të konfirmuar, sepse nuk e dëgjova
12 përkthimin. Pako e para ishte:

13 "O qyqona, o budall, o spiuna të lind".

14 Kjo pjesë, më intereson ky citim. Ku janë këto "O spiuna
15 të lind"? Kush janë këta spiuna të lind të cilëve ju
16 referoheni?

17 Pë. Kjo është një shprehje që unë mendoj diku bashkë nga
18 shteti juaj dhe shumë shtete të tjera e kanë fol për spiunat.
19 Kështu që me kanë një spiunë i lindur do të thotë duhet me
20 kenë prej babës që është bashkëpunëtor me okupatorin dhe që
21 pastaj edhe ai vazhdon punën për shembull. Siç është çifti --
22 edhe pse ky ka punu për popullin e vet, po dhe detyrën e ka
23 pasë si spiun. Numri 2. Tjetër, ka pasë fatkeqësisht, ka pasë
24 të tillë dhe në Kosovë dhe ka ende të tillë që kanë punu
25 ngushtë me sistemin jugosllav dhe me sistemin e Millosheviçit

1 dhe që ju ka bashkangjtit atyne, siç janë [REDAKTUAR]me babë të
2 vetë e me vëlla të vetë.

3 Pastaj, shikoni thotë, çdo herë kjo thënia që ju
4 përdorin, ju mbërtypin, jo ktën, kjo a thënie që përdorë edhe
5 gjatë Luftës së Dytë Botërore, edhe të Parës Botënore, edhe në
6 Francë, edhe në Angli, edhe çdokund. Se ne s'kemi mujt me
7 përdorë këto, se ne jemi çliru vonë. Këto i kanë përdorë
8 popujt që janë çliru. Dhe thënie janë marrë prej thënieve që
9 unë kam lexu në libra. Dhe një tjetër?

10 Edhe spiunë mbase u ka shfrytësu -- prandaj mos bëhi që u
11 mbron dikush -- sepse historikisht a fjalë. Këtu ju u
12 drejtojna unë. Shiqo, zoti Prokuror, së pari që kjo, që ky
13 emision ta cekim se a mirë për Gjykatën me e ditë. Ky është
14 emision humoristik. Që ky emision këtu që jam, ky është
15 emision i njohur humoristik. Ky është vetëm për humor. Ky nuk
16 është ndonjë media që ka programe serioze asnjëherë. Së pari,
17 le të dihet edhe interesi çfarë ka qenë këtu.

18 E dyta, unë nuk e di se ndoshta sipas kësaj që po ju, unë
19 u dashë me kanë në gjyq edhe në Gjykata të Kosovës. Vetë
20 qeveria jeme me më qit. Se unë kem lyp, ne dhe organizata
21 jonë, ne kemi lyp që zbatohet në kuvend ligji i lustracionit
22 dhe pastaj vetingu. Dhe ligji i lustracionit ka të bëjë me ata
23 njerëz të cilët kanë bashkëpunu drejtpërdrejtë me okupatorin,
24 që dihen botënish.

25 Kështu që unë edhe aty, nëse këqyret, unë paskam thy

1 rregullat. Po unë mendoj që mendimi i lirë me kërku diçka që
2 është legjitime, s'është. Prandaj këtu e kam fjalën te
3 lustracioni. S'ka të bëjë këtu me këto sende dhe me njerëz që
4 dojnë me u marrë me sendet, sepse ne jemi kanë shumë të
5 sulmuar këtu, zoti Prokuror. Na gjatë kësaj kohe, mos harroni,
6 ne jemi kanë shumë më në presion se ju. Ju keni ba hajgare. Ju
7 keni neglizhu. Ju s'jeni tregu asnjëherë të interesum me u
8 marrë me ne. Ne edhe barrën e juve pa dashje na u kanë ngarku.
9 Jemi kanë shumë të sulmum.

10 Tash se kush i nxit? E dinë ata, nga të gjitha partitë,
11 nga vetë pushtetarët. Dhe po ta them të drejtën, kur kem lyp
12 lustracionin ne jemi kanë shumë ma të sulmum. Prandaj nuk e
13 kam peticu gabimisht këtu, as patjetër tuj tregu se ne kemi
14 problem. Dhe spiuni i lindur s'besoj që i keni lind ju. Ata
15 dhe spiun i lindur është ku ka dhe babën, e që fatkeqësisht në
16 Kosovë ka. E fatkeqësisht kemi edhe në krye të qeverisë.

17 Tani nëse edhe kjo është e dënueshme, le ta bëjnë ligjit
18 e lustracionit dhe do ta shihish. Kështu që nuk është ka i
19 identifiku ose i dedikohet dikujt posaçëm ose njerëzve të
20 kësaj Gjykate apo të asaj Gjykate. Unë nuk mendoj që spiuni
21 është dëshmitar. Spiuni është spiunë. E ka detyrën e vetë
22 gjatë kohe lufte. E ka detyrën me i shkatërru një shtet. E ka
23 detyrë me bashkëpu me okupatorin me ju përmbajtë popullin e
24 vetë në robni.

25 Unë s'besoj që -- unë prapëseprapë po du me besu se ju

1 jeni, bile, një pjesë të Kosovës e keni. Kështu që është sikur
2 me dashtë ti me bë vetë precedent në këtë punë. S'ka të bëjë
3 me këta njerëz që kanë të bëjë me këtë Gjykatë. S'ka çka të
4 bëjë spiuni -- kur t'i thuash njërit spiun, ai nuk është as
5 dëshmitar. Dëshmitari është kur kallëzon diçka. Spiuni është
6 ku në dëm të vetit ose spiunon, thjeshtë manipulon. S'ka të
7 bëjë me këta çka ju po mendoni me tentu dhe me i japë drejtën.

8 Plus është, këqyrni mirë, është emision humoristik.

9 Emisioni më humoristik që është i mundshme në Kosovë.

10 Py. Pra, kur i keni thënë këtyre spiunëve të lindur që "mos
11 mendoni që keni dikënd që ju mbron", kjo ishte hajgare në këtë
12 program humoristik?

13 Pë. Këto janë përdorë në të gjitha shtetet e librat që kam
14 lexuar gjatë Luftës së Parë e të Dytë Botërore për spiunët.

15 Këta e ka thënë edhe gjatë luftës së kohës së Hitlerit,
16 fashizmit. Kjo a thënë edhe gjatë revolucionit borgjez-francez
17 në Francë. Kjo a thanë edhe gjatë revolucionit në Spanjë. Në
18 Itali. Çdokund. Sepse ne, thashë, nuk e kemi pasur luksin, do
19 të ishim kanë mirë që të kishim mujt ne me folë për spiunët,
20 po na jemi çliru në 1999. Kështu që i referohet kohërave
21 historikisht që kanë ndodhë. Dhe deshe s'deshe ti, kjo u ka
22 ndodhë atyre. Unë nuk po besoj hala që ju prej ime jeni tuj
23 punu me spiunë dhe s'di pse po e lënë me nënkuptu dhe po i
24 dëmton edhe vetë organin që ti punon.

25 Py. Pra, kjo pjesë nuk ishte hajgare kjo që thatë. Këtë e

1 keni thënë seriozisht?

2 Pë. Ti po mendon që unë e kam thënë seriozisht?

3 Py. Kur thatë: "Ju o qyqanë, ju budallenj, ju spiuna mos
4 mendoni se dikush do t'ju mbrojë", e the këtë seriozisht nuk
5 po bëjshe hajgare kur e the këtë?

6 Pë. A keni dëshirë me jua ilustru sa seriozisht e kam thënë?

7 Py. Unë dua t'i përgjigjeni pyetjes sime, zoti Haradinaj. A
8 ishte deklaratë serioze kjo?

9 Pë. Asgjë s'ka serioze. Prandaj nëse don me e ditë, me e
10 ilustru sa seriozisht unë po ta ilustroj me një fakt. Pastaj
11 ti e kupton saktë. Edhe Paneli.

12 Py. Për çfarë e keni fjalën?

13 Pë. Mendoj që ju ka ndodhë edhe ju, nëse je prind. Ka ndodhë
14 shpesh kur një gjellë shoqja ma ka mëshef për për mos me u
15 trashë. Mu ma kanë tregu fëmija. Dhe unë i kam thënë kjo -- ti
16 je spiunia e babës. E kupton ti këtë fjalë tash që unë i kam
17 thënë fëmijës tim me të vërtetë spiun edhe pse përdoret fjala?
18 Në këtë prizëm është e thënë kjo fjalë.

19 Py. Zoti Haradinaj, të lutem ndoshta vetëm me "po" ose "jo".
20 A është kjo deklaratë serioze kjo që keni thënë? E keni thënë
21 seriozisht; "po" ose "jo"?

22 Pë. Përderisa nuk është në një emision serioz, është jo
23 serioze. Dhe jo.

24 Py. Tani dua t'ju tregoj një video tjetër.

25 Z. HALLING: [Përkthim] I kërkoj ndjesë sekretarisë së

1 Gjykatës sepse do ta ndryshoj videon që ju dhashë atyre. Kjo
2 është video P37. Me numër 08273302. Dhe është në fazën kohore
3 në vulën kohore 1 orë, 4 minuta, 52 sekonda, deri në 1 orë, 5
4 minuta dhe 6 sekonda. Në transkriptin në anglisht, është në
5 faqen 5 dhe kjo pjesë fillon me "Në anën tjetër", dhe mbaron
6 me "kemi deklaruar publikisht".

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Akoma po ngarkohet
8 videoja në sistem. Do të ketë pak vonesë.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare.

11 Py. Zoti Haradinaj, kjo është një intervistë nga 24 qershori
12 2020. Po shikoj videon. Ky është program komik, humoristik?

13 Pë. Ky është program shumë serioz dhe unë këtu kam folë shumë
14 seriozisht. Dhe atë e thashë deri që tash, ato që thashë këtu
15 deri tash e sqarove. Fjala brenda ta sqaron se ç'ka kam thënë.
16 Po qe se është e tillë.

17 Py. Pra, kur thoni tradhtarët dhe spiunët në favor të këtij
18 Tribunali, për këtë e keni fjalën?

19 Pë. Të cilit Tribunal?

20 Py. Këtij Tribunali. Kësaj Gjykate.

21 Pë. Më fal, atëherë unë jam ulur këtu gabimisht. Unë e di që
22 jam ul në Gjykatën e Kosovës. Atëherë unë po çojna prej këtu.

23 Py. Zoti Haradinaj, kur folët për çdo tradhtar dhe çdo spiun,
24 që është pro kësaj Gjykate e keni fjalën për këtë Gjykatë apo
25 jo?

1 Pë. Zoti Prokuror, edhe njëherë po e them. Nuk e vazhdoj më
2 deklaratën teme nëse kjo Gjykatë është Gjykatë e Tribunalit.
3 Ajo ka përfundu për Kosovën, për Jugosllavinë dhe unë atëherë
4 jam këtu gabimisht dhe çojna prej këtij momenti, nëse është
5 Gjykatë e Tribunalit. Krejt aty domethënë më kërkon mu falje
6 dhe -- [Nuk ka mikrofon].

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
8 Haradinaj. Zoti Haradinaj.

9 I AKUZUARI HARADINAJ: [Nuk ka mikrofon] -- zoti Gjykatës,
10 po ma ndal sa dush telefonin por -- [Nuk ka mikrofon]. A jam
11 në Gjykatë që përfaqësojnë Kosovën apo jam në Tribunal? Unë
12 jam ka e kuptoj keq.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
14 Haradinaj, ju lutem përgjigjuni pyetjes.

15 I AKUZUARI HARADINAJ: Unë nuk përgjigjna pa e ditë ku
16 jam. Kështu e kuptova keq dhe kjo mu më ofendon. Më ofendon
17 sepse do të thotë nuk jam ka përgjigjna për ato për shka jam
18 ardhë. Ose ta ndryshon pyetjen, të thotë e thashë gabim.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju bën
20 pyetjen për një deklaratë që e keni bë ju.

21 I AKUZUARI HARADINAJ: Unë s'kam fol as këtu për
22 Tribunalin, as është tema këtu për Tribunalin. Ndoshta është e
23 përkthye gabim te ju Tribunal. Mua mu përkthi Tribunal.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duket se
25 kjo ishte deklarata juaj, zoti Haradinaj?

1 I AKUZUARI HARADINAJ: Unë kam përmend Gjykatë, nuk kam
2 përmend Tribunal, të lutem. Nuk po e shoh. Ose më ka di me
3 lexu.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Do të përpiqem ta bëj pyetjen në
5 një mënyrë tjetër.

6 Py. Zoti Haradinaj, për cilin institucion ligjor të
7 drejtësisë e kishit fjalën në këtë citim?

8 Pë. Kam me ngutë edhe njëherë ta ndëgjojmë se -- [Nuk ka
9 mikrofon].

10 I AKUZUARI HARADINAJ: Më fal. Më fal më ke dekoncentru me
11 ato çka fole. A bën me lëshu edhe njëherë videon me ndëgju. Të
12 lutem. S'e kam të qartë tash. S'jam ka muj as e lexoj.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë ta luajmë videon.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, të luhet
15 video edhe njëherë.

16 [Luhet videoincizimi]

17 I AKUZUARI HARADINAJ: Ju lutem, shtroni pyetjen. Unë e
18 dëgjova saktë. Do të thotë, ajo çka po mendoj unë, jo çka e
19 thatë ju.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Ka një problem terminologjie. Në
22 shqip përmendet fjalë Gjykatë dhe jo Tribunal. Besoj ka
23 problem terminologjie.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë nuk jam
25 në gjendje ta marr këtë vendim.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Mënyra sesi do ta bëj pyetjen tani
2 e shmang këtë problemin e terminologjisë.
3 Py. Dhe kjo është pyetja që ju bëra zoti Haradinaj, para sesa
4 të luhej videoja. Pra, zoti Haradinaj, për cilin institucion
5 juridik e kishit fjalën në këtë video që sapo dëgjuam?
6 Pë. Do të thotë, këtu fjala është konkretisht për Zyrën e
7 Prokurorit të Specializuar dhe po ceket këtu. E dyta, sepse
8 orientimin që ta dhashë e deri që tash nëse kjo, se në fund e
9 përkufizoj, nëse kjo ngrihet mbi bazën e bashkëpunëtorëve
10 serbë, që fatkeqësisht, 100 vjet kanë jetuar aty dhe kemi,
11 kemi pasë, kuislingëve që ju kanë bashku në luftë me ta. Po ti
12 potencoj qita emra qetu shqiptarë edhe çka qe ke qitë këtu
13 tjerë hiç, janë që kanë veshur uniformën e Serbisë dhe me
14 serbët na kanë mësy në front lufte dhe kanë kallë shtëpia e
15 shqiptarë kanë vra të kombësisë vet. Do të thotë, këta i kam
16 mendu ashtu. Dhe tradhtarë janë ata të cilët i kanë qitë në
17 pritë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare.

18 Py. Zoti Haradinaj --

19 Pë. Jo, po i sqaroj kuj i kam thënë dhe kam thënë unë
20 jam --[Nuk ka mikrofon].

21 I AKUZUARI HARADINAJ: -- dhe gjithmonë do ta përkrahi
22 këtë sepse -- [Nuk ka mikrofon].

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
24 Haradinaj, ju përgjigjët pyetjes dhe nuk ka nevojë për më
25 tepër.

1 I AKUZUARI HARADINAJ: Ta them prapë -- [Nuk ka mikrofon].

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk keni
3 nevojë për këtë.

4 I AKUZUARI HARADINAJ: Në rregull.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
6 Haradinaj, mos ndalni mikrofonin sepse nuk dëgjohen ato që
7 thoni kur e fikni mikrofonin. Lëreni ndezur, ju lutem.

8 I AKUZUARI HARADINAJ: Në fund ju referohem nëse ka në
9 këtë drejtim njëetnik, selektiv dhe jo gjithëpërfshirës. Dhe
10 fjala në fund e shpjegon nëse ka këtë kuptim dhe këtë drejtim.
11 Është kështu. E përkrahin vetëm ata që kanë qenë armiq tanë
12 dhe me armiqtë tanë kanë bashku edhe kanë luftu. Prandaj fjala
13 e fundit e sqaron saktë se nëse ka këtë drejtim që vetëm këtë
14 me i siguru, vetëm në mënyre selektive, ata e përkrahin.

15 Unë mendoj se këtë Gjykatë duhet me e përkrahë të gjithë
16 na. Dhe do ta kishte përkrahë dhe do ta përkrahë nëse ndjeken
17 të gjitha krimet pa marrë parasysh kush.

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 Py. Sipas mendimit tuaj personat që bashkëpunojnë me DHSK-në,
20 në formën që ajo është sot, janë bashkëpunëtorë të serbëve,
21 apo jo?

22 Pë. Ah jo. Këta po e thu ti. Këta po e thu ti. Gjithsecili ka
23 të drejtë ta lyp të drejtën e vetit.

24 Py. Pra, a po bashkëpunon DHSK-ja me autoritetet serbe?

25 Pë. E keni thënë ju vetë dhe e ka thënë edhe e ka thënë edhe

1 koordinatori juaj. Në bazë të këtyne, unë e kam konkludimin

2 dhe mendoj që po.

3 Py. A nuk na thatë dje që kjo është akuza më e madhe që mund
4 të bëni?

5 Pë. Për kënd akuzë?

6 Py. Bashkëpunimi --

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Zoti Halling, përmendi diçka që
9 zoti Haradinaj e ka thënë. Le të na japi faqen e transkriptit
10 se ku është.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Është në faqen 74 të
12 transkriptit të djeshëm. Duke pasur parasysh se është e
13 vështirë që të nxjerrim transkriptin në shqip në këtë moment
14 ndoshta është më kollaj që unë ta lexoj pjesën dhe të shkruhet
15 në traskript dhe pastaj --

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e
17 pranueshme.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Po të vendoset në ekran.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atë do të
20 bëjmë.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është faqja 74 e transkriptit
22 të djeshëm.

23 Py. Zoti Haradinaj, do t'jua lexoj:

24 "Dhe ne kemi këtë dyshim se këto mund të ishin dokumente
25 të ZPS-së. Ata na akuzuan ne që kishim bashkëpunuar me serbët

1 dhe i sollën dokumentet këtu duke i akuzuar njerëzit që kishin
2 marrë pjesë dhe që jeni bashkëpunëtorë të shërbimeve sekrete
3 serbe dhe kjo është akuza më e madhe që mund t'i bësh dikujt".

4 Zoti Haradinaj, a e thatë këtë dje?

5 Pë. Po e thashë. Dhe po e përsëris edhe njëherë, sepse po më
6 duket i ndërrove qasjet dhe kuptim qysh e kam thënë unë. Unë
7 kam thënë "ne", Organizata e Veteranëve ka pasë kohë mbas
8 ardhjes së dokumenteve të juve që na kanë akuzu se edhe ne po
9 bashkëpunojmë me Serbinë, se na i ka prurë Serbia këtu. Prandaj
10 dojshin me na thënë që jeni të njëjtë sikurse tjerët që po i
11 akuzon, po thotë bashkëpunëtorë me Serbinë i ka pasë quajtur.
12 Dhe kjo a kanë akuzë e rëndë për ne.

13 Sepse po të kishim bashkëpunu me Serbinë, ne nuk do t'ju
14 kishim kritikuar ju. Do të ishim pajtë plotësisht me ju. Si
15 munda unë nëse bashkëpunoj me Serbinë më të thënë ty pse po
16 bashkëpunon? Nuk e - shiqoni, se dhe termi "Serbi" nuk e ka
17 kuptimin e përgjithshëm pse ai është i këtij nacionaliteti. A
18 krejt në rregull me bashkëpunu me një serb. Por nuk është
19 aspak në rregull me bashkëpunu me një serb që ka krye dhe ka
20 vra dhe ka urdhëruar vetë personalisht krimin. Këtu a kuptimi,
21 po na e përmendim vetëm serb. Sepse një serb -- ka serbë shumë
22 ndershmëri. Ka serbë që janë edhe vetë kundër lufte. Kështu që
23 unë nuk flasë nuk e fyej një popull, se e fyej veten. Çdo kund
24 ka njerëz të këqij.

25 Prandaj unë e thashë ka qenë ofendim për ne. Njëkohësisht

1 tuj u kritiku ju pse po bashkëpunoni me kriminelët, me na
2 thanë ata se na jemi që keka bashkëpunu sepse na kanë akuzu që
3 mos i ke marrë te sigurimi sekret serb. Sepse e kanë ditë
4 opinionin që veç ata kanë qasje në këto dhe veç ju keni
5 konfidencialitet me ta. Në këtë prizëm e kam thënë edhe po e
6 përsëris prapë.

7 Py. A do të kishit frikë se mos akuzoheshit si bashkëpunëtor
8 serb?

9 Pë. Nuk kam unë frikë hiç që muj akuzojna. Mirëpo mundohen me
10 bë lajme se për me u akuzu unë si bashkëpunëtor serb unë isha i
11 privilegjuni. Isha në pushtete. S'isha burgos kurrë. Kështu që
12 janë shembujt që nuk mundem ne edhe një armik i popullit tim
13 me kanë shokë. Unë dhe një armik i popullit tim, po e themi
14 popullit tim, po konkretisht edhe i familjes time qemë ka vra,
15 më ka pre, më ka torturu, maltratu, ma ka ndalu të drejtën e
16 jetës me ken na shokë. Në asnjë mënyrë.

17 Shokët ndihmohen, shokët privilegjohen. Shokët nuk
18 dënohen, nuk torturohen. Ose të paktën kur pranon me u bë shok
19 me armikun t'i ndal torturat, t'i ndal maltratimet, të
20 privilegjon. Kështu.

21 Py. Çfarë mund të ndodhë në Kosovë nëse dikush akuzohet se
22 është bashkëpunëtor serb?

23 Pë. Kush i akuzon? Duhet me kanë një drejtësi.

24 Py. Nuk është kjo pyetje. Pyetja është çfarë mund të ndodhë
25 në Kosovë kur dikush akuzohet si bashkëpunëtor i serbëve?

1 Pë. Njerëzit janë tuj jetu, s'u ka ndodhë asnjësend.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
3 vazhdoni.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë do të kundërshtoja sepse kërkon
5 spekulim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E rrëzoj
7 kundërshtimin. Do ta lejoj pyetjen.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 Py. Nëse një dëshmitar do të akuzohej si bashkëpunëtor serb
10 do të vritej apo jo?

11 Pë. Jo more. Vetëm nëse ka qenë në front a kanë luftë, ka
12 mujt edhe me u vra. Në kohë lufte flas, në front. Në front
13 është uniforma. Ai gjuan ti e gjuan. Aty se dinë as
14 nacionalitetin, as moshën, as gjininë, as kurrëgjë. Është
15 front. Po jo tash. Tash janë organet gjyqësore dhe ishalla e
16 kemi kalu kohën e luftës dhe atë kohë. Ishalla kurrë s'vjen
17 ajo kohë. Që njerëzit me i marrë zgjedhjet private me i marrë
18 -- me bë zgjedhje private. Nuk besoj që jemi ne në atë
19 standard tash. Kosova s'është në atë standard më.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Nëse mund t'i lutem Sekretares që
21 të nxjerrë një postim nga FaceBooku. Është me numër SPOE002264
22 deri në SPOE002267. Ka dhe numër me shtojcën -ET. E ka
23 klasifikimin konfidenciale, më intereson faqja 1.

24 Py. Zoti Haradinaj, ky është një postim nga faqja e
25 Facebookut të Hysni Gucatit e datës 26 prill 2020. Ka një

1 aspekt të veçantë për të cilën dua t'jua tregoj. Do të ishte
2 më e lehtë po ta lexoja për hir të procesverbalit, mbase
3 përkthyesit me gojë mund të -- përkthimi i tyre mund të
4 ndihmojë ta gjeni pjesën. Thuhet:

5 "Shkëlzen Gashi, së bashku me disa intelektualë që
6 mbështeten nga Serbia dhe mbështetësit ndërkombëtar, kanë
7 ngritur një sërë gjykime kundër UÇK-së, duke sajuar lloj-lloj
8 historish kundër tyre duke dhënë edhe 27 -- krahas kësaj, disa
9 prej këtyre dëshmitarëve janë vrarë sepse kanë zbuluar me
10 dashje ose pa dashje se kanë punuar me këto struktura për ta
11 shkatërruar UÇK-në, pa prova dhe dëshmi, me të vetmin qëllim
12 që të arrijnë synimin e tyre".

13 Zoti Haradinaj, a pajtoheni me këto çka është thënë këtu
14 në postim?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Së pari, këtu i kërkohet të
17 komentojë për postimin e dikujt tjetër dhe nuk mund ta dimë a
18 është postuar nga ai person apo jo. Dhe i kërkohet që të
19 spekulojë lidhur me këtë dhe e kundërshtojmë këtë lloj pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
21 kundërshtimi.

22 Mund të vazhdoni.

23 Z. HALLING: [Përkthim] E përsëris pyetjen.

24 Py. Zoti Haradinaj, a pajtoheni me çka thuhet në postimin që
25 sapo jua lexova.

1 Pë. Së pari, këtu nuk është unë po të isha pajtuar ose diçka
2 tjetër do ta kisha shkruar vetë, por duhet cekur se ky
3 Shkëlzen Gashi ka qenë një këshilltar i kryeministrit Albin
4 Kurti dhe ky ka deklaruar dhe i ka arsyetuar vrasjet e 11.000
5 shqiptarëve në Tivar dhe arsyeton vrasjen e serbëve prapë ndaj
6 shqiptarëve si hakmarrje të asaj kohe. Kështu që ka qenë
7 person që e ka trubullu opinionin komplet në Kosovë dhe ky
8 ndoshta pastaj a mundu me një shpjegim të vetin ose nëse është
9 i veti po flas. Unë s'e di a është i veti, por faqja duket.
10 Unë nuk e di. Pastaj ka dhënë një opinion të vetin. Që unë për
11 opinionet e tij këtu nuk jam as për vlerësim juridik, as për
12 vlerësim tjetër sepse nuk muj të shprehna saktë për opinionet
13 e tij.

14 Unë pajtojna që Shkëlzen Gashi ka gënjyer dhe a mundu me
15 nxit urrejtje. Shkëlzen Gashi. Këtu s'është aspak fajtor as
16 autori, as kush do ta kish citu këtë. Ky i ka thënë këto
17 deklarata në një emision televiziv shumë serioz. Dhe për këtë
18 arsye, harrova me cek, ky është liru nga puna. A kriju, a
19 kërku me e hek prej pune dhe e ka hek prej pune. E ka liru
20 në fakt. U kërku me përjashtu, por e ka liru.

21 Py. Deklarata që Gashi me një kastë intelektualësh të
22 mbështetur nga Serbia dhe mbështetësit e tyre ndërkombëtarë
23 kanë ngritur shumë gjyqe kundër UÇK-së, me këtë deklaratë këtu
24 pajtoheni apo jo?

25 Pë. Zoti Prokuror, fatkeqësisht dhe këtu duhet të ndihna unë

1 keq. Janë shumë intelektualë që kanë qenë me Serbinë dhe na
2 kanë dënu ne. Unë, mu asnjë gjykatës serbë se kam pasë që më
3 ka dënu. Të gjithë shqiptarë kanë qenë.

4 Py. Komenti që gjykimet kundër UÇK-së dhe se më shumë se 70
5 për qind të dëshmitarëve janë blerë dhe paguar, a është kjo
6 diçka të cilën ju vetë e besoni?

7 Pë. Zoti Prokuror, unë nuk mund të spekuloj me mendimet e të
8 tjerëve, të lutem. Mos hezito diçka që çka s'muj të spekuloj
9 se qoftë edhe që mendoj ashtu, mendimi jem nuk a i vlefshëm se
10 mendim tjetër prej atij që ose protagonistit që e ka shkru ose
11 atij që e ka shpërnda. S'ka këtu të pëlqej e s'të pëlqej. Ka
12 pjesë që më pëlqejnë, ka pjesë që s'më pëlqejnë. Pa e shkru
13 vetë ka pjesë që s'i kisha shkru. Ka pjesë që i kisha shkru
14 edhe ma fortë. Kështu që s'po du me spekulu me mendimet e të
15 tjetrit. Qoftë nëse është i Hysnisë po dhe mos koftë, s'du me
16 spekulu se s'e kam atë të drejtë unë. S'jam as opinionist i
17 kësaj. Nuk po i iki përgjigjes, singërisht, po thjeshtë gabo. J.
18 Mund të gabo, çka të them. Mund të gabo në raportin e
19 mendimit, jo për diçka për vete që po tutna këtu.

20 Py. Zoti Haradinaj, nuk mori përgjigje pyetja që bëra. Në
21 lidhje me këtë pjesë, a pajtoheni me atë pjesë të postimit apo
22 jo?

23 Pë. Si decidivisht, bukfalisht nuk pajtojna. Si emra kur e
24 lexoj çiftin e Shkëlzen Gashit dhe shokëve të tyre, më bëjnë
25 me vjellë edhe tash. Më vjen vjellë.

1 Py. Po, kjo nuk është kjo pjesa e komentit për të cilin po e
2 bëj pyetjen. Po që "70 për qind e dëshmitarëve që kanë dhënë
3 dëshmi në gjyqet kundër UÇK-së kanë sajuar lloj-lloj historish
4 janë blerë e janë paguar" me këtë pjesë, a pajtoheni?

5 Pë. Tani po insiston që unë me hi me analizu këto dhe po
6 analizoj, për hir të drejtësisë, që ju të mos më akuzoni që po
7 u mundohna me ik asaj. Nëse dhe i marrim të gjitha proceset,
8 pra dhe këtë po ta them tash me bindje, kështu taman, nëse i
9 marrim të gjitha proceset në Kosovë që i kanë ngritë prej
10 UNMIK-ut, EULEX-it dhe Tribunali, jo 70, po 80 për qind kanë
11 dalë njerëz të pastër. E vetmja gjë që ka ndodhë, ka ndodhë
12 një fatkeqësi, njerëzve jua keni hyp ka 7 vjet jetë. Merri
13 rezonoi nëse s'del qështu, unë s'po du me i lënë as 70, po
14 them që edhe 90 për qind njerëzit kanë dalë të pafajshëm. Dhe
15 janë liru. Edhe në Tribunal, edhe në Gjykata të UNMIK-ut edhe
16 në Gjykatat e EULEX-it. Nëse kështu, që kësaj ju ka referu ka
17 gabu që ka shkru 60 e 70. 90 është. S'kam tjetër përgjigje për
18 ta. Për hir të drejtësisë, për hir të transparencës se mu duk
19 që duhet me u bë transparent e analizova këtë dhe qëndroj tash
20 mbas këtyre fjalëve të mia që unë i thashë. Ju, ju mbetet t'i
21 verifikoni.

22 Py. Pra, e kam kuptuar qartë që qëndrimi juaj është i pasaktë
23 se numri i dëshmitarëve të korrumpuar është më i lartë sesa
24 përqindja që është përmendur në këtë postim?

25 Pë. Nuk thashë unë as "të korrumpuar" as "të pakorrumpun", po

1 të gjithë ata dëshmitarë, do të thotë, nuk doli që e dëshmun
2 dhe nuk janë bindës për të gjitha gjykatat që janë mbajt dhe
3 gjykimet që janë mbajt deri sot ndaj pjesëtarëve të UÇK-së.
4 Dhe pjesëtarët e UÇK-së mbi 90 për qind të rasteve kanë dalë
5 të pafajshëm. Prandaj me zotin Gucati këtu s'pajtojna asnjë
6 grimë me 60 e 70, po me 90. Dhe mund të jetë edhe mbi 90. Si
7 raste jam ka flasë, nuk jam ka flasë për njerëz. Dhe për mua
8 ata dëshmitarë të cilët kanë ndihmu me i ngritë aktakuzat dhe
9 s'kanë mujt me e bind Trupin Gjykses dhe shyqyr se është një
10 Trupi Gjykses dhe nuk varet krejt prej Prokurorie. Gjykatat
11 kanë pru vendim 90 për qind në dobi të të akuzuarve dhe janë
12 dalë të pafajshëm.

13 Unë e kreva këtë përgjigje. Më s'kam ça me komentu. Dhe
14 këtë e bëna edhe njëherë po them, vetëm për hir të
15 transparencës edhe të juve këtu, edhe të Gjykatës, po edhe të
16 publikut. Po edhe po tregoj pakënaqësinë teme, nëse në këtë
17 mënyrë tash ai e ka mendu, mos më shtini me fol, e ka mendu ai
18 si unë kështu që po fol që tash dhe ia tërheki vërejtjen zotit
19 Hysni Gucati se nuk është 60 po dhe 90 mundet me qenë.
20 Py. Dhe pajtoheni me ato pjesë të postimit ku thotë që "disa
21 prej këtyre dëshmitarëve janë vrarë"? Po e lexoj të gjithë
22 fjalinë:

23 "Gjithashtu disa prej këtyre dëshmitarëve janë vrarë
24 sepse kanë zbuluar me dashje apo pa dashje se kanë punuar për
25 këto struktura në mënyrë që të shkatërrohet UÇK-ja, pa prova

1 apo me dëshmitarë të fabrikuar, si i vetmi qëllim për të
2 arritur qëllimin". Pra, juve pajtoheni që disa prej këtyre
3 dëshmitarëve janë vrarë?

4 Pë. Zoti Prokuror, specifikohu se kush po mendon që ka thënë
5 kështu? Për Hysninë po mendon që ka thënë Hysniu apo dikush
6 tjetër? Për mu jeni shumë të paqartë, po edhe për Trupin
7 Gjykues jeni të paqartë. Kush i ka thënë këto fjalë?

8 Py. Siç e shpjegova që në fillim është një postim nga faqja e
9 Facebookut e zotit Hysni Gucati e datës - më falni - e muajit
10 prill 2020. Fjalja që unë jua lexova, pajtoheni me atë fjali?

11 Pë. Atëherë për sqarimin e juaj, po edhe të këtij Trupi
12 Gjykues, këto fjalë i ka thënë dhe i ka citu Shkëlzen Gashi.
13 Ky veç ika tregu çka ka tregu ai. Nuk janë fjalë, as mendimi i
14 tij, as i imi e as i njeri që e don Kosovën. Kjo është fjalë e
15 tij dhe për këtë arsye e ka shkarku kryeministri. Të lutem,
16 këtu ky i ka citu ata këtu. Unë kështu po e kuptoj dhe kështu
17 po shihet. Edhe kështu ka qenë. Ai i ka thënë këto fjalë.

18 Dhe unë sa di diku, sapo lexoj po, e di që u diskutu
19 shumë. Kam pasë debate dhe unë për këtë çështje dhe kam thënë
20 nëse zoti Gashi i din këto gjëra, që ti i citove tash, le të
21 urdhnon, le të shkon në Gjykatë le ti thotë. Të mos krijon
22 konfuzion në popull e në shoqëri e gjithkund, që me na u kthy
23 ne bumerang këtu, sikur po mundohesh ti tash me na kthy si
24 bumerang në të. Dhe unë, edhe këtu po e propozoj, a mirë me e
25 marrë zoti Shkëlzen Gashi. Pikërisht me e marrë me e pyet për

1 këto sende nëse i din. Dhe a mirë nëse i din dhe ka pasë
2 guximin me i thënë. Pajtohem plotësisht me ta. Po a mirë edhe
3 me e dënu nëse ka shpif.

4 Py. Zoti Haradinaj, fjalia që unë lexova nuk tregon që është
5 -- që janë fjalë të zotit Gashi. Duket sikur është pjesë e
6 postimit apo jo?

7 Pë. Tani ato se çka ti don me mendu e çka ti don është
8 çështje e jotja. Dhe ato çka ti më the me dhënë mendimin tim.
9 Nëse ti don me e qit mendimin tënd qite, po besomë edhe ti e
10 ke gabim se nuk është ashtu. Është kështu qysh po them unë. A
11 e saktë sepse mund ta gjeni deklaratën e Shkëlzen Gashit. Nëse
12 keni pasë nge me hi nëpër Facebook-e, unë jam i sigurt që ju e
13 keni edhe atë deklaratë. Po nuk doni me e qit. S'ju konvenon
14 edhe që ka kaq. Është e saktë.

15 Që unë këtu po ju them, nëse nuk janë këto fjalët e
16 Shkëlzen Gashit, unë haptazi po pranoj që jam në faj dhe jam
17 ka spekuloj këtu dhe e pranoj dënimin, sepse jam nën një
18 betim. E marr përgjegjësinë prej këtu. Hy e zbulo. Dhe po ta
19 citoj çka ka thënë se është interesant. Ka thënë këto i ka vra
20 vetëm UÇK-ja, se me siguri nuk i ka vrarë shoqata kulturo-
21 artistike kemi [e pakuptueshme] që u merren me vegla, me
22 muzikë e Hajdar Dushit, është shoqëria e Hajdar Dushit kjo. Po
23 ta citoj që ka thënë edhe ma shumë, që zoti Gucati e paska i
24 paska ndihmu që s'ia ka qitë edhe këto.

25 Zoti Prokuror, këto s'janë as mendimi i tij, as mendim i

1 jemi. As pajtohem me ato çka ka thënë ai. Po e kemi inkuraju.
2 Ka shkrim që kam shkru edhe unë për këtë diku. Edhe nëse e ke
3 zbulu [në] Facebook, do ta gjesh. E kam inkuraju që me këtë
4 dije që ka, pa marrë parasysh a i duket dikuj mirë a keq, le
5 të shkon në Prokurori dhe t'i denoncon se është mirë.

6 Por, kam thënë që edhe duhet me marrë përgjegjësi për
7 shpifje. Edhe jam edhe sot dakord. Edhe sot ju bëj thirrje
8 kush çka din le të shkon. Pse mësheft? Dëshmitar është
9 ashiqare, pse mësheft. S'ka nevojë me u turpru askush për një
10 gjë të vërtetë.

11 Py. Zoti Haradinaj, dëshmitarët të cilët dëshmojnë kundër
12 UÇK-së, a janë bashkëpunëtor serbë?

13 Pë. Për hir, po të them thjesht, zoti Prokuror, nuk e kam --
14 nuk jam ai që du me ju ndihmu ju, si Prokuror dhe si Zyrë të
15 Prokurorit veç, po të them ju këtu që dy herë me rastin e
16 Millosheviçit dhe qetash që bën 100 pyetje, je ka don me e bë
17 qëllim si precedan të katër. Dhe nëse që kjo nënkuptohet në
18 Kosovë qysh unë mendoj që mundet me u nënkuptu kjo pyetje e
19 jotja, ju po doni me bë precedan të paqenë. Pse? Pse po mendon
20 ashtu? Kush ka mëndu ashtu?

21 Py. Zoti Haradinaj, ju lutem dëgjoni pyetjen --

22 Pë. Ju nuk keni thënë -- po dilni në kundërshtim me ju. Ju
23 nuk keni thënë që jeni ka i njekni pra UÇK-në. Tash po thu që
24 t'i keni ka njekni UÇK-në. Cila është? Jeni tuj e ndjek krimin
25 dhe njerëz që kanë qenë -- kanë mujt me qenë dhe të mundshëm

1 edhe në UÇK apo jeni tuj e ndjek vetëm UÇK-në? Nëse e ndjekni
2 vetëm UÇK-në nuk keni nevojë me thirrë individë hiç. Kën ta
3 merrni sikur -- [nuk ka mikrofon] -- dhe nuk e di që do të
4 jemi kundër institucionit dhe nëse e njëjta -- [e
5 padëgjueshme].

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
7 Haradinaj, mikrofonin. Zoti Haradinaj.

8 I AKUZUARI HARADINAJ: Ndalma, zoti Gjykatës, sa dush. Unë
9 kur u shpreha thashë atë çka ata po më provokon.

10 Zoti Prokuror, po kallëzoj, unë nuk mund mu -- unë më bën
11 nervoz me këto provokime. Po është çka ndikon sepse gjykimi a
12 publik dhe pastaj mos i bjen pi shkurt. Nëse UÇK-ja është cak,
13 UÇK-ja është cak i kësaj Prokurorie, s'pajtohna asnjë -- në
14 rregull mor vëlla, pse jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti
16 Haradinaj, nuk keni mikrofon.

17 I AKUZUARI HARADINAJ: Unë ja e kam këtu.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, po jua
19 fik unë. Jua fik unë sepse nuk po i drejtoheni pyetjes. Ju
20 lutem, dëgjoni pyetjen. Përgjigjuni pyetjes me fjali të
21 shkurtër.

22 Zoti Halling, vazhdoni.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
24 Py. Zoti Haradinaj, kjo pyetje mund t'i përgjigjeni me "po"
25 ose me "jo". Dëshmitarët që dëshmojnë kundër UÇK-së, a janë

1 bashkëpunëtorë serbë?

2 Pë. Nuk je ka ma bën pyetjen me bë "po" ose "jo". Ja kam thu
3 "kundra UÇK-së" dhe unë nuk e quaj krejt UÇK-në kriminale.

4 Nëse më thu kundër individëve, është diçka tjetër. Prandaj po
5 reagoj. Është shumë interesant se çka po flitni këtu dhe çka
6 po transmetohet dhe si po lenë -- çka po lenë me u nënkuptu.

7 Nuk e kam me ju ndihmu ju. Po kjo krijon precedant ma
8 vonë. Që na pikërisht për këta ju kemi kritiku ju. Që ju e
9 keni në sulm UÇK-në s'lun rol hiç kush është. Nëse ju jeni ka
10 i lypni kriminelët që kanë mujt me qenë edhe UÇK dakord jam.
11 Nëse doni me e dënu UÇK-në je kundërshtar, jam kundërshtar i
12 yt është krejt jetën. Si UÇK. Dhe s'duhet me më pyet jo mu, po
13 kënd ta pyetesh një popull që e don lirinë, kështu mendojnë.
14 Por kjo s'do të thotë me e mbrojt krimin nëse ka qenë edhe
15 pjesëtar i UÇK-së. Pse mos me u marrë?

16 Prandaj, zoti Gjykatës, kjo pyetje është ma e gjanë se me
17 "po" edhe me "jo".

18 Nëse më shtrohet pyetja po e konfirmoj unë ose kolegu im,
19 a jeni kundra një dëshmitari, i cili është kundra një
20 pjesëtar i këtu që ka qenë edhe UÇK, unë nuk jam kundra. Por
21 një dëshmitari që është kundra UÇK-së, po jam kundra. Nëse
22 është ka dënohet UÇK-ja si emër, si grup krejt, komplet, unë
23 jam kundër. Nëse ka dënohet individët ose nëse merren pyetje
24 ose nëse, si me thënë, nëse shoshiten, nëse trajtohen
25 individët që mund të jenë edhe pjesëtar të UÇK-së, unë ata

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 113

1 dëshmitarë nuk i quaj tradhtarë as kurrgjë. Janë dëshmitarë.
2 Krejt në rregull është. Unë dua ta pastroj emrin si emër UÇK
3 komplet. Është sikur me thënë apo dënojmë krejt Kosovën apo
4 dënojmë krejt Serbinë. Në kësi lloj pyetje nuk ka po, jo.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
6 Vazhdoni, zoti Halling.

7 Z. HALLING: [Përkthim]

8 Py. Pra, zoti Haradinaj, nëse ju kuptova, anëtarë, individë
9 të UÇK-së edhe mund të kenë kryer krime gjatë luftës në
10 Kosovë; kështu?

11 Pë. Nëse janë krimet e pretenduara, por edhe që pastaj
12 zbulohen dhe janë të pretenduara, pse të mos trajtohen. Ne nuk
13 kemi kurrgjë kundra kësaj. Pse jo? Krimi nuk ka as emër, as
14 nacionalitet, as ngjyrë, as personalitet e as pozitë
15 qeveritare. Për mu krimi a krim. Ky është qëndrimi ndaj krimit
16 dhe duhet të zbulohet dhe duhet të dënohet.

17 Py. Pra, të paktën ekziston mundësia, nëse flasim në
18 abstrakt, që UÇK-ja të ketë kryer krime?

19 Pë. Unë nuk merrna me gjëra abstrakte. Me ato jeni ka merr ju
20 deri më tash. Kështu që po ju lë ju atë të drejtë. E keni
21 marrë vetë. E keni uzurpu. Vazhdoni. Unë nuk flas për gjëra
22 abstrakte.

23 Py. Një përgjigje që do "po" ose "jo".

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një sekondë.

25 Zoti Cadman ka një koment.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Po kështu si edhe Mbrojtjes i është
2 kërkuar më përpara që të qëndrojmë larg asaj çka ka ndodhur në
3 konflikt edhe unë nuk e kuptoj çfarë lidhje kanë këto pyetje
4 me këtë proces.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
6 kundërshtimi.

7 Vazhdoni me pyetjet.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 Py. Zoti Haradinaj, me "po" ose me "jo", a është të paktën e
10 mundur, që në nivel abstrakt, që UÇK-ja të ketë kryer krime?

11 Pë. Unë [nuk] jam prestigjator, nuk qes fall me fol për gjëra
12 abstrakte. Dhe nuk po di çfarë, cilën pyetje e don ti? Nuk
13 mund të shprehem për këto. Jo që s'po du, po është diçka
14 abstrakte. Dhe për gjëra abstrakte të shprehesh është me hup
15 kohën kot dhe me hup mendimin tënd kot edhe me e ul veten. Po
16 them thjesht: Jam për zbulimin e krimeve kushdo qoftë ata edhe
17 UÇK, pjesëtarët e UÇK-së, edhe jashtë UÇK-së. Kushdo qoftë ai.
18 Kjo është konkrete. Por përgjigja abstrakte thashë ju jeni ka
19 merreni me këto. Këto përgjigje pyetje jepni ju. Unë nuk
20 përgjigjem për pyetje abstrakte.

21 Py. Ta them ndryshe pyetjen, nga ana tjetër. Nëse dikush do
22 thoshte që UÇK-ja nuk mund të ketë kryer krime, ju nuk do të
23 pajtoheshit me këtë apo jo?

24 Pë. Normal.

25 Z. BUCKLEY: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Por për çfarë e ka

1 fjalën Prokurori për UÇK-në për të gjithë subjektin global apo
2 për anëtarët individualë?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuror,
4 besoj e keni fjalën për anëtarët individualë?

5 Z. BUCKLEY: [Përkthim] Sepse kjo e ka marrë e përgjigjen
6 përmes përgjigjeve të shumta të zoti Haradinaj, ku është thënë
7 që anëtarët individualë mbajnë përgjegjësi individuale.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë e
9 përjashtova këtë. Nuk ka më rëndësi, nuk ka më nevojë që të
10 flisni për një kundërshtim që nuk kemi nevojë. Unë e mora
11 parasysh kundërshtimin tuaj.

12 Zoti Halling, korrigjoni gjuhën.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Po mirë, mbase do të ishte më e
14 lehtë po të shohim videon tjetër. Ju lutem Sekretares së
15 Gjykatës, të nxjerrë materialin P39. Me numër 08398503. Është
16 publike, me vulë kohore 10:33 deri në 11:05. Është në faqen 4
17 të transkripti në anglisht. Ndërsa ekstrakti fillon me fjalën
18 "pra, nuk ishte e lehtë të bindej faktori ndërkombëtarë" dhe
19 mbaron me fjalën "filluar për luftën në Ballkan".

20 [Luhet videoincizimi]

21 Z. HALLING: [Përkthim]
22 Py. Zoti Haradinaj, në këtë video nga 30 qershori 2020, për
23 çfarë e kishit fjalën kur thatë "edhe po të kishim dashtë nuk
24 mund të kryenim krime"? "Edhe po të kishim dashur nuk patëm
25 mundësi të bënim krime".

1 Pë. Kjo është ajo ku kam folë në atë -- ne dihet forca jonë
2 sa ka qenë e UÇK-së. Dihet kush ka pasë potencial me kry
3 krime. Dhe dihet kush a kanë i dëshmun, para luftës në Kosovë,
4 në vende të tjera, në katër shtete tjera, kush ka kry krime.
5 Dhe dihet ku ju ka dhënë vlerësimi dhe u vlerësu nga Evropa se
6 kush ka bë gjenocid. Të mos flasim për masakra që janë bë dhe
7 në sy të ushtarëve të Holandës që i ka dëshmitarë vetë
8 holandezët. Prandaj këtë e kam thënë. Ne në pikëpamje
9 figurative me sqaru.

10 Por këtu nëse këqyr ma poshtë, unë nuk mund të hij dhe
11 shumë mirë që po bëhet kjo dhe do të jetë e qartë. Kush ka bë
12 le të del. Unë, kundërshtimi jem është zotni edhe njëherë --
13 edhe po e them edhe njëherë, kundërshtimi jonë është vetëm pse
14 nuk bën kjo Gjykatë, nëse s'munden ata në Serbi, se as s'ju
15 ngon ajo juve, qytetarë të nacionaliteve tjera t'i merr dhe
16 t'i njeh, t'i trajton sikur këta të dyshon njëjtë. Në rregull
17 është. Ju po doni me na nxjerrë dhe këtë problem e kam pasë me
18 sqaru.

19 Unë [nuk] jam kundra drejtësisë. Nuk jam kundra zbulimit
20 të krimeve. Jam vetëm mos me kanë i njëanshëm, pra, dhe
21 parcial e selektiv. Kjo është. Është element shumë i thjeshtë,
22 po ju me qëllim s'po doni me i kuptu.

23 Py. Ju sapo thatë: "Dihet mirë se kush kishte potencial me
24 kry krime". A kishte UÇK-ja potencial me kry krime?

25 Pë. Po ma së pari logjikisht, në popullsi të vet, ushtria e

1 saj çlirimtare nuk e ban. E dyta, ne civilëve s'ke mujt me ju
2 afru civilëve serb nëse i këqyrim. Ne s'kemi mujt me u afru
3 kurrë. Te një popullatë civile nëse a kanë e atakune, ajo
4 popullatë civile a kanë e atakune prej forcave serbe. Kanë
5 pasë fuqinë, logjistikën, organizimin. Besa përvojë edhe
6 paraprake, se nuk është ato vrasjet e para që i ka bërë në
7 Kosovë. 100 vjet na kanë vra rresht. Dhe kështu që edhe
8 përvojën e kanë pasë. Nuk ka brez i ushtrisë jugosllave që nuk
9 e ka bë, në periudhën e vet, vrasje në Kosovë dhe mbi
10 shqiptarët. Në këtë formë kam kallëzu për potencialin. Sepse
11 po të mos ishte potenciali i madh nuk ish dashtë me intervenu
12 bota ndërkombëtare dhe me ia u hek potencialet.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling,
14 ju lutem mos e përdorni të gjithë shprehjen e përgjithshme
15 UÇK. Siç tha zoti Buckiey, duhet të bëni një lloj hyrje.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Do ta përshtat gjuhën.
17 Py. Zoti Haradinaj, a keni dijeni që për ndonjë rast të
18 ndonjë anëtari të UÇK-së që është dënuar me drejtësi për krime
19 lufte?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Nuk ka
21 përkthim].

22 Z. CADMAN: [Përkthim] [Nuk ka përkthim].

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Nuk ka
24 përkthim].

25 Z. HALLING: [Përkthim] [Nuk ka përkthim].

1 I AKUZUARI HARADINAJ: Zoti Gjykatës, nuk e dëgjova
2 përkthimin e fjalimit të avokatit dhe nuk po e dëgjoj
3 përkthimin e Prokurorit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Nuk ka
5 përkthim].

6 Z. HALLING: [Përkthim]
7 Py. Zoti Haradinaj, a keni dijeni për ndonjë rast kur ndonjë
8 anëtar i UÇK-së është dënuar në mënyrë të drejtë dhe të duhur
9 për krime lufte? A ka ndodhur kjo?

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Zoti Haradinaj, tha që nuk dëgjoi
11 ndërhyrjen time dhe nuk dëgjoi edhe pyetjen nga Prokurori.
12 Pra, ta them edhe njëherë, ju lutem?

13 Pra, për zotin Haradinaj, kundërshtimi im ishte për të
14 gjithë këtë linjë pyetjesh sepse Mbrojtjes ju tha që të mos
15 diskutoheshin çështje që kishin të bënin me luftën dhe
16 Prokurorisë duhet t'i jepet i njëjti urdhër të mos bëjë të
17 tilla lloje pyetjesh për të qenë të barabartë dhe për të qenë
18 procedurë e drejtë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë e
20 kundërshtoj. Unë e hedh poshtë këtë kundërshtim.

21 Dhe zoti Halling, mund ta bëni pyetjen.

22 Z. HALLING: [Përkthim]
23 Py. A keni dijeni zoti Haradinaj, për ndonjë rast kur ndonjë
24 anëtar i UÇK-së është dënuar në mënyrë të drejtë për krime
25 lufte? A ka ndodhur ndonjëherë kjo sipas mendimit tuaj?

1 Pë. Unë e thashë edhe pak më përpara, se 90 për qind të
2 rasteve do të thotë janë dalë të pafajshëm. Kështu që tash po
3 spekuloj me 10 ose me 90, po pjesa tjetër po nënkuptohet që
4 ata që janë dënu, janë dënu. Dhe ka qenë e acceptueshme. Nuk
5 thashë 100 për qind janë dalë. Mund të dalë. Janë dënu. Janë
6 ka vujt dënimin.

7 Py. Pra, në qoftë se do të thoja që në të gjitha rastet
8 anëtarët e UÇK-ja kanë vrarë vetëm ushtarë në uniformë, ju nuk
9 do të pajtoheshit me këtë?

10 Z. BUCKLEY: [Përkthim] Kundërshtoj. Kjo kërkon spekulim.
11 Zoti Haradinaj nuk mund të pritët prej tij që të komentoj në
12 lidhje me këtë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thoni
14 kundërshtoj. Jepni se çfarë kundërshtoni. Mos na mbani
15 fjalime.

16 Z. BUCKLEY: [Përkthim] Nuk është fjalim, është thjesht
17 dhënia e arsyes pse kundërshtoj.

18 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mundem?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
20 hidhet poshtë.

21 Mund ta bëni pyetjen.

22 Z. HALLING: [Përkthim]

23 Py. Zoti Haradinaj, në qoftë se them që në të gjitha rastet
24 ushtarët e UÇK-së kanë vrarë vetëm ushtarë në uniformë, ju nuk
25 do të ishit dakord me këtë?

1 Pë. Unë nuk i kam observu ata. Nuk i kam kontrollu ata. Unë
2 di për pjesën ku jam kanë unë. Unë asnjëherë s'kam pasë punë
3 me civilë. Ku jam ndeshë me ushtarë serbë sa kam mujt i kam
4 kokërru, sa herë kam mujt. Edhe e dinë saktë ata. Sa herë kam
5 mujt ushtrinë e Slllobodan Millosheviçit në Koshare, ku e kam
6 zënë, ku kam mujt e kam gjujt. Se ka pasë dy rrugë: A me më
7 vra a me i vra. Fati as unë s'kam mujt s'kam vra sa kam
8 dashtë, po as ata ushtarët s'kanë mujt shyqyr me më vra edhe
9 pse më kanë plagos. Lufta është luftë. Jam ka flasë për
10 frontin. Unë nuk i di të tjerat.

11 As po i pohoj, as po i mohoj. As nuk e kam atë aftësi, në
12 fakt, me dhënë një mendim të tillë. Thashë për proceset
13 gjyqësore janë mbajt 90 për qind, ndoshta është spekulim, po
14 qe 60-70, 90 për qind kanë dalë të pafajshëm. 10 përqindëshi
15 janë fajësu. Kanë marrë dënimin. Në rregull. I ka caktu
16 gjithkush. Kërrkush s'i ka kundërshtu. Kështu që s'jam ka hi
17 këtu me pastru ose mos me pastru dikën.

18 Unë po kërkoj me u shqyrto hala nëse ka. Pse jo? Krimet e
19 pretenduara pse mos me u zbardh nëse janë. Kështu që unë jam
20 pro zbardhjes së krimeve të pretenduara nga kushdo qofshin
21 ata.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
23 zoti Haradinaj. Ju përgjigjët pyetjes.

24 Z. HALLING: [Përkthim]

25 Py. Tani që thatë që a s'mund ta konfirmoni as mund ta mohoni

1 këtë. Pyetja tjetër ka të bëjë me këtë.

2 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të nxirret P49. Është me
3 numër 08918512. Pjesa këtu është në minutën 36, 12 sekonda
4 deri në 37:02. Në faqen 16, në transkriptin në anglisht. Dhe
5 kjo fillon me "UÇK-ja nuk e bëri këtë" dhe mbaron me fjalët
6 "kam vra ushtarë të uniformum me uniformë".

7 I AKUZUARI HARADINAJ: Nuk e kam ende transkriptin në
8 shqip.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Ndoshta se kam dhënë numrin e ERN.
10 08918512.

11 Py. Kjo është edhe në dosjen tuaj që keni përpara, zoti
12 Haradinaj, po në qoftë se nuk e gjeni aty i njëjti informacion
13 është dhe në mes të ekranit.

14 Pë. Ku është? Të lutem, e lexon edhe njëherë.

15 Py. 08918512.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 Py. Zoti Haradinaj, në fund aty thoni "Në të gjitha rastet,
19 krejt që kemi pasë rastin kemi vra ushtarë të uniformum".

20 Ju tani do ta konfirmoni apo do ta mohoni këtë që është
21 thënë?

22 Pë. Këtu kam fol për atë çka di unë personalisht. Dhe çka di
23 unë personalisht, po ta them edhe ty, kam gjuajt edhe e di që
24 kam vra ushtarë në front të Koshares në uniformë. Po ta pranoj
25 ty. Po e pranoj tërë. Kam gjuajt, bile, nuk mujt me vra sa kam

1 gjujtë e sa kam pasë qejf. Kjo është diçka krejt tjetër. Ose
2 se është disa krim e pranoj edhe këtë krim. Unë kam gjuajt në
3 ushtarë të cilët kanë gjuajt mua. Kam gjuajt na u kanë afru
4 100 metra, 200 metra. Na kanë vra, i kemi vra. Dhe jam tuj fol
5 këtu për përvojën time personale. Po, kam vra ushtarë serbë
6 edhe oficerë, që ata thojnë që është oficer, se unë s'e kam
7 ditë çka a kanë. Po. S'ka këtu të bëj me civila asnjë send.
8 Unë nuk jam kthy prej Suedie edhe me dhënë lula. Derisa jam
9 kthy me një front e kam pranë me vdek vetë. Unë jam kanë në
10 front. Jam ka foli për pikën e frontit.

11 S'jam marrë me civilë. As jam marrë mbas lufte më këto
12 sende. Është çliru vendi jem dhe në rregull është. Jam plagos
13 prej tyne, që kam mujt me qenë edhe vranë dhe s'po lyp
14 kërrkush llogari as pse më kanë plagos. Në rastin tem as po
15 lypi llogari pse më kanë plagos, as po jap llogari pse kam
16 gjuajt në ta derisa jam kanë i sulmu. Në vetëmbrojtje jam
17 kanë, në vendin tim më kanë sulmu. Dhe shka është edhe një
18 tjetër, as në Serbi s'jam shku as jashta Kosovës s'jam shku,
19 në vendin tim dhe në uniformë.

20 Py. Zoti Haradinaj, në atë fjali në video "Në të gjitha
21 rastet ne kemi vra ushtarë me uniformë". Kush janë këta "ne"?
22 Pë. Ushtria sa jam kanë aty. Batalioni që jemi kanë aty. Nuk
23 jam ka flas për krejt UÇK-në në këtë kuptim. Se nuk e di çka
24 kanë bë UÇK-ja në frontet e tjera dhe nuk dyshoj dhe s'kam
25 qejf me qenë ndryshe. S'është as dëshira e imja me kanë

1 ndryshe.

2 Unë, zoti Prokuror, për dijen tuaj kam dorëzu dy ushtarë
3 vetë kam dorëzu. Wesley Clark e ka marrë ushtarin e parë që e
4 ka ndërru me dy ushtarët amerikanë që i ka zënë Serbia. Unë
5 kam dorëzu ushtarë, sepse -- a e dini pse i kam dorëzu? Unë e
6 kuptoj se çka është jeta e robit. Kam qenë vetë i burgosun dhe
7 i pafuqishëm. E ki publike.

8 Py. Gjithashtu thatë që nuk ishte në karakterin e UÇK-së për
9 me e bë këtë. A e keni fjalën edhe për njësinë tuaj në lidhje
10 me këtë?

11 Pë. Më së pari e kam për karakterin njerëzor dhe karakterin e
12 edukimit. Dhe besoj se askush ma fortë nuk e kupton çka don me
13 thënë ku ke ti një fuqi ndaj të pafuqishmit me bë diçka. E
14 kemi provu në lëkurën tonë dhe ai si i përsërit këto, ai duhet
15 me kenë i çmendun. Dhe nëse ma sheh ma gjestin këtu, ku bëj
16 kështu, ku them që më ka mujt kjo domethënë që duhet me kanë i
17 çmendur. Unë s'jam kanë ndonjëherë i çmendur.

18 Kështu që për mu të dobtit, kushdo të jetë ai dhe njeri
19 të dorëzun, unë s'du me pa asi njerëzsh. S'du me pasë as
20 shokë, as kurrgjë. As kam qejf me ndejtë me ta, kushdo të jetë
21 ai. Edhe si shqiptar po të them dhe si janë, unë s'du me
22 ndejtë me ata, se ata janë njerëz të ligj. S'e unë e di çka
23 domethënë me kanë i lidhur prej radiatorit, fëmijë e me të rreh
24 tre burra. Unë kurrë s'e bëj atë, prandaj i kam dorëzu. Edhe i
25 kisha dorëzu dhe 300 me pas qenë. Në kohën që isha përgjegjës

1 edhe me jetën teme.

2 Kështu që me pa pasë të tillë, tash po dal me supozim, që
3 mendojnë ashtu më kishin vra mu pse i kam dorëzu serbët. Unë
4 për këtë arsye pjesën çka unë e di, është kështu qysh po e
5 them. Më kish vra mu që ajo UÇK atëherë. Asnjë fjalë s'më ka
6 bë kurrkush. Krejt në rregull a kanë. Shumë mirë. Pse mos me i
7 dorëzu njerëz? Pse me u marrë me civilë? S'janë marrë civilët
8 me ne. Se ata civilët që janë marrë me forca që ju janë bashku
9 njësive serbe, na s'kemi pasë mundësi as me i pa.

10 Py. A mund të ndjekë penalisht DHSK-ja në mënyrë të ligjshme
11 një anëtar të UÇK-së?

12 Pë. Nëse ka bë krim dhe e vërteton, pse jo? E meriton edhe
13 dënimin. Pse jo? Problemi është pse selektive. Pse pikërisht
14 kjo pikë e vogël, që edhe nëse e merr pretendimet që ka mujt
15 me bë, pse nuk po gjuhet në përgjithësi. Se pse? Vetëm këtu e
16 kemi kundërshtimin dhe mosmarrëveshjen ne me zyrën e juve,
17 Prokuror. Këtu është ajo që ne na bën të dukemi që jemi armiq
18 të njëri-tjetrit. Dhe nëse ju e keni me të vërtetë atë qëllim
19 sikur dhe ti vazhdon rrugën e Millosheviçit, unë jam
20 kundërshtar i yt haptas dhe tëra herët. Nëse ty s'vjen turp
21 m'u me cilësu veten ose me i jep asi nënkuptimi vazhdo ti, unë
22 jam kundërshtar i yt.

23 Py. Zoti Haradinaj --

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

25 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të përpiqem

1 ta përmbaj veten dhe të mos bëj kundërshtime të tjera. Vetëm
2 që duhet të kujtohem se në paragrafin 73, në urdhrin për
3 zhvillimin e procedurës thuhet që:

4 "Pala që bën kundërpjetjet duhet të bëjë përpjekjet më të
5 mira për të shmangur pyetjet e panevojshme jorelevante dhe të
6 përsëritura". Dhe unë dua të them që këto pyetje që janë bërë
7 janë të këtij lloji, janë të panevojshme.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
9 hidhet poshtë.

10 Vazhdoni zoti Halling.

11 Z. HALLING: [Përkthim]

12 Py. Zoti Haradinaj, është e saktë që ju donit që dokumentet
13 që ju janë sjellë në zyrën tuaj të njiheshin, të diheshin
14 publikisht në mënyrë që DHSK-ja të mendohej mirë përpara se ta
15 konfirmonte Aktakuzën kundër ish-anëtarëve të UÇK-së?

16 Pë. Jo. Ne s'kemi mendu këtë interpretim. Ne kemi mendu ma së
17 pari me e ditë a janë a s'janë. Që ne kurrë hala deri sot nuk
18 e dimë. Jo, jo s'ka qenë kjo. S'ka qenë ky qëllim hiç. Ka qenë
19 qëllimi që diçka çka na pruhet ne, ne me kanë transparent dhe
20 me tregu mos me mbajt diçka msheft. Unë do ta kisha ndi veten
21 shumë më shumë fajtor, zoti Prokuror, po t'i kisha mbajt
22 msheftë këto dhe po të kisha bë ba diçka tjetër me to.

23 Në kuptimin e kësaj për me kanë koherent me kohën kur
24 kanë ardhë. Shiqo veç kohën kur kanë ardhë, kur i kem qitë.
25 Nuk ka mujt me u bë mbledhja e mediave ma shpejtë se kjo që u

1 bë. Dhe besoni dhe një, zoti Gjykatës, mos me pat qenë interes
2 publik kjo lloj çështje e Prokurorisë që e bon këta vetë, o
3 nuk ishin ardhur hiç sa për ne gazetarët. Po tuj e ditë që
4 mundet me kanë qesi kundërshtime ishim na të sulmu në tana
5 anët, janë ardhë. S'kanë ditë kurkush ça ka. Prandaj janë
6 ardhë.

7 Nuk ka qenë qëllimi jonë me bë diçka tjetër çka ju po
8 pretendoni jo. Jo, jo s'a kanë ajo. Se na nuk e kem ditë, na
9 nuk e kem ditë. Na hala s'e dimë saktë që tash. Krejt me
10 pretendime janë tuj shku edhe ju edhe na. Se a janë a s'janë
11 të juve?

12 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kemi dhe një
13 video që duam ta luajmë. Dhe në interes të kohës sepse kjo ka
14 dy pjesë të veçanta, dua që kjo të lexohet më mirë.

15 Është dokumentin P7, 08135503. Me vulën kohore 19 minuta
16 e 40 sekonda deri në 20:04 dhe pastaj 22:22 deri 22:31. Është
17 në faqet 11 dhe 12 në transkriptin në gjuhën angleze.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk e di sa kohë mund të zgjasi
19 kjo, sepse po vjen fundi i ditës së sotme.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Unë kam qëllim që të luhet kjo
21 pjesë dhe të bëjmë një pyetje në lidhje me të.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 Py. Zoti Haradinaj, do t'ju lexoj një pjesë të intervistës që
25 keni dhënë në 18 shtator 2020. Është intervista në të cilën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 127

1 keni dalë bashkë me zoti Tomë Gashi dhe fillon me atë pjesën
2 "Në këtë rast a duhet të hidhen poshtë të gjitha aktakuzat e
3 bëra nga Dhomat e Specializuara?

4 Zoti Gashi:

5 "Tani Dhomat e Specializuar kanë nevojë -- Dhomat e
6 Specializuar duhet të mendohen përsëri. Është në dorën e
7 Gjykatësit të Procedurës Paraprake që ta bëjë këtë".

8 Dhe pastaj koordinatori thotë:

9 "Kjo është e ditur".

10 Zoti Gashi thotë:

11 "Ata duhet të mendohen edhe njëherë nëse duhet t'i
12 konfirmojnë këto aktakuza apo jo".

13 Dhe pastaj ju thoni:

14 "Sepse duke qenë Gjykata si e degjenerume, nuk mund të
15 presim edhe avokati ynë e tha shumë mirë. Ata duhet të
16 mendohen mirë tani. Duhet të mendohen dy herë".

17 Zoti Haradinaj, zoti Gashi tha që DHSK-ja duhet të
18 mendohet mirë përpara se të konfirmojë aktakuzat dhe ju u
19 pajtuat me këtë, apo jo?

20 Pë. Më fal, ky është mendimi i tij dhe mendimin e lirë ai e
21 ka me e shpreh secili. Unë nuk kam çka ndërhyjë te ai. S'ka
22 qenë pjesë e jemja. Është pjesë e përgjegjësisë të tij ato që
23 ka thënë ai dhe e din ai sesa është e bazume kjo, as e
24 pabazume. Pastaj është edhe ekspert jurist.

25 Py. Zoti Haradinaj, po ju pyes, a është edhe mendimi juaj ky?

1 Pë. Cili?

2 Py. Kur thatë që mendoj që duhet edhe njëherë të mendojnë.

3 Gjykata duhet të mendojë edhe njëherë, a pajtohesh me mendimin
4 e zotit Gashi që Gjykata duhet të mendohet edhe njëherë nëse
5 t'i konfirmojë apo jo aktakuzat?

6 Pë. Jo, ky s'a mendim i jemi. Ky a mendimi i Tomë Gashit.

7 Py. Dhe kur thoni që duhet edhe njëherë të mendojnë, mendoj
8 që duhet dhe njëherë të mendojnë, a është mendimi juaj ky?

9 Pë. Ku? I cilit kam thënë unë? Ku kam thënë unë që duhet edhe
10 njëherë të mendojnë?

11 Py. Në 22:22 deri në 22:31. Ndoshta mund të jetë në faqen
12 tjetër.

13 Pë. Do të thotë, a po e sheh pra, do të thotë edhe nëse e kam
14 thënë që po e këqyri edhe nëse e kam thënë, do të thotë kam
15 reflektu me mendimin e një eksperti. Do veç që kam citu atë.
16 Ai ka thënë qashtu kam citu dhe unë, tuj mëndu që ai rezonon
17 më mirë se unë në këtë aspekt. Edhe është ma i zoti se unë në
18 aspektin juridik Tomë Gashi. Ka qenë edhe Prokuror edhe
19 Gjykatës edhe Mbrojtës.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta lëmë këtu. Ta ndërpresim
21 këtu, i nderuar Gjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
23 Do të vijmë përsëri këtu nesër në orën 9:30 minuta.

24 Zoti Cadman, ju lutem na njoftoni për zotin Reid dhe mund
25 t'i thoni që të jetë gati për datat 24 dhe 31, shpresojmë që

1 sot të viheni në kontakt me të. Dhe nesër të jetë e zgjidhur
2 çdo gjë.

3 Faleminderit të gjithëve, përkthyesve, personelit
4 audiovizual dhe Sekretarit të Gjykatës.

5 --- Seanca përfundon në orën 15.59

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25